



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në: “Informatikë”

Universiteti i Tiranës

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:


Prof.Dr. Thoma KORINI

Dr. Alketa GREPCKA

Janar / 2023

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Bachelor në "Informatikë"**

1	IAL aplikues:	Universiteti i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Informatikës
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bsc në " Informatikë "
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër Nr. 31, datë 30.12.1994
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Urdhëri i regjistrimit të Formës së diplomës:	Urdhër Nr. 297, datë 20.07.2012
7	Urdhëri/VBA i akreditimit pararendës:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i Parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
13.1	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
13.2	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
14	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
15	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit 2021 - 2022:	43 PAE / 27 PAK Ngarkesa mësimore: 71 % PAE / 29 % PAK
16	Numri i studentëve (2018-2021):	2019-2020 202 studentë; 2020-2021 201 studentë; 2021-2022 202 studentë;
17	Komente / të tjera:	-



TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti i Tiranës (UT) është një institucion publik i arsimit të lartë, i themeluar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.207 dt.30.05.1957. UT i është akorduar akreditimi institucional me Vendim BA Nr. 84, datë 27.10.2018, me kohëzgjatje 4 vite akademike, afati vlefshmërisë deri më 26.10.2022. Universiteti i Tiranës sipas strukturës aktuale ka në përbërjen e tij një filial, gjashtë fakultete dhe dy institute emërtuar si vijon:

- Filiali i Sarandës
- Fakulteti i Gjuhëve të Huaja
- Fakulteti i Ekonomisë
- Fakulteti i Drejtësisë
- Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë
- Fakulteti i Shkencave Sociale
- Fakulteti i Shkencave të Natyrës
- Instituti i Fizikës Bërthamore
- Instituti i Studimeve Europiane

Statuti i UT, në përputhje me Ligjin Nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” është miratuar në vitin 2018.

Programi i studimit i ciklit të parë Bachelor në “Informatikë” është hapur me Urdhër Nr. 31, datë 30.12.1994 të Ministrisë së Arsimit. Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë universitare Bachelor në "Informatikë". Forma e regjistrimit të diplomës është kryer me Urdhër Nr.297, datë 20.07.2012 të MAS. Njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi është Departamenti i Informatikës, njësi përbërëse e Fakultetit të Shkencave të Natyrës.

Programi i studimit Bachelor në "Informatikë" ofrohet me kohë të plotë, me kohëzgjatje 3 vite akademike dhe është organizuar në bazë të sistemin Europian të transferimit të krediteve në 180 kredite ECTS. Objektivi kryesor i programit të studimit Bachelor në "Informatikë" është realizimi i formimit shkencor dhe profesional të specialistëve në fushën e Informatikës, në mënyrë të veçantë programues apo zhvillues softuerësh, informaticienë teorikë, administratorë dhe programues të bazave të të dhënave, administratorë të sistemeve të shfrytëzimit, administratorë dhe ndërtues të rrjeteve kompjuterike, arkitektë sistemesh kompjuterike, specialistë të sigurisë së informacionit, specialistë informatike për fusha të ndryshme të zhvillimit ekonomik. Programi i studimit ofrohet në përputhje të plotë me Statutin dhe Rregulloren e UT. UT ka aplikuar në ASCAL për akreditimin e programit të studimit Bachelor në “Informatikë” më datë 26.10.2021. Në këtë mënyrë, kemi të bëjmë me akreditimin për herë të para të këtij programi studimi.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Burimi parësor i informacionit për grupin e punës ishte Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, i përgatitur në Maj 2022. Ky Raport siguron një pamje të detajuar të sistemeve dhe mekanizmave që ka ngritur UT për të përmbushur objektivat e veta si dhe për të arritur efektivitetin e procedurave të tij për menaxhimin e cilësisë dhe standardeve. UT, po ashtu, nëpërmjet sistemit AMS të ASCAL, vuri në dispozicion të vlerësuesve një numër eviencash mbështetëse.

Për realizimin e këtij vlerësimi, GVJ u mbështet kryesisht tek kërkesat e parashkuara nga Ligji Nr. 80/2015 *“Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”*, VKM Nr.531, datë 11.9.2018 *“Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”*, VKM Nr.41, datë 24.01.2018 *“Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë”*, në VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, *“Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”*, në Udhëzimin e MASR Nr. 1, datë 14.1.2020, për *“Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e Institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njërive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë”*, Udhëzimin e MASR Nr. 22, datë 3.9.2020, Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin Nr. 1, datë 14.1.2020, *“Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e Institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njërive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë”* si dhe gjithë aktet e tjera nënligjore që kanë të bëjnë me organizimin e studimeve në institucionet e arsimit të lartë.

GVJ gjatë vlerësimit të jashtëm u mbështet nga specialisti i ASCAL, Msc. Majlinda Demirneli. Takimet në institucion, u zhvilluan sipas programit të miratuar nga ASCAL. Takimet në institucion konsistuan në zhvillimin e diskutimeve, me Dekanin e Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Përgjegjës të Departamentit të Informatikës, Grupin e Vlerësimit të brendshëm, stafin akademik, studentët, përfaqësues të Degës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës, përfaqësues të Degës së Burimeve Njerëzore, përfaqësues të Drejtorisë së Kërkimit Shkencor, Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë, përfaqësues të Zyrës së Kurrikulave si dhe përfaqësues të Sekretarisë Mësimore. Gjithashtu u zhvillua edhe një vizitë e auditorëve, laboratorëve si dhe bibliotekës, shoqëruar me diskutime për elementë lidhur me këtë infrastrukturë. Vlerësimi i programit të studimit u fokusua në analizën e programit, në shqyrtimin e syllabuseve: vendosjen e objektivave të të mësuarit, kompetencat që synohen të fitohen, rrugët nëpërmjet të cilave fitohen (metodat e mësimdhënies), literaturën bazë dhe atë shtesë, mënyrat e vlerësimit të dijeve, përcaktimin e krediteve, kualifikimin e stafit akademik, etj. Informacioni dhe të dhënat që përmban ky raport bazohen në burimet e sipërpërmendura dokumentare, në takimet e zhvilluara, si dhe në materialet shtesë që iu vunë në dispozicion GVJ-së sipas kërkesave të paraqitura.

Universiteti i Tiranës është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 27.12.2022, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 52/188 Prot, datë 27.12.2022. Universiteti i Tiranës më datë 25.01.2023, njofton nëpërmjet sistemit AMS, mbi dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Informatikë”

I. OFRIMI, I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Programi i studimit Bachelor në “Informatikë” i ofruar nga UT, është në përputhje me planin strategjik të Departamentit të Informatikës i cili synon të jetë në pararojë të zhvillimeve të informatikës në vend dhe në rajon si në kërkim ashtu edhe në mësimdhënie. Në këtë mënyrë, ky program u shërben interesave kombëtare [Ev.: 5 Strategjia e Departamentit të Informatikës].
Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit, megjithëse nuk ka të bëjë direkt me fushën e ruajtjes dhe konsolidimit të vlerave akademike e kulturore kombëtare, mbështet zhvillimet prioritare të kohës në Shqipëri e më gjerë. Ky program studimi që në fillimet e tij, nëpërmjet specialistëve që ka përgatitur, ka qenë një mbështetje e fuqishme për modernizim e vendit nëpërmjet shtrirjes së informatizimit në aspekte të ndryshme të aktivitetit njerëzor.
Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Në Statutin e UT përcaktohet si mision ofrimi i një game të plotë të programeve të nivelit bachelor, master dhe studime doktorale duke ofruar një edukim me në qendër studentin, si dhe duke nxitur rritjen personale dhe intelektuale, për të përgatitur studentë për karrierë produktive dhe qytetare, të përgjegjshëm në një shoqëri globale. Universiteti kontribuon në zhvillimin e shoqërisë, përmes tri shtyllave të misionit të arsimit të lartë publik: kërkim shkencor, edukim, si dhe shërbim ndaj publikut, që vazhdimisht e pasurojnë dhe e informojnë njëra-tjetrën. Në këtë aspekt, programi i studimit Bachelor në “Informatikë”, është hartuar dhe ofrohet në përputhje me misionin e UT [Ev.: 1 Statuti i Universitetit të Tiranës].

<p>Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Informatikë” ka si objektivi të realizojë formimin shkencor dhe profesional të specialistëve në fushën e Informatikës duke u mundësuar studentëve të përgatiten sipas eksperiencës më të mirë ndërkombëtare, përmes një kurrikule të ndërtuar me kujdes dhe në përputhje me fushën e studimit [Ev.: 7 Plani Mesimor Bachelor Informatike; Takime në institucion].</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>

<p>Standardi I.2</p>	
<p>Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>Në Strategjinë e Zhvillimit të UT përcaktohet se programet e studimit në këtë universitet kanë për qëllim të përbashkët zhvillimin e arsimit, kulturës, shkencës dhe ekonomisë në shërbim të lirisë e diversitetit të ideve, për ndërtimin dhe konsolidimin e shoqërisë demokratike dhe shtetit të së drejtës, për rritjen e mirëqënies e dinjitetit njerëzor, të realizuara me veprimtari të ligjshme dhe transparente [Ev.: 4 Strategjia e Zhvillimit Të Universitetit Të Tiranës 2018-2023].</p>
<p>Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>UT ofron një larmi programesh studimi që përfshijnë fushën e informatikës dhe teknologjisë së informacionit, shkencave natyrore, shkencave sociale ekonomike, etj. Të gjitha programet e studimit në UT kanë si emërues të përbashkët nxitjen e mendimit kritik dhe krijues me qëllim zhvillimin e frymës së qytetarisë demokratike, krijimin e një hapësire publike universitare që karakterizohet nga debat i lirë, serioz dhe me përkushtim ndaj të mirës publike. UT e konsideron veten si një institucion që synon që përmes programeve të studimit t’i orientojë studentët drejt të menduarit analitik dhe ndërdisiplinor dhe t’i përgatisë ata për konkurrencën në tregun e punës. [Ev.: RVB; 4 Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018-2023]. GVJ konstatoi se programi i studimit Bachelor në “Informatikë” është hartuar në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e UT dhe zhvillohet duke u orientuar në përputhje me Strategjinë e Departamentit të Informatikës [Ev.: 5 Strategjia e Departamentit të Informatikës].</p>

<p>Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.</p>	<p>Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit Bachelor në “Informatikë” mbështetet në Statutin dhe Rregulloren e UT në përputhje me standartet më të mira të mësimdhënies dhe me drejtimet akademike të institucionit. Në këtë aspekt, të gjitha programet e ciklit të parë janë të organizuar me 180 kredite ECTS dhe japin akses në ofertën didaktike të ciklit të dytë të ofruar jo vetëm nga UT por dhe nga IAL të tjera brenda dhe jashtë vendit. GVJ është i mendimit se, në mënyrë të veçantë programi i studimit Bachelor në “Informatikë” ofrohet në përputhje me standartet më të mira të mësimdhënies dhe me drejtimet akademike të UT duke ju përgjigjur kërkesave të tregut dhe garantuar aksesin në ciklet më të larta të studimeve [Ev.: 1 Statuti i Universitetit të Tiranës; RVB; 4 Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018-2023]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>


<p>Standardi I.3</p>	
<p>Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe takimet në institucion GVJ konstatoi se programi i studimit Bachelor në “Informatikë” ka për qëllim të realizojë formimin shkencor dhe profesional të specialistëve në fushën e Informatikës përfshirë programues apo zhvillues softuerësh (për aplikime desktop, web, mobile, cloud etj), informaticienë teorikë, teknologë të informacionit dhe komunikimit për sektorin publik dhe privat, administratorë dhe programues të bazave të të dhënave, administratorë të sistemeve të shfrytëzimit (në kompjutera personale, servera apo sisteme të shprëndara), administratorë dhe ndërtues të rrjeteve kompjuterike, arkitektë sistemesh kompjuterikë, specialistë të sigurisë së informacionit, specialistë informatikë për fusha të ndryshme të zhvillimit ekonomik. [Ev.: 2 Rregullore Programi Studimi Bachelor Informatike; Takime në institucion]</p> <p>Në Rregulloren e programit të studimit janë shprehur qartë aftësitë që studenti synohet të përfitojë si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Krijimi i shprehive të lidhura me profesionin përfshirë njohuri të avancuara në fushën e informatikës, të

	<p>kuptuarin kritik të teorive / parimeve dhe aplikimit të tyre kryesore në fushën e informatikës, njohjen e termave teknikë, njohjen e proceseve teknologjike, njohuri mbi zhvillimet kryesore teorike dhe aplikimet praktike në fushën e informatikës, njohuri të shkrimit teknik në fushën e informatikës, njohjen e sistemeve informatike;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Aftësimi i specialistëve të ardhshëm me frymën e punës në grup dhe bashkëpunimin me aktorët dhe faktorët e tjerë që ndikojnë në ciklin jetësor të zhvillimit të një softueri përfshirë mjetet dhe metodat e komunikimit me porositesit, përdoruesit fundorë, manaxhimin e organizatës, manaxherin e projektit, analistët e biznesit etj; • Krijimi i shprehive në prodhimin e kodit cilësor dhe duke përdorur praktikat më të mira programative; • Ndërtimi i kodit apo sistemeve duke pasur në vëmendje sigurinë e informacionit; • Përgatitja e studentëve të cilët duan të avancojnë më tej studimet e tyre në studime të Masterit të Shkencave apo Masterit Profesional në fushat e Informatikës apo Teknologjisë së Informacionit, përfshirë fusha studimi të kombinuara mes informatikës dhe një fushe tjetër shkencore / teknike, përfshirë këtu dhe drejtimin e mësuesisë; <p>[Ev.: 2 Rregullore Programi Studimi Bachelor Informatike]</p> <p>Në mënyrë më të detajuar objektivat kryesorë të këtij programi studimi shtjellohen për çdo lëndë pjesë përbërëse të tij dhe shprehen qartë në përmbajtjen e syllabuseve [Ev.: 9 Syllabuset Bachelor në Informatikë 2020-2021].</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e</p>	<p>Institucioni ka analizuar tendencën e kërkesave të maturantëve për të studjuar në programet e ofruara nga UT dhe në mënyrë të veçantë për programin e studimit Bachelor në "Informatikë". Kjo analizë i referohet vlerësimit të interesit të studentëve referuar aplikimeve pranë degëve Informatikë dhe Teknologji Informacioni dhe Komunikimi, gjenerimit dhe analizimit të informacionit të grumbulluar nëpërmjet anketave online nga studentët e ciklit të parë, monitorimit të numrit të të diplomuarve dhe analizës së kërkesë ofertës së tregut [Ev.: 10 Studimi i Tregut të Punës 2018]. Ka rezultuar se përsa u përket aplikimeve, për drejtimin "Informatikë" ka një rritje prej 23.7% të kërkesave për periudhën 2019-2021. Gjithashtu, konstatohet që ka një tendencë në rritje të punësimit të studentëve duke kaluar nga 9% për studentët e vitit të parë në</p>

<p>pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>32% për studentët e vitit të tretë [Ev.: 11 Studimi i Tregut të Punes Janar 2022]. Mbi bazën e këtyre elementëve, zhvillimeve të shpejta në këtë fushë në dekadat e fundit, prioritetëve kombëtare në këtë drejtim si dhe kërkesat nga bizneset dhe institucionet e qytetit të Tiranës, GVJ është i mendimit se programi i studimit Bachelor në "Informatikë" u përgjigjet kërkesave të tregut dhe garantohet një zhvillim i qëndrueshëm i tij në vitet në vijim [Ev.: Takime në institucion]</p>			
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve, garantojnë përfitim të dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Nga analiza e strukturës së programit të studimit, GVJ konstatoi se ai është hartuar në përputhje me VKM Nr.41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë", si dhe VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë". Gjithashtu, përsa i përket përmbajtjes, në këtë program studimi janë pasqyruar elementët e nevojshëm formues të cilët garantojnë përfitim të dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës, lehtësojnë punësimin e studentëve, mundësojnë transferimin e studimeve në fusha të ngjajshme si brenda institucionit, ashtu edhe në institucione të tjerë që ofrojnë programe të ngjajshme studimi si dhe, pas diplomimit, mundësojnë vazhdimin e studimeve të ciklit të dytë. Në përfundim të studimeve studentët e programit të studimit Bachelor në "Informatikë" synohet të punësohen si specialist informatike në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Në administratën publike; • Në kompani implementimi zgjidhjesh informatike; • Në institucione bankare, telekomunikacioni, mjekësore; • Në ndërmarrje të ndryshme ekonomike; <p>[Ev.: 7 Plani Mesimor Bachelor Informatike; 9 Syllabuset Bachelor në Informatikë 2020-2021; RVB].</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Niveli i Përmbushjes</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X


Standardi I.4

Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Informatikë” ofrohet nga Departamenti i Informatikës, njësi përbërëse e Fakultetit të Shkencave të Natyrës. Misioni i Departamentit të Informatikës është të përgatisë specialistëve cilësorë të informatikës dhe të ofrojë kërkim cilësor e të aplikuar. Synohet përgatitja e profesionistët më të mirë në mësimdhënie, kërkim, industri dhe sektorin publik si dhe ofrimi i kërkimit cilësor sipas drejtimeve e kualifikimeve të stafit dhe të nevojave të vendit [Ev.: 5 Strategjia e Departamentit të Informatikës]. Plotësimi i këtij misioni mbështetet në një staf total prej 72 punonjësish nga të cilët 29 janë PAE, 38 PAK dhe 5 personel ndihmës akademik (të dhënat e vitit 2020-2021). Përsa i përket PAE, 3 prej tyre janë me titullin Prof.Asoc, 11 me gradën shkencore “Doktor”, 7 janë në proces të përgatitjes së doktoratës, ndërsa 8 janë me diplomën Master i Shkencave [Ev.: RVB, Tabela 1]. Referuar fushës individuale të kualifikimit, GVJ konstatoi se personeli i angazhuar në programin e studimit Bachelor në “Informatikë” disponon formimin e duhur për të garantuar një mësimdhënie cilësore [Ev.: 14 CV Stafi Akademik PAE; 15 CV Stafi Akademik PAK].</p> <p>GVJ është i mendimit që ka një tendencë për përmirësimin e shkallës së kualifikimit të PAE, gjë e cila duhet të vazhdojë edhe në vitet në vijim duke ofruar në këtë mënyrë garanci suplementare për një qëndrueshmëri në kohë të personelit akademik dhe rritje të nivelit cilësor jo vetëm të mësimdhënies, por edhe të kërkimit shkencor.</p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave të Natyrës ka në përbërjen e tij njësitë bazë [Ev.: 30 Organigrama] :</p> <ul style="list-style-type: none"> • Departamenti i Matematikës • Departamenti i Matematikës së Aplikuar • Departamenti i Informatikës • Departamenti i Fizikës • Departamenti i Kimisë • Departamenti i Kimisë Industriale • Departamenti i Biologjisë • Qendra Kërkimore e Florës dhe Faunës • Departamenti i Bioteknologjisë <p>GVJ konstatoi se ka një përputhje ndërmjet fushës së përgjithshme dhe specifike të programit të studimit dhe fushës akademike e kërkimore të Fakultetit të Shkencave të Natyrës. Duke ju referuar kërkesave të Ligjit Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë</p>

	<p>në Republikën e Shqipërisë” përsa i përket kodifikimit të programeve të studimit, aktualisht mungojnë aktet nënligjore, të nevojshme për të realizuar këtë proces.</p> <p>FSHN-së i mungon një rregullore Fakulteti, megjithëse është detyrim i sanksionuar në nenin 12, pika 6, të Statutit të UT, sipas të cilit, veprimtaria e fakultetit mbështetet ndërmjet të tjerash edhe në rregulloren e fakultetit. Nga takimi me Dekanin dhe Zv. Dekanin për Shkencën të FSHN mësuam se ajo është duke u përgatitur.</p> <p><i>GVJ sugjeron, se FSHN/UT duhet të miratojë rregulloren e njësisë kryesore FSHN për mbarvajtjen dhe mbështetjen e veprimtarisë, konform ligjit të arsimit të lartë, 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" si dhe statutit të UT.</i></p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Departamenti i Informatikës, është pjesë e FSHN, UT, dhe ofron programe në tre ciklet e studimit [Ev.: 3 Rregullore e Departamentit të Informatikes]:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Cikli i parë: “Bachelor në Informatikë”; • Cikli i parë: “Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”; • Cikli i dytë: “Master i Shkencave në Informatikë”; • Cikli i dytë: “Master i Shkencave në Teknologji Informacioni”; • Cikli i dytë: “Master i Shkencave në “Mësuesi në Informatikë AML”; • Cikli i dytë: “Master Profesional në Informatikë Biznesi”; • Cikli i dytë: “Master Profesional në Teknologji Informacioni”; • Cikli i tretë: Studime doktorature në Shkencat Natyrore, nënfusha, Informatikë. <p>Misioni i Departamentit të Informatikës është të zgjerojë dhe të diversifikojë përgatitjen e profesionistëve të specializuar në informatikë dhe teknologji informacioni dhe të çojë përpara njohuritë në sisteme dhe shkencat kompjuterike duke siguruar mësimdhënie me cilësi të lartë si dhe të drejtojë kërkime shkencore që adresojnë sfida në fusha aktuale informatikë dhe probleme sociale. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV si dhe takimet në institucion, GVJ konstatoi se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Departamentit të Informatikës. [Ev.: 3 Rregullore e Departamentit të Informatikes, Takime në institucion].</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.5

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njëjësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Veprimtaria e FSHN zhvillohet bazuar në Statutin e UT, Rregulloren e UT, Rregulloren e Departamentit të Informatikës si dhe gjithë rregulloret për aspekte të ndryshme të jetës akademike [Ev.: 1 Statuti i Universitetit të Tiranës; https://unitir.edu.al/rregullore-ut/]. Hartimi, mbikqyrja dhe mbarëvajtja e programit të studimit Bachelor në "Informatikë" mbulohet nga Departamenti i Informatikës. Për të mundësuar formimin e studentëve me njohuritë e kërkuara për këtë program të ciklit të parë, Departamenti i Informatikës bashkëpunon edhe me departamente të tjerë të FSHN duke përcaktuar si nivelin e angazhimit ashtu edhe detyrimet reciproke. Në mënyrë të veçantë anëtarë të Departamentit të Matematikës së Aplikuar, Matematikës dhe Fizikës janë të angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit Bachelor në "Informatikë". Elementët që kanë të bëjnë me aktivitetin mësimor-kërkimor të stafit akademik, botimet dhe pjesëmarrjet në konferencat kombëtare dhe ndërkombëtare, cilësinë e mësimdhënies, projektet në kuadër të permisimit të programit, etj janë pjesë e raporteve vjetore që përgatiten [Ev.: RVB; 22 Raporti Vjetor FSHN UT 2020-2021; 21 Raporti Vjetor FSHN UT 2019-2020].</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të DVV, GVJ konstatoi se UT ka nënshkruar një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit si dhe me aktorë të biznesit të cilat mbështesin realizimin e objektivave të programit të studimit. [Ev.: 25 Marrëveshje të FSHN me kompani, institucione të tjera 2016-2021; https://unitir.edu.al/marreveshjet-erasmus-ka1-te-nenshkuara-nga-universiteti-i-tiranes/; https://unitir.edu.al/marreveshjet-bilaterale-2/]</p>

<p>Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>GVJ u njoh me raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. Raporti i cili përfshin vitet akademike 2018-2019, 2019-2020, 2020-2021 jep një pasqyrë të vizitave të personelit akademik të Departamentit në institucione homologe europiane në kuadër të marrëveshjeve ERASMUS, vizita të profesorëve të huaj shoqëruar me mbajtje leksionesh të hapura si dhe organizim konferencash ndërkombëtare. Departamenti i Informatikës është i përfshirë në mënyra të ndryshme në këto marrëveshje duke përfituar në mënyrë direkte në zhvillimin profesional të personelit akademik të tij si dhe në mundësitë nxitëse që u ofrohen studentëve për t'u orientuar në fusha përtej atyre që hasen në përditshmërinë e zhvillimit të mësimin sipas kurrikulave konkrete të programeve bachelor të departamentit [Ev.: 27 Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>GVJ u informua se praktika mësimore është pjesë e planit mësimor dhe është parashikuar si një lëndë e veçantë me një volum prej 3 kreditesh ECTS [Ev.: Takime në institucion]. Referuar informacionit të pasqyruar në analizën vjetore të Departamentit të Informatikës, për periudhën 2018-2021 ka pasur dhjetëra marrëveshje të nënshkruara në kuadër të rritjes profesionale të studentëve në degën e Informatikës duke mbështetur zhvillimin e praktikës mësimore. Gjithashtu, Departamenti i Informatikës është angazhuar në konsolidimin e lidhjeve me aktorët e biznesit duke organizuar takime me tema të ndryshme në ambientet e departamentit, apo duke marrë pjesë në aktivitete të ndryshme të organizuara nga aktorët e biznesit dhe institucione të tjera, si workshope, tryeza të rrumbullakëta etj. Ndër të tjera, qëllimi i këtyre aktiviteteve ka qenë edhe njohja dhe të qenurit koherent me nevojat dhe pritshmëritë e tregut të punës, ashtu sikurse edhe konsultimi dhe diskutimi i lëndëve dhe përmbajtjes së tyre me qëllim që programet e ofruara të jenë sa më pranë pritshmërive të tregut të punës. [Ev.: 26 Analiza Vjetore e Departamentit të Informatikës; 25 Marrëveshje të FSHN me kompani, institucione të tjera 2016-2021].</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Në UT është ngritur që prej vitit 2021 "Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe trajnimit" [Ev.: https://unitir.edu.al/qender-virtuale-e-trajnimit-dhe-zhvillimit-profesional/]. Kjo qendër organizon në mënyrë periodike trajnime apo seminare të ndryshme në shërbim të rritjes së kompetencave dhe përfundimit të elementëve me interes si në drejtim të kualifikimit individual ashtu edhe në drejtim të</p>

	<p>marrjes së informacioneve për çështje të caktuara. Mund të përmenden p.sh. aktivitete të tilla si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Si të shkruhet dhe të botohet një artikull; - Trajnimi me temë "Mendimi kritik"; - Trajnimi "Etika në vendin e punës dhe menaxhimi i konflikteve"; - Seminari "Referencimi i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve me atë Evropiane"; - Trajnimi "Shkrimi i propozimeve kompetitive për projekte të financuara nga EU" - Seminari online organizuar nga EU for Innovation &Preneurz.Amsterdam team; - Etj. <p>GVJ u informua se në kuadër të aktiviteteve të organizuara nga Departamenti është dhe ai mbi Hapësira e Programuesve të Rinj – YPS, konferenca ndërkombëtare shkencore RTA-CSIT e cila zhvillohet në mënyrë periodike si dhe zhvillimi i “workshop”-eve dhe leksioneve të hapura [Ev.: 29 Aktivitete Departamenti Informatikes 2018-2021; RVB; Takime në institucion].</p> <p>GVJ u informua se shumica e studentëve që përfundojnë studimet Bachelor në Informatikë kanë zgjedhur të thellojnë me tej njohuritë e tyre duke u regjistruar në programet master shkencor dhe master profesional të ofruar nga Departamenti i Informatikës [Ev.: Takime në institucion].</p>
--	--

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Referuar planit mësimor [Ev.: 28 Plani Mesimor Bachelor Informatike 2022-2023], GVJ konstatoi se programi i studimit Bachelor në “Informatikë” është i organizuar në lëndë e module të vlerësuara në kredite në përputhje me Ligjin Nr.80/2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Forma e studimit për këtë program është me kohë të plotë dhe realizohet për 3 vite akademike me nga 2 semestra secili. Përfundimit të këtij programi studimesh i korresponon grumbullimi i 180 krediteve ECTS, duke realizuar çdo vit 60 kredite.</p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Informatikë” i korresponon Nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve duke mundësuar fitimin e njohurive, afësive dhe kompetencave për realizimin e formimit shkencor dhe profesional të specialistëve në fushën e Informatikës me aftësinë për të punuar si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - programues apo zhvillues softuerësh (për aplikime desktop, web, mobile, cloud etj.); - informaticienë teorikë, teknologë të informacionit dhe komunikimit për sektorin publik dhe privat; - administratorë dhe programues të bazave të të dhënave; - administratorë të sistemeve të shfrytëzimit (në kompjutera personale, servera apo sisteme të shprëndara); - administratorë dhe ndërtues të rrjeteve kompjuterike, arkitektë sistemesh kompjuterikë; - specialistë të sigurisë së informacionit; - specialistë informatike për fusha të ndryshme të zhvillimit ekonomik. <p>[Ev.: 2 Rregullore Programi Studimi Bachelor Informatike; Takime në institucion].</p> <p>GVJ është i mendimit se njohuritë e përftuara në këtë cikël studimi krijojnë një bazë dhe shprehi të mjaftueshme për të</p>

	avancuar në një shumëllojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh të lidhura me informatikën.
Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuar në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.	GVJ, referuar planit mësimor dhe syllabuseve të lëndëve, është i mendimit se programi i studimit Bachelor në “Informatikë” është hartuar në mënyrë të tillë që të përmbajë elementët teorikë bazë të nevojshëm për të mundësuar thellimin në drejtime më specifike që lidhen me informatikën [Ev.: 7, 7/1, 7/2, 7/3 Planet Mesimore Bachelor Informatike; 9 Syllabuset Bachelor në Informatikë 2020-2021]
Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	GVJ është i mendimit se aftësitë dhe kompetencat e avancuara të përfuara në kuadër të këtij programi studimi mundësojnë nga njera anë një ekspertizë të thelluar në problematika të tilla si inxhinieri softi, programues, zhvillues web, menaxher rrjetesh kompjuterike në institucione private apo shtetërore dhe nga ana tjetër krijojnë një bazë të shëndoshë për të thelluar studimet në ciklin e dytë të tyre, Master i Shkencave apo Master Profesional. Gjithashtu integrimi në program i lëndëve me zgjedhje si Statistikë e aplikuar, UML, Bazat e Infografisë, GIS, Analizë Numerike, krijon mundësinë që studentët të kenë mundësinë të marrin njohuri në një drejtim të caktuar në funksion të preferencave të tyre dhe orientimit që mendojnë të ndjekin në ciklin pasues të studimeve ose edhe në karrierën profesionale [Ev.: 7, 7/1, 7/2, 7/3 Planet Mesimore Bachelor Informatike].
Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.	GVJ konstatoi se hartimi i programit të studimit Bachelor në “Informatikë” është bërë duke u mbështetur në të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në mënyrë të veçantë, është hartuar duke respektuar kërkesat e VKM Nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë”, si dhe procedura e hartimit dhe miratimit të tyre ka kaluar në gjitha hallkat e përcaktuara në aktet përkatëse ligjore e nënligjore.
Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Nga analiza e programit të studimit [Ev.: 7, 7/1, 7/2, 7/3 Planet Mesimore Bachelor Informatike], GVJ konstatoi se janë përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët sipas kërkesave të akteve ligjore dhe nënligjore. Duke i ballafaquar dhe përshtatur në përputhje me VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë” veprimtaritë formuese të programit mund të grupohen:

	<p>A. LËNDË BAZË – përgatitje metodologjike dhe kulturre e përgjithshme (32 kredite - rreth 18%)</p> <p>B. LËNDË KARAKTERIZUESE –përgatitje për disiplinën shkencore (96 kredite - rreth 53%)</p> <p>C. LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGRUESE – nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje (22 kredite – rreth 12%)</p> <p>D. LËNDË PLOTËSUESE – gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale (22 kredite – rreth 12%)</p> <p>E. DETYRIME PËRMBYLLËSE (8 kredite – rreth 5%)</p> <p>si dhe respektohet kërkesa që përqindja e krediteve të lëndëve të kategorive A dhe B të mos jetë më pak se 70% e totalit [Ev.: RVB; 7, 7/1, 7/2, 7/3 Planet Mesimore Bachelor Informatike].</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	UT i është akorduar akreditimi institucional me Vendim BA Nr. 84, datë 27.10.2018, me kohëzgjatje 4 vite akademike, afati vlefshmërisë deri më 26.10.2022. Njësitë kryesore të UT dhe në veçanti FSHN përmbush detyrimet ligjore në lidhje me numrin e njësive bazë, ndërsa njësia bazë, Departamenti i Informatikës përmbush kriteret ligjore që mundësojnë zhvillimin e aktivitetit në fushën përkatëse të ekspertizës [Ev.: 30 Organigrama; 66 Vendimi i Bordit të Akreditimit Nr.84, date 27.10.2018; Takime në institucion].
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e	Nga takimet me personelin akademik GVJ u informua se koordinatori i programit të studimit është Përgjegjësi i Departamentit, i cili : <ul style="list-style-type: none"> - Drejton punën për hartimin, ndryshimin e Rregullores së Bachelor në Informatikë; për përgatitjen e strategjisë së zhvillimit; për përgatitjen e dokumentacionit pedagogjik të Bachelor në Informatikë: planin mësimor, programet mësimore, paketën e praktikës dhe të udhëzimeve për

tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.

tezën; për hartimin e planit të kërkimit, për administrimin e të ardhurave të Bachelor në Informatikë.

- Propozon për miratim programet mësimore.
- Miraton programin e lëndëve mësimore
- Drejton hartimin e orarit të mësimave, të provimeve dhe ndjek zbatimin e tyre.
- Miraton komisionet e provimeve.
- Ndjek ecurinë e procesit mësimor.
- Ndjek ecurinë e veprimtarisë kërkimore dhe të procesit të tezës.
- Organizon ceremoninë e diplomimit.
- I propozon Këshillit të fakultetit kriteret e pranimit të studentëve,
- I propozon Dekanit komisionet e pranimit të studentëve, komisionin e tezës, komisionet e diplomimit.
- Organizon konkursin e pranimit të studentëve të rinj.
- Përfaqëson Bachelor në Informatikë në marrëdhëniet me të tretë
- Organizon vlerësimin e brendshëm të Bachelor në Informatikë.

Për të ndjekur problematikat që lidhen me studentët, GVJ u informua se programi i studimit ka një kujdestar për çdo vit [Ev.: 6 Rregullore e UT – Neni 23; RVB; Takime në institucion].

Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënljore për organizimin dhe strukturën akademike.

Fakulteti i Shkencave të Natyrës në vitin akademik 2021-2022 është i përberë nga Personeli Akademik Efektiv (PAE) në nivel fakulteti (171 pedagogë PAE) të cilët kanë kualifikimin si më poshtë [Të dhëna të përpunuara nga gjetjet në DVV, viti akademik 2021-2022]:

Kualifikimi	Nr. personel PAE
Prof. Dr.	31
Prof. Asoc.	39
Dr./PhD	73
Dr. Proces	7
Msc.	21
Gjithsej	171

Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.

Departamenti i Informatikës është pjesë përbërëse e Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe ofron programe në tre ciklet e studimit [Ev.: 3 Rregullore e Departamentit të Informatikës]:

- Cikli i parë: “Bachelor në Informatikë”;
- Cikli i parë: “Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”;
- Cikli i dytë: “Master i Shkencave në Informatikë”;

Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënljore për organizimin dhe strukturën akademike.

- Cikli i dytë: “Master i Shkencave në Teknologji Informatikë”;
- Cikli i dytë: “Master i Shkencave në “Mësuesi në Informatikë AML”;
- Cikli i dytë: “Master Profesional në Informatikë Biznesi”;
- Cikli i dytë: “Master Profesional në Teknologji Informatikë”;
- Cikli i tretë: Studime doktorature në Shkencat Natyrore, nënfusha, Informatikë.

Departamenti i Informatikës është i organizuar në 3 grupe mësimore kërkimore [Ev.: 3 Rregullore e Departamentit të Informatikës]:

- a) Grupi mësimor kërkimor “Qeverisja Elektronike”;
- b) Grupi mësimor kërkimor “Sistemet e informacionit ndërveprues”;
- c) Grupi mësimor kërkimor “Analizë të dhënash dhe inteligjencë artificiale”.

Departamenti i Informatikës si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në Teknologji Informatikë dhe Komunikimi në vitin akademik 2020-2021 ka këtë paraqitje:

Kualifikimi i stafit	Departamenti i Informatikës	
	PAE	PAK
Prof.Dr	-	-
Prof.Asoc	3	1
Dr/PhD	11	3
Dr në proc	7	-
Msc	8	34
Gjithsej	29	38

GVJ konkludon se Departamenti i Informatikës, përgjegjës për programin e studimit Bachelor në "Informatikë", i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 25 të Ligjit Nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” si dhe gjithë kriteret ligjore për organizimin dhe strukturën akademike. Për sa më sipër GVJ konstaton se Njësia kryesore dhe njësi bazë përgjegjëse për programin, përmbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik. [Ev.: 13 Tabelat permbledhese Per RVB Informatikë; Takime në institucion].

Shkalla e përmbushjes së standardit

Në përmbushje

Përmbushet pjesërisht


Përmbushet kryesisht

Përmbushet plotësisht

Standardi II.3

Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Departamenti i Informatikës ofron programe studimi në të tre ciklet: Bachelor (2 programe studimi), Master i Shkencave (3 programe studimi), Master Profesional (2 programe studimi) dhe Doktoratë (1 program studimi). Departamenti, për programin e studimit Bachelor në "Informatikë" disponon gjithë informacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Plani mësimor; - Rregullorja e programit të studimeve; - Suplementi i diplomës Bachelor në "Informatikë"; - Programet (syllabuset) e lëndëve; - Rregulloren e diplomimit. <p>[Ev.: 7, 7/1, 7/2, 7/3 Planet Mesimore Bachelor Informatike; 2 Rregullore Programi Studimi Bachelor Informatike; 8 Suplement Diplome Bachelor ne Informatike; 9 Syllabuset Bachelor në Informatikë 2020-2021; 45 Rregullore Diplomimi per Programet e Ciklit I FSHN].</p> <p>Ky informacion i shoqëruar me kuotat dhe kriteret e përvitshme të pranimit përbëjnë informacionin bazë të programit të studimit, i cili disponohet nga Departamenti i Informatikës dhe pjesërisht vihet në dispozicion të studentëve të ciklit Bachelor dhe të kandidatëve për studentë nga shkollat e mesme. Një pjesë e mirë e këtij informacioni ndodhet i disponueshëm në faqen web të FSHN [Ev.: https://fshn.edu.al/departments/departamenti-i-informatikes].</p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Nga analiza e programit të studimit Bachelor në "Informatikë" GVJ konstatoi se ai është i organizuar në lëndë e aktivitete formuese në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Ky program përmban lëndë, aktiviteve formuese sipas disiplinave:</p> <p>A. LËNDË BAZË – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme (32 kredite - rreth 18%)</p>

	<p>B. LËNDË KARAKTERIZUESE –përgatitje për disiplinën shkencore (96 kredite - rreth 53%)</p> <p>C. LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGRUESE – nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje (22 kredite – rreth 12%)</p> <p>D. LËNDË PLOTËSUESE – gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale (22 kredite – rreth 12%)</p> <p>E. DETYRIME PËRMBYLLËSE (8 kredite – rreth 5%)</p> <p>Eventualisht mund t'i lihej më shumë vend praktikës profesionale e cila është parashikuar me 3 kredite ECTS.</p> <p>[Ev.: 7, 7/1, 7/2, 7/3 Planet Mesimore Bachelor Informatike; 9 Syllabuset Bachelor në Informatikë 2020-2021].</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Informatikë” është i organizuar sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Forma e studimit për këtë program është me kohë të plotë dhe realizohet për 3 vite akademike me nga 2 semestra mësimdhënie secili. Përfundimit të këtij programi studimesh i korrespondon grumbullimi i 180 krediteve ECTS, duke realizuar çdo vit 60 kredite (30 kredite për semestër) [Ev.: 7, 7/1, 7/2, 7/3 Planet Mesimore Bachelor Informatike; 9 Syllabuset Bachelor në Informatikë 2020-2021].</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Plani mësimor si elementi bazë i programit të studimit Bachelor në "Informatikë" përmban:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ndarjen e lëndëve sipas aktiviteteve formuese; - Ndarjen e lëndëve sipas viteve dhe semestrave; - Dhënien për secilën lëndë të ngarkesës në orë javore, ngarkesës në kredite, numrit total të orëve, numrit të orëve në auditor; - Ndarjen e ngarkesës në auditor për secilën lëndë në elementët përbërës si leksione, seminare e laboratorë. - Dhënien e mënyrës së shlyerjes së lëndës. <p>[Ev.: 7, 7/1, 7/2, 7/3 Planet Mesimore Bachelor Informatike</p> <p>Në rregulloren e programit të studimit përcaktohen edhe elementë që lidhen me shkallën e detyrueshme të frekuentimit, mënyrën e shlyerjes së lëndëve, provimin e diplomës etj. [Ev.: 2 Rregullore Programi Studimi Bachelor Informatike]. Elementë të tjerë jepen edhe në</p>




	<p>rregulloret e tjera të institucionit [Ev.: 6 Rregullore e UT; 3 Rregullore e Departamentit të Informatikes].</p> <p>GVJ nga shqyrtimi i përmbajtjes së programit mësimor konstaton:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mësimi zhvillohet në 15 javë kalendarike me 20 deri 24 orë/javë; • Ngarkesa mësimore totale është 4500 orë, nga të cilat 1983 orë në auditor (plani i vitit 2020-2023). <p>[Ev.: 28 Plani Mesimor Bachelor Informatike 2022-2023]</p> <p><i>GVJ është i mendimit se eventualisht mund të specifikoheshin edhe elementë që lidhen me ngarkesën në auditor të detyrave apo projekteve të kursit.</i></p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Pranimi i studentëve, procedurat dhe dokumentacioni i pranimit, ndërprerja e studimeve, transferimi dhe ekuivalentimi i studimeve, të drejtat dhe përgjegjësitë e studentëve, tarifat e studimit dhe kalimi i vitit akademik në Departamentin e Informatikës kryhen në përputhje me Rregulloren dhe Statutin e UT-së. Propozimi për kuotat (numrin e studentëve) dhe kriteret e pranimit inicohet nga Departamenti dhe miratohet në instancat e tjera deri në Senat. Kriteret e pranimit janë kriteret specifike që lidhen me elementët e formimit bazë të nevojshëm për ndjekjen e programit të studimit, ndërsa kriteri i përgjithshëm është ai i përcaktuar me VKM dhe që ka të bëjë me notën mesatare. Marrja në konsideratë e elementëve të ndryshëm në kriteret e pranimit realizohet nëpërmjet një sistemi pikëzimi. Për vitin akademik 2020-2021 pikëzimi bazohej në marrjen në konsideratë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 50% të mesatares sipas VKM; - 15% të mesatares së matematikës nga kurrikula bërthamë; - 5% mesatarja e fizikës nga kurrikula bërthamë; - 10% mesatarja e TIK nga kurrikula bërthamë; - 20% nota e Matematikës nga kurrikula me zgjedhje e vitit III; <p>GVJ u informua se të gjithë informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve jepen në Rregulloren e programit të studimit Bachelor në “Informatikë” dhe në Rregulloren e UT si dhe një numër elementësh janë të aksesueshëm në faqen web të FSHN.</p> <p>[Ev.: 6 Rregullore e UT; 2 Rregullore Programi Studimi</p>

	<p>Bachelor Informatike; https://fshn.edu.al/info/kritere]. GVJ është i mendimit se praktikat e prezantuara për transferim studimesh dëshmojnë për procedura të qarta dhe transparente të zbatuara nga institucioni. [Ev.: 60 Shqyrtimi i Dosjeve Dege II Transferime Cikli I Cikli II; 59 Ekuivalentime Kategoria Transferime Dege Te Dytja].</p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Elementë më të detajuar për përgjegjësin (titullarin) e lëndës, semestrin kur zhvillohet, njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti, objektivat, elementët e mësimdhënies, detyrimet për frekuentimin, literaturën, mënyrën e shlyerjes së lëndës dhe peshën e elementëve të ndryshëm në vlerësimin final jepen në syllabuset e lëndëve [Ev.: 9 Syllabuset Bachelor në Informatikë 2020-2021]. GVJ konstatoi se syllabuset e lëndëve përmbajnë gjithë elementët e nevojshëm përcaktuar në VKM Nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë”, si dhe VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”. Megjithatë GVJ është i mendimit se literatura bazë dhe ajo e rekomanduar jo për të gjithë syllabuset është specifikuar në mënyrë të plotë (përfshirë vitin e botimit) dhe ka raste kur kjo literaturë nuk është e viteve të fundit.</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Referuar RVB dhe dokumentacionit në dispozicion, programi i studimit Bachelor në “Informatikë”, është përshtatur në mënyrë të vazhdueshme me ndryshimet në aktet ligjore e nënligjore në fushën e arsimit të lartë. Përsa i përket planit mësimor ndryshimet kanë qenë të kufizuara pa çuar në një ristrukturim të plotë të programit që të kalonte kufirin prej 20% tej të cilit kërkohet miratimi nga MAS [Ev.: RVB; Takime në institucion]. Ndër përmirësimet e planit mësimor mund të përmenden:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përmirësimi i syllabuseve për të pasqyruar zhvillimet e shpejta në fushën e informatikës; - Ristrukturim i disa lëndëve; - Ndryshime në raportin ndërmjet elementëve formues brenda lëndëve të caktuara. <p>Gjatë takimit më personelit akademik të programit të studimit GVJ u informua në përmirësimet e syllabuseve kanë kontribut edhe studentët duke dhënë mendimet e tyre [Ev.: Minuta takimi Bsc Informatike dhe Teknologji Informati- UT].</p>




Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht

Standardi II.4


Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	GVJ konstatoi se ngarkesa mësimore është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi. Ngarkesa është përcaktuar në bazë të sistemit të krediteve ECTS, duke parashikuar 30 kredite në semestër. Nga totali prej 4500 orësh mësimore për të tre vitet e studimit, rreth 44% e tyre janë parashikuar në auditor. Në këtë mënyrë, duke ju referuar të tre viteve akademike, rezulton që ngarkesa javore në auditor të luhatet në intervalin 20 deri 24 orë. [Ev.: 7, 7/1, 7/2, 7/3 Planet Mesimore Bachelor Informatike].
Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.	Nga shqyrtimi i DVV dhe takimet në institucion, GVJ është i mendimit se përmbajtja e veprimtarive dhe shpërndarja e lëndëve mundësojnë, njohuri, aftësi dhe kompetenca të cilat garantojnë formimin e nevojshëm për punësim të studentëve. Në këtë drejtim, GVJ konstatoi se ka një tendencë në rritje të punësimit të studentëve që në vitet e ndjekjes së programit të studimit duke kaluar nga 9% për studentët e vitit të parë në 32% për studentët e vitit të tretë [Ev.: 11 Studimi i Tregut të Punës Janar 2022]. <i>GVJ është i mendimit që një kontribut më të madh mund të jepte rritja e peshës së praktikës profesionale.</i>
Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.	Nga vlerësimi i planit mësimor [Ev.: 7, 7/1, 7/2, 7/3 Planet Mesimore Bachelor Informatike], GVJ konstatoi se shpërndarja e lëndëve të programit të studimit në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional në fushën e informatikës. Eventualisht, mund të kishte një detajim duke integruar në planin mësimor edhe elementë të tillë si detyrat e kursit. Gjithashtu GVJ është i mendimit që me interes do të ishte integrimi në lëndë të ndryshme edhe i projekteve me synimin edhe të inkurajimin e punës në grup.

	Edhe shtimi (apo parashikimi në syllabus) i detyrave të kursit (apo projekteve) në një numër lëndësh do të kontribonte në një përvetësim më të mirë të programit (p.sh në lëndët GIS, Bazat e infografisë, Programim C++ etj).
Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	GVJ është i mendimit se në përgjithësi struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor [Ev.: 7, 7/1, 7/2, 7/3 Planet Mesimore Bachelor Informatike]. Megjithatë, <i>GVJ do të rekomandonte një rritje të peshës së detyrave të kursit apo projekteve si dhe rritje të peshës së praktikës në elementët formues të programit. Gjithashtu kontribut pozitiv do të kishte edhe parashikimi (apo rritja) e numrit të orëve të seancave laboratorike.</i>
Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	GVJ është i mendimit se ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. Nga vizita në institucion dhe takimet me studentë e personelin akademik GVJ ka konstatuar një përputhje të mirë të këtij program studimi me programe analoge [Ev.: Takime në institucion]. Megjithatë nga takimet me studentët rezultojnë se pritshmëritë e tyre janë më të mëdha për futjen e teknologjive të reja [Ev.: Minuta takimi Bsc Informatike dhe Teknologji Informacioni- UT].
Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.	Nga shqyrtimi i syllabuseve të lëndëve të këtij programi studimi GVJ konstatoi se, përjashtuar disiplinat bazë ku ndryshimet janë më të kufizuara, ato përgjithësisht janë të përditësuara me literaturë bashkëkohore. Në rastin e programit të studimit në fushën e informatikës, kjo vjen edhe si domosdoshmëri për arsye të zhvillimeve të shpejta në këtë fushë. Megjithatë <i>GVJ është i mendimit se literatura bazë dhe ajo ndihmëse jo për të gjithë syllabuset është specifikuar në mënyrë të plotë (përfshirë vitin e botimit) dhe ka raste kur kjo literaturë nuk është e viteve të fundit.</i> [Ev.: 9 Syllabuset Bachelor në Informatikë 2020-2021 skanuar]
Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.	Programi i studimit Bachelor në “Informatikë”, i vlerësuar në përmbajtje nga GVJ, garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për një program studimi të ciklit të parë. Nga takimet me studentët rezultojnë se realizimi faktik i programit të studimit përmbush kërkesat dhe është brenda pritshmërive të tyre. Gjithashtu studentët vlerësuan pozitivisht menaxhimin nga ana e personelit akademik të mësimin online

	<p>[Ev.: Takim me studentët: Minuta takimi Bsc Informatike dhe Teknologji Informacioni- UT]. <i>Eventualisht rritja e kontributit të seancave laboratorike detyrave të kursit/projekteve si dhe rritja e peshës së praktikës profesionale dhe bërja e saj e detyrueshme do të përmirëson më tej formimin në këtë program.</i></p>			
<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Referuar DVV dhe takimeve në institucion, GVJ është i mendimit se përmbajtja e programit të studimit garanton si punësimin direkt mbas diplomimit ashtu edhe vazhdimin e studimeve të ciklit të dytë. Një pjesë e mirë e studentëve të diplomuar në këtë program studimi vazhdojnë studimet Master i Shkencave në Informatikë, Master i Shkencave në Teknologji Informacioni, Master i Shkencave në Mësuesi Informatike për arsimin e mesëm të lartë, Master Profesional në Informatike Biznesi ose Master Profesional në Teknologji Informacioni ose në programe Master të IAL-ve të tjera. Konstatohet që studentët, duke shfrytëzuar edhe kërkesat e larta të tregut për specialistë në fushën e informatikës, punësohen (në mjaft raste që para përfundimit të ciklit Bachelor) dhe në programet Master rezultojnë në një masë të madhe të punësuar [Ev.: Takime me studentët; https://fshn.edu.al/departments/departamenti-i-informatikes]</p>			
<p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>GVJ konstatoi se institucioni në përgjithësi si dhe FSHN dhe Departamenti i Informatikës në veçanti, nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit me partnerë të ndryshëm nga tregu i punës, kanë synuar nga njera anë përshtatjen sa më të mirë të programit të studimit me kërkesat e tregut e punës dhe nga ana tjetër ofrimin dhe njohjen e studentëve me këtë treg. [Ev.: 25 Marrëveshje të FSHN me kompani, institucione të tjera 2016-2021]. Gjithashtu angazhimi i personelit akademik me kontratë i cili është i punësuar në institucione apo biznese të ndryshme kontribuon në transmetimin në Departament të nevojave të tregut të punës për formimin në fushën e informatikës [Ev.: RVB].</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																																												
Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	<p>Sipas përcaktimeve ligjore, personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës, kriter i cili plotësohet nga stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi [Ev.: 13 Tabelat permbljedhese Per RVB Informatikë].</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Kualifikimi i stafit akademik të PS</th> <th colspan="2">2018-2019</th> <th colspan="2">2019-2020</th> <th colspan="2">2020-2021</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof. Dr</td> <td>3</td> <td>1</td> <td>3</td> <td>-</td> <td>3</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Prof. Asoc.</td> <td>5</td> <td>-</td> <td>3</td> <td>-</td> <td>4</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Dr/Phd</td> <td>20</td> <td>2</td> <td>21</td> <td>1</td> <td>22</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Msc.</td> <td>16</td> <td>32</td> <td>15</td> <td>26</td> <td>14</td> <td>26</td> </tr> <tr> <td>Gjithsej</td> <td>44</td> <td>35</td> <td>42</td> <td>27</td> <td>43</td> <td>27</td> </tr> </tbody> </table> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Total PAE</th> <th>Total PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2020-2021</td> <td>43</td> <td>27</td> </tr> <tr> <td>2019-2020</td> <td>42</td> <td>27</td> </tr> <tr> <td>2018-2019</td> <td>44</td> <td>35</td> </tr> </tbody> </table> <p>Mbulimi i programit në përqindje sipas viteve akademike referuar numrit të PA të angazhuar është:</p> <p>Për vitin akademik 2020-2021, 62% PAE dhe 38% PAK; Për vitin akademik 2019-2020, 61% PAE dhe 39% PAK; Për vitin akademik 2018-2019, 56% PAE dhe 44% PAK;</p> <p>Ndërsa përsa i përket ngarkesës mësimore të realizuar, për vitin 2020-2021 ajo është përballuar në masën rreth 71% nga personeli akademik efektiv (PAE) dhe 29% nga personeli akademik me kontratë(PAK).</p> <p>GVJ është i mendimit, se Departamenti i informatikës duhet të bëjë përpjekje për zvogëlimin e ngarkesës mësimore të realizuar nga personeli akademik me kontratë.</p> <p>Nga analiza e ngarkesës së mësimore të personelit akademik, GVJ konstatoi se ngarkesa në orë mësimore në auditor është relativisht e lartë. Në ndonjë rast kjo ngarkesë kalon kufirin e normës mësimore plus një mbingarkesë prej 200 orësh suplementare në auditor (përcaktuar në Udhëzimin Nr.29, datë 10.9.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të</p>	Kualifikimi i stafit akademik të PS	2018-2019		2019-2020		2020-2021		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof. Dr	3	1	3	-	3	-	Prof. Asoc.	5	-	3	-	4	-	Dr/Phd	20	2	21	1	22	1	Msc.	16	32	15	26	14	26	Gjithsej	44	35	42	27	43	27	Viti akademik	Total PAE	Total PAK	2020-2021	43	27	2019-2020	42	27	2018-2019	44	35
Kualifikimi i stafit akademik të PS	2018-2019		2019-2020		2020-2021																																																								
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																																							
Prof. Dr	3	1	3	-	3	-																																																							
Prof. Asoc.	5	-	3	-	4	-																																																							
Dr/Phd	20	2	21	1	22	1																																																							
Msc.	16	32	15	26	14	26																																																							
Gjithsej	44	35	42	27	43	27																																																							
Viti akademik	Total PAE	Total PAK																																																											
2020-2021	43	27																																																											
2019-2020	42	27																																																											
2018-2019	44	35																																																											

	<p>personelit akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë”). Gjithashtu ka raste kur numri i lëndëve tejkalon numrin e lëndëve vjetore apo semestrale të përcaktuar në Udhëzimin Nr.29. GVJ është i mendimit se një ngarkesë mësimore e tillë vështirëson angazhimin e personelit akademik në kërkimin shkencor.</p> <p>GVJ rekomandon shtimin e personelit akademik efektiv.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Nga analiza e të dhënave të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi, GVJ konstatoi se ky personel ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit dhe realizimin e procesit mësimor. Theksojmë se edhe personeli akademik me kontratë i angazhuar në këtë program studimi plotëson kushtet ligjore. Megjithatë, duke patur në konsideratë faktin se personeli akademik me kontratë përbën (për tre vitet e fundit) 38 deri në 44% të personelit akademik të programit kërkohet që tendenca zbritëse e angazhimit të PAK të vazhdojë në vitet në vijim për të arritur në kushtin që ky numër të mos kalojë 30% të personelit akademik total të angazhuar [Ev.: 13 Tabelat permbledhese Per RVB Informatikë].</p> <p>Gjithashtu do të ishte me vend që edhe në dy raste (lëndët Organizim kompjuteri & arkitekturë dhe Bazat e informatikës) ku aktualisht titullari i lëndës është i kategorisë As.Lektor (MSc), të synohej një shkallë më e lartë [Ev.: 9 Syllabuset Bachelor në Informatikë 2020-2021]</p>
<p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Nga shqyrtimi CV të stafit akademik, GVJ konstatoi se fushat e kualifikimit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi përputhen me modulet/lëndët që mbulojnë [Ev.: 14 CV Stafit Akademik PAE; 15 CV Stafit Akademik PAK]. Nga takimet në institucion dhe DVV, GVJ u informua se një pjesë e personelit akademik të kategorisë As.Lektor është i angazhuar në kryerjen e studimeve të doktoratës [Ev.: Takime në institucion]. Një element pozitiv i konstatuar është dhe qëndrueshmëria e stafit akademik në vite, sidomos për stafin akademik efektiv (verifikuar për tre vitet e fundit).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe</p>	<p>Praktika profesionale për këtë program studimi rezulton e integruar me provimin e diplomës. Personeli akademik me kontratë ka shërbyer si urë lidhëse me institucionet shtetërore dhe biznesin për të mundësuar kryerjen e praktikës profesionale. Nga ana e Departamentit të Informatikës pretendohet që me planin e ri mësimor programi i studimit Bachelor në Informatikë, të ketë të përfshirë praktikën mësimore si lëndë e veçantë, si rrjedhojë numri i praktikave</p>

mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	dhe bashkëpunimeve pritet që të jetë i konsiderueshëm me numrin e studentëve në këto programe studimi. Megjithatë, nga shqyrtimi i planit mësimor të propozuar për vitin 2022-2023, GVJ konstaton se përsëri praktika është pjesë e zërit "Temë diplome" në planin mësimor duke hequr mundësinë e një vlerësimi të veçantë i cili do të pasqyrohej edhe në rezultatet e studentëve. [Ev.: 28 Plani Mesimor Bachelor Informatike 2022-2023]
--	--

Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Personeli ndihmës akademik i Departamentit të Informatikës është i angazhuar kryesisht për mbulimin e seancave praktike laboratorike të lëndëve të përfshira në programin e studimit. Në mënyrë të veçantë garantohej mirëmbajtja e bazës materiale kompjuterike si dhe instalimi i software-ve, menaxhimi i llogarive të studentëve në serverat e laboratorëve etj, si dhe asistohen studentët gjatë zhvillimit të seancave laboratorike. [Ev.: Takime në institucion]. Referuar RVB, mbulimi profesional i zhvillimit të orëve laboratorike garantohej nëpërmjet drejtimit të tyre nga stafi akademik (PAE/PAK) i cili është ngarkuar për zhvillimin e tyre në kuadër të ngarkesës mësimore [Ev.: 17 CV Stafi Ndihmes Akademik; RVB; Takime në institucion].
---	--

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.</p>	<p>GVJ u informua se Departamenti i Informatikës inkurajon dhe mbështet të gjithë format dhe metodat në mësimdhënie të cilat kontribuojnë në aftësimin e studentit. Mësimdhënia organizohet bazuar në aktet rregullatore si Statuti dhe Rregullorja e UT, Rregullorja e Departamentit të Informatikës dhe Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në "Informatikë". Në dokumentin mbi "Metoda inovative të zhvilluara dhe përdorura gjatë mësimdhënies në departamentin e Informatikës", përshkruhen metodat inovative të përdorura nga personeli akademik i departamentit duke synuar një mësimdhënie me në qendër studentin e cila integron fazat në vijim:</p> <ol style="list-style-type: none"> a) Pedagogu drejton, orienton, udhëzon. b) Studenti përfshihet, vepron. c) Pedagogu i vë studentët të bëjnë pyetje. d) Studenti bën pyetje dhe kërkon përgjigje. e) Pedagogu bisedon, diskuton, shkëmben ide. f) Studenti diskuton, arsyeton, argumenton. g) Pedagogu i përfshin nxënësit në vlerësim dhe vetvlerësim. h) Pedagogu menaxhon, organizon. <p>Një sfidë e veçantë, me elementë të së cilës u njoh GVJ, ka qenë organizimi i mësimin online në kushtet e pandemisë. Ky problem u trajtua në rang institucioni duke hartuar udhëzuesin për mësimin në distancë si dhe trajnime për stafin akademik për përdorimin e platformave përkatëse. Për vetë natyrën e programit të studimit Bachelor në "Informatikë", studentët shprehën opinionin e tyre se mësimi online funksionoi shumë mirë dhe se ata kanë përfituar shumë në këto 3 vite.</p> <p>[Ev.: 33 Udhëzues i Universitetit të Tiranës për përdorimin e sistemit të mësimin në distancë; 32 Metoda inovative të zhvilluara dhe përdorura gjatë mësimdhënies në departamentine Informatikës; 34 Trajnime per stafin akademik mbi platformën Microsoft Teams;</p>

	<p>https://api.fshn.edu.al/uploads/Udhezues_i_UT_per_mesi_min_ne_distance_f2c2b81980.pdf; Takim me studentët]</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Departamenti i Informatikës është përgjegjës për realizimin e procesit mësimor për programin e studimit Bachelor në "Informatikë". Në këtë aspekt është dhe përgjegjësi kryesor për monitorimin e cilësisë së mësimdhënies. Kjo detyrë drejtohet nga Përgjegjësi i Departamentit të Informatikës, i cili në fund të çdo semestri, analizon punën e të gjithë anëtarëve të stafit akademik.</p> <p>Këtij qëllimi i shërben dhe plotësimi i përmbledhëses së veprimtarisë së pedagogut në të cilin pasqyrohen elementë të tillë si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të dhëna për pedagogun • Mësimdhënia (lista e lëndëve që zhvillon pedagogu sipas cikleve të studimit) • Udhëheqje diplomash • Produkte të kërkimit/ veprimtarisë krijuese (Tekste/Libra/ Monografi, Artikuj në revista shkencore, produkte arti/teknike, prezantime në konferenca shkencore, pjesëmarrje në projekte kërkimi) • Njohje profesionale (çmime, prezantues i ftuar, certifikata) • Shërbime (Shërbime për fakultetin/universitetin, Shërbime profesionale, Shërbime publike ose për komunitetin) <p>Mbi këtë bazë plotësohet edhe matrica përmbledhëse e vlerësimit e cila integron edhe vlerësimin nga përgjegjësi i departamentit.</p> <p>Të gjithë këta elementë janë pjesë e Paketës së instrumenteve të cilësisë. GVJ u informua se një kontribut të qënësishëm në këtë proces jep dhe Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK) e cila ka si funksion kryesor bashkëpunimin për sigurimin e cilësisë së mësimdhënies [Ev.: 36 Paketa e Instrumentave të Cilësisë, RVB, Takime në institucion].</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve,</p>	<p>GVJ konstatoi se garantimi i përfshirjes së studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies dhe të vlerësimit të dijeve mundësohet nëpërmjet pyetësorëve:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi i lëndës nga studenti; • Vlerësimi për pedagogun

përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.

Këta pyetsorë plotësohen në fund të çdo semestri (përpara zhvillimit të provimit). Nëpërmjet këtyre pyetsorëve merret opinioni i studentit në lidhje me strukturimin e lëndëve, metodat e të nxënit dhe të mësimdhënies, logjistikën e auditorëve, literaturën e përdorur, materialet mësimore, cilësinë e mësimdhënies, vlerësimin e studentit, pedagogun (metodat e mësimdhënies, mënyrën e spjegimit, përgjigjet e pyetjeve etj.), detyrimet e lëndës (detyrat, komentet e marra) [Ev.: 36 Paketa e Instrumentave të Cilesise; 74 Raporti i Vleresimit Te Lendeve Semestri I 20-21]. Trajtimi i ankimimeve garantohet në Rregulloren e UT ku nenet 50 dhe 51 specifikohet [Ev.: 6 Rregullore e UT]:

- Studenti ka të drejtë të ankohet për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit. Ankesa i paraqitet me shkrim përgjegjësit të departamentit brenda 24 orëve nga data e zhvillimit të provimit.
- Përgjegjësi i departamentit nëse verifikon shkelje të korigjueshme, në bashkëpunim me komisionin e provimit, bëjnë korigjimet e duhura.
- Në rast se përgjegjësi i departamentit e gjykon se e ka të pamundur të marrë vendim, i propozon dekanit i cili pasi është njohur me të gjithë procedurën merr vendim. Nëse ai e gjen të drejtë ankesën e studentit, anulon provimin dhe merr vendim për rihvillimin e provimit.
- Studenti ka të drejtë të ankohet për rezultatin përfundimtar të provimit. Ankesa i paraqitet me shkrim përgjegjësit të departamentit brenda 48 orëve nga marrja dijani e rezultatit të provimit, i cili bën verifikimet e duhura dhe kur e gjen të pamundur zgjidhjen e ankesës, vë menjëherë në dijeni dekanin.
- Dekani, brenda 48 orësh nga marrja dijani për ankesën nga përgjegjësi i departamentit, ngre një komision ad-hoc i cili bën verifikimin e pretendimeve të studentit. Me miratim të dekanit/drejtorit, komisioni përcakton vlerësimin përfundimtar të provimit.

Nga takimi me studentët GVJ u informua se ka patur raste kur ata kanë patur mundësinë të bëjnë rishikimin e provimit dhe që në disa raste ka ndryshuar dhe nota përfundimtare [Ev.: **Minuta takimi Bsc Informatike dhe Teknologji Informacioni- UT: takimi me studentët**].

Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në

Të dhënat e mbledhura të pyetsorëve përpunohen nga DSBCK duke garantuar edhe ruajtjen e anonimatit. Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK) pranë Fakultetit



mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.

të Shkencave të Natyrës (FSHN) u krijua në Shkurt të vitit 2020, ndërsa aktiviteti i zyrës ka filluar në vitin 2021. GVJ u informua se pjesëmarrja e studentëve në plotësimin e pyetsorëve ka qenë relativisht e ulët (e rendit 30-40%). DSBCK harton raport të cilin ja dërgon Dekanatit. Pas kësaj informohen pedagogët nga ana e Departamentit për çdo lëndë për problematikat që janë hasur [Ev.: **Minuta takimi Bsc Informatike dhe Teknologji Informatike- UT**]. Të dhënat e përfuara nga këto vlerësime (raporte, pyetësor) pas përpunimit statistikor dhe cilësor, shfrytëzohen gjerësisht në mbështetje të procesit të vlerësimit të performancës akademike të secilit pedagog në përfundim të vitit akademik, si dhe në lidhje me lëndët e programit që ndjekin, por edhe të personelit ndihmës akademik dhe administrativ si dhe shërbimeve që ofrohen nga institucioni dhe njësitë përbërëse të tij [Ev.: **Takime në institucion**].

GVJ u informua mbi publikimin në mënyrë periodike nga ana e DSBCK të raporteve të analizës së pyetsorëve, duke i vënë kështu në dispozicion si të personelit akademik ashtu edhe të studentëve apo dhe gjithë instancave të tjera të interesuara [Ev.: https://api.fshn.edu.al/uploads/RAPORTI_I_VLERESIMIT_TE_LENDEVE_SEMESTRI_I_20_21_Nivel_Fakultetit_dhe_Departamenti_7d28de74fd.pdf; https://api.fshn.edu.al/uploads/Raporti_mbi_sondazhin_e_mesimit_online_semestri_II_v_a_2019_2020_9faf3f5171.pdf |

Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmeve të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.

Në veprimtarinë e saj DSBCK, zbaton “Rregulloren për Sigurimin e Cilësisë në Universitetin e Tiranës”, mbështetur njëkohësisht në “Manualin e Cilësisë” dhe “Paketën e Instrumentave të Cilësisë”, miratuar nga Senati i Universitetit të Tiranës më 23 Dhjetor 2020. Përpunimi i rezultateve të pyetsorëve kontribuon jo vetëm në adresimin e problematikave, por edhe në evidentimin e praktikave më të mira me synim përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies. Nga ana tjetër, referuar RVB, DSBC në bashkëpunim me strukturat e tjera përgjegjëse (Komisioni Institucional për Vlerësimin e Standarteve të Cilësisë) organizojnë trajnime tematike në lidhje me metodat e mësimdhënies apo në funksion të përmirësimit të cilësisë, sipas një kalendari që hartohet për këtë qëllim në fillim të vitit akademik [Ev.: **39 Raporti mbi sondazhin e mesimit online; Raport Vjetor DSBCK 2020_2021**].

Shkalla e përmbushjes së standardit

Përmbushet

Pjesërisht

Kryesisht

Plotësisht

X

Standardi III.2**Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	<p>Baza e realizimit të procesit mësimor në auditor është ora mësimore. Ndër format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët dhe detyrat e kursit. GVJ konstatoi se format klasike të mësimdhënies ndërthuren me metoda të ndryshme bashkëkohore. Gjithashtu ka raste kur organizohen edhe leksione nga lektorë të ftuar. Nga diskutimi me pedagogët dhe studentët e programit, GVJ u informua për mënyrën e zhvillimit të lëndëve të ndryshme dhe në mënyrë të veçantë për peshën e elementëve formues të parashikuar në secilën lëndë. Në këtë aspekt, <i>GVJ do të rekomandonte një rritje të peshës së detyrave të kursit apo projekteve si dhe rritje të mëtjeshme të peshës së praktikës në elementët formues të programit.</i> Gjithashtu kontribut pozitiv do të kishte edhe parashikimi (apo rritja) e numrit të orëve të seancave laboratorike.</p> <p>Gjithashtu, nga takimi me studentët, GVJ u informua se aplikohen forma të punës në grup për realizimin e një detyre apo projekti, duke inicuar zhvillimin e elementëve të tillë si menaxhimi i ndarjes së punës, referimi i materialit përfundimtar nga grupi etj. [Ev.: RVB; Minuta takimi Bsc Informatike dhe Teknologji Informacioni- UT].</p>
Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.	<p>Për t'ju përgjigjur diversitetit dhe nevojave të studentëve, çdo vit studimi i programit Bachelor në "Informatikë" ka nga një Kujdestar Akademik i cili është në kontakt të vazhdueshëm me ta, për çdo nevojë të tyre përgjatë gjithë periudhës së studimeve. Po ashtu, në çdo lëndë, nga ana e personelit akademik, mundësohet komunikimi me studentët jo vetëm gjatë realizimit të procesit mësimor në auditor, por edhe jashtë auditorit nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike (e-mail, rrjete sociale etj.). Në këtë mënyrë, GVJ konstatoi se personeli akademik ka qenë në vazhdimësi i disponueshëm për zhvillimin e konsultimeve për çështje specifike si dhe për t'ju përgjigjur pyetjeve e shqetësimeve individuale të studentëve në lidhje me procesin mësimor. Në mënyrë të veçantë, gjatë periudhës së pandemisë, personeli akademik ka mundësuar komunikimin e vazhdueshëm me studentët si në kuadër të zhvillimit të lëndëve dhe problematikave të zhvillimit të tyre</p>

	ashtu edhe në drejtim të problematikave specifike të tyre [Ev.: Takime në institucion].
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se për përmirësimin e kompetencave didaktike, përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve, veprohet në disa drejtime:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përmirësimi i infrastrukturës së mësimdhënies, duke ofruar auditorë të paisur me teknologji bashkëkohore të mësimdhënies si dhe nëpërmjet modernizimit të bazës laboratorike dhe mbajtjes së saj në gatishmëri për zhvillimin e aspekteve praktike të procesit mësimor; • Krijimi i oportuniteteve për stafin akademik nëpërmjet mobiliteteve të ndryshme në institucione të arsimit të lartë jashtë vendit për të përsosur metodat e mësimdhënies; • Realizimi i trajnimeve, pjesëmarrja në konferenca, aksesit në platforma kombëtare dhe ndërkombëtare, përmirësime të vazhdueshme në pedagogji; • Përdorimi i modeleve të vlerësimit të harmonizuara me të mësuarit me në qendër studentin; • Përdorimi i platformave inovative të të mësuarit (përdorimi i Microsoft Teams, etj). <p>[Ev.: RVB; 47 Detajet e infrastrukturës të Departamentit të Informatikës; 16 Specifikimet e Laboratoreve; 32 Metoda inovative të zhvilluara dhe përdorura gjatë mësimdhënies në departamentine Informatikës; 55 Komunikim në Microsoft Teams për ngarkimin e leksioneve (literaturës bazë); Takime në institucion]</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Nga shqyrtimi CV të stafit akademik, GVJ konstatoi se fushat e kualifikimit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi përputhen me modulet/lëndët që mbulojnë dhe se kanë shkallën e kërkuar të kualifikimit për të mbuluar zhvillimin cilësor të mësimin në ciklin e studimeve Bachelor [Ev.: 14 CV Stafi Akademik PAE; 15 CV Stafi Akademik PAK]. Gjithashtu nga takimi i zhvilluar me studentët, rezultoi se mendimi i tyre është se personeli akademik është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit. [Ev.: Takime në institucion].</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë</p>	<p>GVJ konstatoi se vlerësimi i metodave të mësimdhënies është objekt i diskutimeve dhe trajtimit të vazhdueshëm si nga vetë pedagogët për lëndët që mbulojnë ashtu edhe nga studentët</p>

<p>periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>(nëpërmjet pyetsorit të vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies). Në këtë drejtim, një informacion i çmuar përfitohet nga përpunimi i të dhënave të pyetsorit të vlerësimit të mësimdhënies së lëndëve për çdo program studimi i cili plotësohet dy herë në vit dhe shërben si bazë për përmirësime të mëtejshme. Konkluzionet e dala gjatë përpunimit të të dhënave të pyetsorëve kanë qenë objekt i hartimit të një plani masash nga ana e Departamentit i cili është dhe përgjegjës për ndjekjen e ecurisë së përmirësimeve të propozuara [Ev.: Takime në institucion].</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.</p>	<p>Nga takimet me studentët dhe pedagogët e angazhuar në këtë program studimi GVJ konstatoi se personeli akademik përdor metoda të ndryshme (që varen edhe nga specifika e lëndëve) për të rritur interesimin për orën e mësimit dhe për të rritur shkallën e përvehtësimit të informacionit të transmetuar. Shpjegimi i leksionit shoqërohet me prezantime Powerpoint si dhe me materiale të tjera ilustruese, ndërsa pjesët praktike shoqërohen me diskutime në orët e seminareve si dhe me zgjidhje të problemeve të caktuar në seancat laboratorike. Kjo lidhet edhe me specifikën e lëndëve të programit të studimit ku ka një rol dhe peshë të veçantë përdorimi i bazës laboratorike kompjuterike. Një sfidë e veçantë ka qenë zhvillimi i orëve të mësimit në kushtet e pandemisë. Në këto kushte u përdor kryesisht platforma Microsoft Teams nëpërmjet të cilës zhvillohej procesi mësimor si dhe postoheshin edhe materialet për çdo temë mësimore. Në këtë mënyrë u arrit të tejkaloheshin vështirësitë lidhur me zhvillimin e mësimit online dhe u mundësua përvehtësimit i programit në një shkallë të kënaqshme, gjë e cila u konfirmua dhe nga takimi me studentët [Ev.: 32 Metoda inovative të zhvilluara dhe përdorura gjatë mësimdhënies në departamentine Informatikës; 55 Komunikim në Microsoft Teams për ngarkimin e leksioneve (literaturës bazë); Takime në institucion].</p>
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Nga takimet me studentët dhe pedagogët e programit të studimit Bachelor në “Informatikë”, GVJ konstatoi se ka një tendencë në rritje për angazhimin e studentëve në punë praktike të cilat inkurajojnë sensin e autonomisë dhe synojnë zgjidhjen e problemeve të caktuar [Ev.: Takime në institucion]. Ky element konkretizohet nëpërmjet detyrave të kursit dhe punëve laboratorike. Në rastin e detyrave të kursit, të cilat në një numër rastesh organizohen edhe në grup, nuk mungon edhe ndjekja e vazhdueshme nga ana e pedagogut përkatës dhe asistimi prej tij për tejkalimin e problematikave. Nga takimi me studentët GVJ u informua se ndërveprimi me pedagogët ka qenë shumë</p>

	i frytshëm, si në kushtet e zhvillimit normal të procesit mësimor, ashtu dhe në periudhën e pandemisë [Ev.: RVB, Takime në institucion].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3	
Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Nga vizita e realizuar në institucion si dhe nga informacioni i disponueshëm në DVV, GVJ konstatoi se procesi mësimor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht. [Ev.: Vizita e ambienteve].
Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	Referuar RVB dhe nga vizita e ambienteve, GVJ konstatoi se sallat e leksioneve, seminareve, laboratorëve, atelieeve, studiove etj. janë të pajisura me mjetet e nevojshme didaktike si: kompjutera, video-projektor, ekrane projektimi, flipchart, servera etj. duke mundësuar që mënyra e realizimit të mësimdhënies të bëhet me metoda e teknologji bashkëkohore dhe në përputhje me specifikat e lëndëve. Gjithashtu, baza laboratorike kompjuterike garanton një zhvillim cilësor të procesit mësimor [Ev.: RVB; Vizita e ambienteve; 47 Detajet e infrastrukturës të Departamentit të Informatikës; 16 Specifikimet e Laboratoreve].
Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.	Mësimdhënia dhe përvehtësimi i dijeve, për nga vetë natyra e programit të studimit Bachelor në “Informatikë”, bazohet në një bazë informatike dhe infrastrukturë të konsoliduar IT, prania dhe funksionimi i të cilës u konstatua në institucion dhe nga GVJ. Për më tepër, një infrastrukturë e tillë ka kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në organizimin e mësimdhënies dhe përvehtësimin e temave mësimore edhe gjatë pandemisë [Ev.: Takime në institucion, Vizita e ambienteve]. GVJ është i mendimit se ndër elementët me kontribut në organizimin dhe zhvillimin e procesit mësimor si dhe një komunikim efektiv në shërbim të këtij procesi, mund të përmenden [Ev.: RVB, Vizita e ambienteve].

	<ul style="list-style-type: none"> • Lidhja e internetit Wi-Fi dhe fikse e cila ofrohet në hapësirat e FShN; • Laboratorët e kompjuterave në dispozicion të studentëve; • Adresat zyrtare të email-it të personelit akademik, personelit ndihmësakademik dhe studentëve; • Salla e posaçme e ambienteve të bibliotekës që shfrytëzon bazën kompjuterike dhe lidhjen e internetit; • Paisja me kompjutera dhe mjete printimi e personelit akademik.
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Nga takimet me personelin akademik dhe studentët, GVJ u informua se literatura bazë është e disponueshme në gjuhën shqipe në formën fizike. Gjithashtu studentëve u vihen në dispozicion nga ana e pedagogëve edhe leksionet (të shkruara ose prezantime Powerpoint), të cilat përmbajnë një informacion më të përditësuar.</p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Biblioteka e FSHN, një nga më të vjetrat në institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri, disponon një numër të madh titujsh në gjuhë të ndryshme: rreth 76000 libra, dispensa e disertacione në fushën e shkencave të natyrës si dhe mbi 20000 njësi periodikësh. Referuar RVB dhe konfirmuar gjatë vizitës në institucion biblioteka e FSHN-së ofron:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Sallën Fond i Hapur i Librit - Sallën Fond i Hapur i Periodikut - Ambjent shërbimi i Fondit Kryesor - 140 vende studimi - 2 kompjutera për studentët <p>Aksesimi online në këtë bibliotekë mund të bëhet edhe me anë të adresës elektronike zyrtare [Ev.: 42 Informacion Biblioteka FSHN; RVB, Vizita në Bibliotekë].</p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përfaqësuara me programin e studimit.</p>	<p>Për vetë zhvillimet e shpejta të informatikës, studentëve u vihet në dispozicion edhe një literaturë e gjerë ndihmëse e cila është e disponueshme pjesërisht në bibliotekën fizike të FSHN dhe në një masë më të gjerë në bibliotekat online ku FSHN ka akses siç është biblioteka dixhitale JSTOR si dhe Biblioteka digjitale universitare U-Library [Ev.: Takime në institucion; Vizita në bibliotekë; https://ulibrary.rash.al/; https://unitir.edu.al/biblioteka-online/]</p>

<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>GVJ u njoh me laboratorët në shërbim të procesit mësimor për programin e studimit Bachelor në “Informatikë” dhe konstatoi se ata janë të paisur me kompjutera të kohës dhe me softuerët e nevojshëm për të realizuar në mënyrë cilësore elementët e procesit mësimor si punët e laboratorit, detyrat e kursit dhe projektet. GVJ u informua se studentët mund të shfrytëzojnë gjerësisht laboratorët e FSHN gjatë orarit zyrtar 8.00-20.00 [Ev.: 52 Rregullore Bibliotekes-FSHN; Vizita e ambienteve; RVB].</p>			
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>GVJ u informua se, megjithëse FSHN nuk disponon një platformë të vetën on-line e cila të integrojë gjithë elementët e jetës studentore, inicuar në periudhën e pandemisë, një përdorim të gjerë ka fituar përdorimi i platformës dixhitale Microsoft Teams duke mundësuar në këtë mënyrë e-learning. Referuar RVB, takimit me pedagogët dhe studentët, GVJ u informua se personeli akademik dhe studentët kanë përdorur dhe përdorin gjerësisht komunikimin elektronik duke krijuar mundësinë e kontaktimit të shpejtë dhe lehtësuar aksesin e materialeve të leksioneve, seminareve, laboratorëve etj [Ev.: Takime në institucion, RVB].</p>			
<p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.</p>	<p>Megjithëse në FSHN nuk rezulton të jetë aktive ndonjë platformë dixhitale e institucionit për menaxhimin e informacionit shoqëruar me hapësirë vetjake të dedikuar, GVJ është i mendimit se personeli akademik i programit të studimit dhe studentët kanë përdorur dhe përdorin me efikasitet platformën dixhitale Microsoft Teams si dhe mundësitë që ofrohen nëpërmjet komunikimit me përdorimin edhe të adresave zyrtare elektronike [Ev.: Takime në institucion].</p>			
<p>Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>	<p>Përmbyllja e detyrimeve të programit të studimit Bachelor në “Informatikë” bëhet me provim të përgjithshëm përfundimtar, ku hartimi i programit të provimit të formimit për programin e studimit, bëhet nga një komision Ad-hoc i ngritur nga Departamenti i Informatikës dhe i miratuar nga Dekanati [Ev.: RVB, 45 Rregullore Diplomimi per Programet e Ciklit I FSHN] Në Rregulloren e programit të studimit përcaktohet se personeli akademik përgjegjës për secilën lëndë të përfshirë në Provimin e Diplomës orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final në rast se kjo kërkohet nga një përfaqësi e studentëve përmes një ore konsultative [Ev.: 2 Rregullore Programi Studimi Bachelor Informatike].</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>GVJ u informua se në shërbim të sigurimit të cilësisë në UT është ngritur dhe funksionon Komisioni i Përhershëm për Sigurimin të Standardeve të Cilësisë (KPSSC), ndërsa në nivel njësie kryesore funksionon Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës e cila, duke bashkërenduar veprimtarinë e saj me KPSSC, vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore shkencore si dhe vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë së programeve të studimit. Procesi i vlerësimit të cilësisë bazohet në "Manualin e cilësisë" dhe në "Manualin e Vlerësimit të Performancës së Personelit Akademik të Universitetit të Tiranës" dhe mbështetet në analiza statistikore të të dhënave, në konstatime të nxjerra nga rregjistrat, në sondazhet, pyetorët dhe intervistat e organizuara me stafin akademik, stafin ndihmës akademik dhe administrativ si dhe studentët. [Ev.: 40 Manual i sigurimit te cilesise; 72 Manuali i Vlerësimit të Performancës së Personelit Akademik të Universitetit të Tiranës].</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Departamenti i Informatikës është përgjegjës për realizimin e programit të studimit Bachelor në "Informatikë" duke qenë njëkohësisht dhe përgjegjës për rritjen e cilësisë së mësimdhënies. Në këtë proces të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentëve për cilësinë e programit të studimit, një ndihmesë të konsiderueshme paraqet dhe puna e GVB për mbledhjen e informacionit dhe hartimin e RVB duke mundësuar një analizë të hollësishme të gjithë procesit të vlerësimit të cilësisë në lidhje me këtë program dhe identifikimin e elementëve të cilët kanë nevojë për përmirësim. GVJ, gjatë takimit me GVB u njoh me punën për përgatitjen e RVB, mbështetjen e autoriteteve drejtuese, kontributet, mbledhjen e informacionit dhe transmetimin e gjetjeve te personeli akademik dhe studentët [Ev.: RVB; 35 Raport Vjetor DSBCCK 2020_2021].</p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin</p>	<p>Referuar DVV fokusi i mësimdhënies në Departamentin e Informatikës është shumë më tepër sesa përfitimi i njohurive në një disiplinë apo lëndë të veçantë duke qenë se rëndësi i</p>

<p>dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>vihet aftësisë së të menduarit në nivel të lartë, të menduarit kritik, zgjidhjes kreative të problemeve, punës ekipore dhe komunikimit. GVJ u informua për metodat inovative të zhvilluara dhe të përdorura gjatë mësimdhënies në departamentin e Informatikës nga të cilat mund të përmenden:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mësimdhënie me në qendër studentin; - Të nxënit gjatë gjithë jetës (Life Long Learning); - Bashkëpunimi me bizneset dhe institucionet publike; - E-Learning; - Përdorimi i ambjenteve virtuale. <p>[Ev.: 32 Metoda inovative të zhvilluara dhe përdorura gjatë mësimdhënies në departamentine Informatikës]</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Nga takimet në institucion dhe DVV, GVJ u informua se një pjesë e personelit akademik të kategorisë As.Lektor është i angazhuar në kryerjen e studimeve të doktoratës [Ev.: Takime në institucion]. Në këtë mënyrë, kjo kategori, nën drejtimin e udhëheqësve shkencorë, kontribon fuqishëm në zhvillimin e kërkimit shkencor nga njera anë dhe, nëpërmjet rritjes së shkallës së kualifikimit, në përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Kualifikimit të vazhduar shkencor i shërbejnë edhe marrëveshjet e bashkëpunimit me IAL jashtë vendit konkretizuar nëpërmjet mobiliteteve të stafit akademik të Departamentit të Informatikës [Ev.: 27 Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit].</p>
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>GVJ u informua se në UT është ngritur që prej vitit 2021 "Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe trajnimit" [Ev.: https://unitir.edu.al/qender-virtuale-e-trajnimit-dhe-zhvillimit-profesional/]. Kjo qendër organizon në mënyrë periodike trajnime apo seminare të ndryshme në shërbim të rritjes së kompetencave dhe përfimit të elementëve me interes si në drejtim të kualifikimit individual ashtu edhe në drejtim të marrjes së informacioneve për çështje të caktuara.</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Nga takimet me personelin akademik të angazhuar në këtë program studimi, GVJ konstatoi se realizimi i procesit mësimor shoqërohet me përmirësime të vazhdueshme si në përmbajtjen e syllabuseve (për t'u përshtatur me zhvillimet e shpejta në fushën e informatikës), ashtu edhe me implementimin e metodave të reja të mësimdhënies (mbështetur nga një bazë laboratorike në përmirësim të vazhdueshëm). Në këtë proces personeli akademik mbështetet edhe nga personeli ndihmës akademik sidomos për mirëmbajtjen dhe garantimin e gadishmërisë së bazës laboratorike si dhe për asistencën gjatë</p>

	<p>zhvillimit të aspekteve praktike të programit [Ev.: Takim me pedagogët e programit të studimit].</p> <p>Përmirësimi të aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja i kanë shërbyer dhe mobilitetet e personelit akademik në institucione të arsimit të lartë jashtë vendit [Ev.: 27 Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit].</p>			
<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Përmirësimi i metodave të mësimdhënies ka ecur paralelisht me përmirësimin e bazës laboratorike. Aktualisht Departamenti i Informatikës ofron 5 laboratorë të teknologjisë së informacionit. Në këtë mënyrë ka qenë e mundur që në aspektet praktike që kanë të bëjnë me realizimin e projekteve dhe laboratorëve të nxiten iniciativat individuale dhe të nxitet puna në grup. Problematika që ka të bëjë me mësimdhënien është objekt edhe i pyetsorëve të studentëve që realizohen në fund të çdo semestri (përpara zhvillimit të provimit) e që shërbejnë si bazë për përmirësime të mëtejshme. [Ev.: Takime në institucion; 36 Paketa e Instrumentave të Cilësisë; 74 Raporti i Vlerësimit të Lendeve Semestri I 20-21].</p> <p>Referuar RVB, DSBC në bashkëpunim me strukturat e tjera përgjegjëse (Komisioni Institucional për Vlerësimin e Standarteve të Cilësisë) organizojnë trajnime tematike në lidhje me metodat e mësimdhënies apo në funksion të përmirësimit të cilësisë, sipas një kalendari që hartohet për këtë qëllim në fillim të vitit akademik [Ev.: 35 Raport Vjetor DSBC 2020_2021].</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Asnjë	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen</p>	<p>Rregulloret në të cilat përcaktohen kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale lidhur me programin e studimit Bachelor në "Informatikë" janë në nivel institucioni, në nivel njësie kryesore, në nivel njësie bazë dhe në nivel programi studimi, respektivisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rregullorja e UT;

<p>publike dhe njihen nga studentët.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Rregullore e diplomimit për Programet e Ciklit I FSHN; - Rregullore e Departamentit të Informatikës; - Rregullore e programit të studimit Bachelor në Informatikë. <p>GVJ u njoh me këto rregullore [Ev.: 1, 45, 3, 2 Rregulloret] dhe është i mendimit se në to përcaktohen qartë elementët që lidhen me kriteret dhe mënyrën e testimit të njohurive. Elementë të mënyrës së testimit të njohurive dhe peshës së komponentëve të ndryshëm në vlerësimin final jepen në syllabuset e lëndëve [Ev.: 9 Syllabuset Bachelor në Informatikë 2020-2021].</p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Metodologjia e testimit dhe e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore është specifike për secilën lëndë, ndaj njohja me to realizohet nga titullari i lëndës që në orën e parë të mësimi. GVJ konstatoi se këta elementë janë të parashikuar në syllabuset e lëndëve të cilët janë hartuar në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi. [Ev.: 9 Syllabuset Bachelor në Informatikë 2020-2021].</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, të cilat për lëndë të ndryshme kanë elementë të përbashkët, por edhe specifika që lidhen me natyrën e lëndës dhe aktivitetet formuese përkatëse. Përgjithësisht, GVJ konstatoi se vlerësimi final përbëhet nga komponentët:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive, me peshë 0 deri 70%; • Kontrolle të pjesshëm me peshë 0% deri 70% • Plotësimi i detyrimeve laboratorike me peshë 0% deri 30%; • Plotësimi i detyrimeve – detyra kursi me peshë 0% deri 35%; • Kontrolli final, me peshë 0 deri në 100%. <p>[Ev.: 9 Syllabuset Bachelor në Informatikë 2020-2021]</p> <p>Përmbyllja e detyrimeve të programit të studimit Bachelor në “Informatikë” bëhet me provim të përgjithshëm përfundimtar, ku hartimi i programit të provimit të formimit për programin e studimit, bëhet nga një komision Ad-hoc i ngritur nga Departamenti i Informatikës dhe i miratuar nga Dekanati [Ev.: RVB, 45 Rregullore Diplomimi për Programet e Ciklit I FSHN].</p>

	<i>GVJ është i mendimit që me interes dhe kontribut në zhvillimin e aftësive të studentëve për zgjidhjen e problemeve që shtron praktika do të ishte edhe mundësimi i diplomimit nëpërmjet temës së diplomës. Eventualisht mund të parashikohej një notë mesatare kufi si kriter për përmbylljen e studimeve me temë diplome.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbyllet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.	Nga shqyrtimi i syllabuseve të lëndëve, GVJ konstatoi se, për programin e studimit Bachelor në “Informatikë” kontrolli dhe vlerësimi i njohurive realizohet gjatë gjithë vitit dhe mbyllet me provimin përfundimtar, pesha e të cilit në vlerësimin e përgjithshëm varion nga 50 në 100%. Elementët e tjerë që merren në konsideratë gjatë vlerësimit të lëndës janë kontrollet e pjesshëm (me një peshë deri në 25%) dhe vlerësimi që lidhet me detyrimet e tjera të lëndës siç janë laboratorët, seminarët dhe detyra e kursit (me një peshë që varion nga 0% deri në 50%). Duhet theksuar se pesha e elementëve të ndryshëm në vlerësimin përfundimtar varet shumë dhe nga lënda, mënyra e zhvillimit dhe aktivitetet formuese në kuadrin e një lënde. GVJ është i mendimit se përgjithësisht kemi të bëjmë me një kontroll dijesh të përshtatshëm për vlerësimin e lëndëve të programit të studimit [Ev.: 9 Syllabuset Bachelor në Informatikë 2020-2021].
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Në UT nuk është vënë në zbatim ndonjë sistem elektronik i testimit të vlerësimit. Elementë të testimit dhe vlerësimit nëpërmjet sistemeve elektronike janë inicuar në situatën e pandemisë ku, UT ka implementuar dhe vënë në zbatim sistemin elektronik MS-Teams për testimin dhe vlerësimin e studentëve. Referuar RVB dhe takimeve në institucion, kjo mënyrë testimi ka garantuar shpejtësi, transparencë, objektivitet dhe informim të menjëhershëm të vlerësimit të studentëve [Ev.: RVB; Takime në institucion].
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale	Referuar RVB, testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale për studentët e programit të studimeve Bachelor në "Informatikë" kryhet nga pedagogët përgjegjës të

<p>realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>lëndës, ku titullari i lëndës është përgjegjës për vlerësimin dhe notën përfundimtare të studentit. Provimet zhvillohen në praninë e komisionit të provimit i cili përbëhet nga të paktën dy pedagogë ku njeri prej të cilëve është titullari i lëndës.</p> <p>Provimi i diplomës, ku përfshihen pyetje nga një grup lëndësh të programit bazë të cilat vlerësohen me rëndësi dhe impakt maksimal në vitet e mëparshme të shkollimit, përgatitet dhe kontrollohet nga një komision i propozuar nga departamenti dhe i miratuar nga dekanati ku marrin pjesë përgjegjësit e lëndëve / moduleve pyetjet e të cilave janë përfshirë në provim [Ev.: 2 Rregullore Programi Studimi Bachelor Informatike; 45 Rregullore Diplomimi per Programet e Ciklit I FSHN].</p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>GVJ u informua se provimet me shkrim, testimet në lëndët që zhvillohen përgjatë gjithë ciklit mësimor, bëhen në fletë/fletore të sekretuara duke mbajtur të fshehtë emrin e studentit gjatë vlerësimit nga ana e pedagogut. Gjithashtu, sigurohet infrastruktura e nevojshme dhe monitorimi me personel. Në kushtet e pandemisë u aplikua dhe testimi “online” i njohurive [Ev.: RVB; Takime në institucion].</p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Procedura e kontrollit të njohurive zhvillohet sipas rregulloreve përkatëse. [Ev.: https://unitir.edu.al/rregullore-ut/; 3 Rregullore e Departamentit te Informatikes; 2 Rregullore Programi Studimi Bachelor Informatike]. Referuar RVB dhe takimeve në institucion, studenti pas njohjes së vlerësimit, njihet me tezën e provimit pas korrigjimit. Ai njihet me pikët totale të vlerësimit në tezë dhe me pikët e çdo pyetje të tezës dhe eventualisht me komente, për t'u sqaruar dhe për t'u ndihmuar të përmirësohet në të ardhmen në procesin e të nxënës [Ev.: RVB; Takime në institucion].</p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>	<p>Rregullimi i problematikës lidhur me plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra etj, bëhet duke ju referuar dispozitave përkatëse të rregulloreve të UT dhe në mënyrë më të detajuar specifikohet në rregulloren e programit të studimit Bachelor në "Informatikë" duke parashikuar edhe masa disiplinore. Në rregullore specifikohet se si veprime të ndëshkueshme quhen falsifikimi i dokumenteve të ndryshme, kopjimi në provime, kopjime në punime shkencore, etj. Referuar RVB, në rast të konstatimit të kopjimeve në provime apo detyra kursi studentit i tërhiqet vërejtje me gojë dhe i zerohen pikët e vlerësimit [Ev.: 2 Rregullore Programi Studimi Bachelor Informatike; RVB].</p>

<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Në rregullore përcaktohet se vlerësimet për lëndë të veçanta komunikohen nga Komisioni i Provimit në mënyrë individuale duke ruajtur anonimitetin e notës karshi studentëve të tjerë. Komunikimi i vlerësimit bëhet brenda afatit të përcaktuar nga institucioni, brenda 5 ditësh nga përfundimi i provimit. Pedagogu cakton afatin maksimal të ankimimit të provimit dhe studenti mund të ankimojë me shkrim në rast se e mendon të arsyeshme rezultatin e marrë. Pedagogu / pedagogët e lëndës duhet të rishikojë / rishikojnë provimin e ankimuar dhe të njoftojnë studentin për rezultatin përfundimtar. I gjithë procesi i vlerësimit duhet të përfundojë brenda 7 ditësh nga dhënia e tij. Nga takimet me studentët GVJ konstatoi se studentët janë të njohur me këtë procedurë dhe konfirmojnë zbatimin e saj në praktikë. Duhet theksuar se Rregullorja e UT ka përcaktuar se rezultatet e provimit u bëhen të njohura studentëve nga komisioni në përfundim të provimit me gojë dhe për provimet me shkrim brenda 15 ditëve nga data e zhvillimit të provimit. [Ev.: 2 Rregullore Programi Studimi Bachelor Informatike; 6 Rregullore e UT; Takim me studentët].</p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Në Rregulloren e UT përcaktohet se studenti ka të drejtë të ankohet për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit si dhe për rezultatin përfundimtar të provimit. Ankesa për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit i paraqitet me shkrim përgjegjësit të departamentit brenda 24 orëve nga data e zhvillimit të provimit [Ev.: 6 Rregullore e UT]. Nga takimet me studentët GVJ u informua se ka patur raste të ankimimit dhe rishikim të vlerësimit të provimit që ka rezultuar dhe në ndryshim të notës [Ev.: Takim me studentët].</p>			
<p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Në Rregulloren e UT përcaktohet se studenti ka të drejtë të ankohet për rezultatin përfundimtar të provimit. Përgjegjësi i Departamentit bën verifikimet e duhura dhe kur e gjen të pamundur zgjidhjen e ankesës, vë menjëherë në dijeni Dekanin. Dekani, brenda 48 orësh nga marrja dijeni për ankesën nga Përgjegjësi i Departamentit, ngre një komision ad-hoc i cili bën verifikimin e pretendimeve të studentit. Me miratim të Dekanit, komisioni përcakton vlerësimin përfundimtar të provimit. Eventualisht Dekani, në se e gjen të drejtë ankesën e studentit, anulon provimin dhe merr vendim për rizhvillimin e provimit [Ev.: Rregullore e UT].</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Në përputhje</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi III.7

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Informatikë” mundëson fitimin e njohurive dhe afësive profesionale për:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Krijimin e shprehive të lidhura me profesionin përfshirë njohuri të avancuara në fushën e informatikës, të kuptuarit kritik të teorive / parimeve dhe aplikimit të tyre kryesore në fushën e informatikës, njohjen e termave teknikë, njohjen e proceseve teknologjike, njohuri mbi zhvillimet kryesore teorike dhe aplikimet praktike në fushën e informatikës, njohuri të shkrimit teknik në fushën e informatikës, njohjen e sistemeve informatikë. • Aftësimin e specialistëve të ardhshëm me frymën e punës në grup dhe bashkëpunimin me aktorët dhe faktorët e tjerë që ndikojnë në ciklin jetësor të zhvillimit të një softueri përfshirë mjetet dhe metodat e komunikimit me porositesit, përdoruesit fundorë, manaxhimin e organizatës, manaxherin e projektit, analistët e biznesit etj. • Krijimin e shprehive në prodhimin e kodit cilësor dhe duke përdorur praktikat më të mira programative. • Ndërtimin e kodit apo sistemeve duke pasur në vëmendje sigurinë e informacionit. • Përgatitjen e studentëve të cilët duan të avancojnë më tej studimet e tyre në studime të Masterit të Shkencave apo Masterit Profesional në fushat e Informatikës apo Teknologjisë së Informacionit, përfshirë fusha studimi të kombinuara mes informatikës dhe një fushe tjetër shkencore / teknike, përfshirë këtu dhe drejtimin e mësuesisë. [Ev.: 2 Rregullore Programi Studimi Bachelor Informatike] <p>Për vetë natyrën e programit të studimit i cili nxit veprimtarinë krijuese të studentëve, GVJ është i mendimit mënyra e zhvillimit të tij (me integrimin e detyrave e laboratorëve) krijon mundësi për zhvillimin e aftësive të veçanta të studentëve.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e</p>	<p>Për vetë natyrën e tij, Programi i studimit Bachelor në “Informatikë” garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit. Gjuha e huaj është e</p>

<p>teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>përfshirë në vitin e parë të studimeve dhe potencialisht ka kontribut në shfrytëzimin në vijim të literaturës në gjuhë të huaj si dhe lehtëson oportunitetet e mobiliteteve për studentët në institucione homologe të arsimit të lartë jashtë vendit. Referuar programit aktual, në të mungojnë lëndë të shkencave sociale, humane apo të komunikimit. [Ev.: 9 Syllabuset Bachelor në Informatikë 2020-2021]</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde janë objekt i diskutimeve dhe vlerësimeve nga vetë pedagogët për lëndët që mbulojnë si dhe nga studentët (nëpërmjet pyetsorit të vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies). Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ vëren se ka shembuj të analizave të procesit mësimor ku, ndërmjet të tjerave, analizohen kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti si dhe qasjet e pedagogëve për zgjidhjen e problemeve reale për të ndihmuar në aftësimin dhe orientimin e tyre ndaj kërkesave të tregut. [Ev.: 26 Analiza Vjetore e Departamentit të Informatikës].</p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Referuar RVB, në përfundim të lëndës, në orët mësimore të javës së fundit të semestrit, pedogogu planifikon, për efekt orientimi, përmbledhjen/përsëritjen e çështjeve më të rëndësishme të programit lëndor [Ev.: RVB]. Në Rregulloren e programit të studimit përcaktohet se personeli akademik përgjegjës për secilën lëndë të përfshirë në Provimin e Diplomës orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final në rast se kjo kërkohet nga një përfaqësi e studentëve përmes një ore konsultative [Ev.: 2 Rregullore Programi Studimi Bachelor Informatike].</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ u informua se në kuadër të aktiviteteve të organizuara nga Departamenti është dhe ai mbi Hapësira e Programuesve të Rinj – YPS, konferenca ndërkombëtare shkencore RTA-CSIT e cila zhvillohet në mënyrë periodike si dhe zhvillimi i “workshop”-eve dhe leksioneve të hapura. Nga takimi me studentët GVJ u informua edhe për zhvillimin e leksioneve të hapura nga staf i huaj (pedagogë të ftuar nga Portugalia, Turqia) për tematika që lidhen me zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë [Ev.: 29 Aktivitete Departamenti Informatikes 2018-2021; RVB; Takime në institucion].</p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në</p>	<p>Nga shqyrtimi i syllabuseve të lëndëve konstatohet se mësimdhënia në programin e studimit Bachelor në "Informatikë" kombinon formimin teorik dhe përvojën praktike e cila realizohet nëpërmjet seancave laboratorike,</p>

<p>laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>detyrave të kursit apo dhe projekteve. Nga takimet me studentët dhe pedagogët e programit të studimit Bachelor në "Informatikë", GVJ konstatoi se ka një tendencë në rritje për angazhimin e studentëve në punë praktike të cilat synojnë zgjidhjen e problemeve të caktuar. Ky element konkretizohet nëpërmjet detyrave të kursit dhe punëve laboratorike. Megjithatë, GVJ do të rekomandonte një rritje të peshës së detyrave të kursit apo projekteve si dhe rritje të peshës së praktikës në elementët formues të programit. Gjithashtu kontribut pozitiv do të kishte edhe parashikimi (apo rritja) e numrit të orëve të seancave laboratorike [Ev.: 9 Syllabuset Bachelor në Informatikë 2020-2021, Takime në institucion].</p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Nga takimi me pedagogët dhe studentët, GVJ konstatoi se aplikohen forma të punës në grup për realizimin e një detyre apo projekti ose edhe në rastin e laboratorëve ku punohet mbi bazën e nëngrupeve. Në këtë mënyrë bëhet e mundur të zhvillohen edhe elementë të tillë si diskutimet për problemin dhe menaxhimi i ndarjes së punës, interpretimi dhe zgjidhja e problemit, etj [Ev.: Takime në institucion].</p>
<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.</p>	<p>Referuar RVB, përfshirja e studentëve cilësorë në punën kërkimore shkencore është pjesë e politikës së zhvillimit të programeve të Departamentit të Informatikës. Në këtë aspekt një kontribut përbën dhe organizimi i një konferencë shkencore çdo dy vjet. Një nga këto është dhe konferenca ndërkombëtare shkencore RTA-CSIT e cila zhvillohet në mënyrë periodike nga departamenti i Informatikës. Kjo konferencë është zhvilluar së fundmi në vitet 2018 dhe 2021. Me anë të kësaj konference Departamenti i Informatikës synon të ofrojë një mundësi për hulumtuesit e fushës së Teknologjisë së Informacionit, për të prezantuar rezultatet e kërkimit të tyre dhe për të diskutuar mbi sfidat e hasura dhe zgjidhjet e rekomanduara. [Ev.: 29 Aktivitete Departamenti Informatikes 2018-2021; Takim me pedagogët].</p>
<p>Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.</p>	<p>Misioni i departamentit të Informatikës, është të përgatisë specialistë cilësorë të informatikës dhe të ofrojë kërkim cilësor e të aplikuar. Në këtë aspekt Departamenti synon të zhvillohet më tej duke ofruar një gamë të gjerë zgjedhjesh për studentët për t'u pozicionuar më mirë në tregun e punës e për të kontribuar në plotësimin e nevojës në rritje për ta [Ev.: 5 Strategjia e Departamentit të Informatikës]. Për përmbushjen e misionit të mësipërm, Departamenti i Informatikës organizon një numër aktivitete të cilat synojnë mbështetjen dhe zhvillimin e ideve inovative, studimet e</p>

	<p>avancuara kërkimore e shkencore etj. GVJ u informua për projektin Young Programmers Space (YPS), ku me mbështetjen e Dekanit të FSHN, angazhohen pedagogë dhe disa studentë për realizimin e tij. Një numër aktivitete të tjera si leksione të hapura dhe bashkëpunime me mbështetje nga projekti Erasmus+, nëpërmjet tematikave të trajtuara kanë rezultuar me mjet interes për studentët dhe lektorët e Departamentit duke mundësuar më shumë bashkëpunim dhe zhvillim në fushën kërkimore. [Ev.: RVB; 29 Aktivitete Departamenti Informatikes 2018-2021]</p>			
<p>Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të DVV, GVJ konstatoi se institucioni ka nënshkruar një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit nga të cilat një pjesë i korrespondojnë fushës së Informatikës [Ev.: 25 Marrëveshje të FSHN me kompani, institucione të tjera 2016-2021]. Marrëveshjet me institucione homologe jashtë vendit i kanë shërbyer mobilitetit të studentëve, megjithëse në një masë relativisht të kufizuar. Gjithashtu, në një masë më të madhe, i kanë shërbyer mobilitetit të pedagogëve, të cilët nëpërmjet eksperiencës së përfituar dhe transmetimin e saj nëpërmjet formave të ndryshme të mësimdhënies, potencialisht lehtësojnë mobilitetin e studentëve.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

<p>Standardi III.8</p> <p>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>GVJ u informua se diplomimi i studentëve në programin e studimit Bachelor në "Informatikë" bëhet me provim të përgjithshëm përfundimtar. GVJ konstatoi se procedura për provimin final është objekt i një rregulloreje të veçantë në nivel fakulteti, rregullore së programit të studimit si dhe rregullore së Departamentit të Informatikës. Këto rregullore si dhe elementët që lidhen me diplomimin e që janë pasqyruar edhe në rregulloret e tjera të UT, u bëhen të njohura studentëve në fillim të semestrit të fundit të studimeve Bachelor [Ev.: 45 Rregullore Diplomimi per Programet e</p>

	Ciklit I FSHN; 2 Rregullore Programi Studimi Bachelor Informatike].
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Referuar RVB dhe nga takimet në institucion, GVJ u informua se studentët në prag të diplomimit marrin të gjitha sqarimet/informacionet e nevojshme nga kujdestarët akademikë dhe Përgjegjësi i Departamentit, gjatë takimit informues, në lidhje me procesin e diplomimit që realizohet për studentët e vitit të fundit. Gjithashtu, Sekretaria mësimore dhe personeli akademik përgjegjës për lëndët përkatëse të provimit përmbyllës, asistojnë studentët duke u vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final [Ev.: <i>RVB</i>]. Udhëzuesi për provimin e diplomës mund të aksesohet edhe nëpërmjet faqes së internetit të FSHN: <u>https://api.fshn.edu.al/uploads/Bachelor_n_A_Teknologji_i_Informacioni_dhe_Komunikimi_a1c6d5dae5.pdf</u> Në këtë udhëzues jepet informacion mbi 4 lëndët elementë të cilave do të testohen gjatë provimit, shoqëruar me grupetemat përkatëse.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	GVJ u informua se teza e Provimit të Diplomës bazohet në pyetje nga 4 lëndë që janë zhvilluar gjatë procesit mësimor të ciklit Bachelor. Referuar RVB, teza përbëhet nga lëndë bazë dhe karakterizuese (tipi A dhe B) të programit nga të tre vitet akademike, sipas peshës specifike në kredite që ka secila prej tyre [Ev.: <i>RVB; Takime në institucion</i>].
Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.	Hartimi i programit të provimit të formimit për programin e studimit, bëhet nga një komision Ad-hoc i ngritur nga Departamenti i Informatikës dhe i miratuar nga Dekanati [Ev.: <i>RVB; 45 Rregullore Diplomimi per Programet e Ciklit I FSHN</i>] Në Rregulloren e programit të studimit përcaktohet se personeli akademik përgjegjës për secilën lëndë të përfshirë në Provimin e Diplomës orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final në rast se kjo kërkohet nga një përfaqësi e studentëve përmes një ore konsultative [Ev.: <i>2 Rregullore Programi Studimi Bachelor Informatike</i>].
Kriteri 5. Institucioni asistojnë studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo	Duke qenë se diplomimi i studentëve në programin e studimit Bachelor në "Informatikë" bëhet me provim të përgjithshëm

jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	përfundimtar, nuk është e nevojshme që të caktohet udhëheqës diplome dhe as të kryhen matje, analiza apo teste.			
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	GVJ është i mendimit që me interes në drejtim të formimit do të ishte edhe mundësimi i diplomimit nëpërmjet temës së diplomës. Eventualisht mund të parashikohet një notë mesatare kufi si kriter për përmbylljen e studimeve me temë diplome.			
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studentit vlerësohet me notë.	Në rastin e provimit final studentit vlerësohet me notë nga komisioni përkatës i mbrojtjes i cili ka në përbërje 3 deri 5 anëtarë. [Ev.: RVB, Takime në institucion]			
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studentit pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Në përfundim të studimeve të ciklit Bachelor në "Informatikë", studentit i vihet në dispozicion diploma (sipas modelit të miratuar nga MASR) dhe suplementi i diplomës së bashku me listën e notave. [Ev: 8 Suplement Diplome Bachelor ne Informatike].			
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Referuar RVB, pas diplomimit, studentit, me kërkesën e tij, i vihet në dispozicion dhe një kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar me syllabuset përkatëse.			
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	FSHN, nëpërmjet Sekretarisë mësimore ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit pasqyruar në: <ul style="list-style-type: none"> - Regjistrin themeltar (bazë) të studentëve me të dhënat personale të tyre; - Regjistrin e arritjeve akademike me vlerësimet e marra gjatë ndjekjes së programit të studimit; - Regjistrin e lëshimit të diplomave dhe çertifikatave. GVJ gjatë vizitës në Sekretarinë mësimore u njoh me Rregjistrin themeltar, Rregjistrin e arritjeve akademike (notave), Proces-verbale provimesh dhe me Rregjistrin e lëshimit të diplomave [Ev.: Vizitë në Sekretarinë Mësimore].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>FSHN në UT ka në strukturën e tij edhe Drejtorinë e Burimeve Njerëzore e cila bazuar edhe në organigramën e saj është në varësi të drejtpërdrejtë me Dekanatin e FSHN-së dhe pjesë e Degës së Burimeve Njerëzore dhe Arkives së UT-se [Ev.: 6 Rregullore e UT, neni 13]. Kjo drejtori është përgjegjëse për administrimin e dosjeve të personelit akademik (me kohë të plotë dhe të pjesshme) dhe administrativ i punësuar në FSHN bazuar edhe në detyrat dhe përgjegjësitë e shprehur në Kreun V në Statutin e UT-së [Ev.: 1 Statuti i Universitetit të Tiranës].</p> <p>GVJ zhvilloi edhe një vizitë pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore e cila ndodhet në godinen A, në katin e parë. Gjatë vizitës u konstatua se ndonëse stafi janë trajnuar 3 herë nga RASH nuk është kryer akoma një informatizim i zyrës e cila do të bëjë më efektive menaxhimin dhe administrimin e të dhënave të personelit të cilat deri tashmë ruhen në formë fizike dhe në excel [Ev.: Takim në institucion]. Të dhënat përditësohen një herë në vit bazuar në arrijtet akademike të stafit. Zyra e Burimeve Njerëzore është përgjegjëse për kontrollin dhe menaxhimin e ngarkesës mësimore vjetore bazuar edhe në nenin 71 në Statut të UT-së dhe në Udhëzimin e MASR nr.29 date 10.09.2018 [Ev.: Takim në institucion].</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe</p>	<p>Rekrutimi i stafit akademik, ndihmës-akademik, personelit administrativ në Departamentin e Informatikës bëhet në mbështetje të Legjislacionit të Punës në Republikën e Shqipërisë, të ligjit nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë në</p>

<p>aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Republikën e Shqipërisë”, akteve ligjore dhe nëngjore të shprehur në Statut neni 67 dhe 68 [Ev.: 1 Statuti i Universitetit të Tiranës, Evidenca 6 Rregullore e UT, neni 26]. Kërkesa për rekrutim të stafit akademik (me kohë të plote dhe të pjesshme) dhe stafit ndihmës – akademik buron nga Departamenti i Informatikës. Punësimi realizohet me procedurë konkurrimi të hapur përmes garantimit të një procesi të drejtë dhe transparent. Për të plotësuar nevojat e veprimtarisë mësimore, Departamenti i Informatikës çdo vit, pas planifikimit të ngarkesës vjetore për stafin PAE fton edhe personel akademik me kontratë të përkohshme ose paraqet kërkesën e tij për staf PAK [Ev.: 3 Rregullore e Departamentit të Informatikës, neni 15] dhe i paraqet Dekanatit të FSHN-së listën me propozimet për personelin akademik pas një diskutimi paraprak në departament [neni 23].</p> <p>Në takimet e zhvilluar në institucion u theksua vështirësia që Departamenti i Informatikës ka në lidhje me plotësimin e kërkesave të tyre për personel akademik me kohë të plotë. Konkretisht për vitin 2020-2021 ky departament ka kërkuar shtimin e personelit me 6 pedagogë të rinj për të rritur cilësinë në mësimdhënie dhe për të ulur ngarkesën mësimore por akoma vendet vakante nuk janë plotësuar [Ev.: 71 Plan Masash Departamenti i Informatikës]. Kërkesat për tre vitet e fundit janë refuzuar nga ana e Rektoratit të UT-së dhe Bordit të Administrimit për mungesë të fondeve.</p> <p><i>GVJ rekomandon plotësimin më staf akademik për të garantuar cilësinë në mësimdhënie.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Departamenti i Informatikës është përgjegjës për hartimin e kriteve të veçanta në procesin e rekrutimit të stafit akademik me kohë të plotë ose të pjesshme. Përgjegjesi i Departamentit i rekomandon Dekanatit të FSHN-së kriteret e posaçme bazuar në vendimin e marrë pas një diskutimi paraprak në departament [neni 23 në rregullore të UT-së].</p> <p>Kritere të veçanta vendosen edhe për punësimin e personelit ndihmës mësimor për vendet e lira të punës. Këto kritere propozohen nga Departamenti i Informatikës dhe pas marrjes së një miratimi nga Dekani i FSHN-së i cili bën edhe verifikimet e nevojshme i percjillet Rektoratit të UT-së për miratim dhe ndjekje të mëtejshme të procedurës [Ev.: 6 Rregullore e UT, neni 23].</p> <p>GVJ u njoh edhe me procedurën e rekrutimit të stafit akademik gjatë vizitës së kryer pranë kësaj drejtorie. Në verifikimet e kryera GVJ konstaton zbatimin korrekt të procedurës së</p>

	<p>vendosjes së kriterëve të veçanta në procesin e punësimit të stafit akademik. Ndër kriterë të veçanta dominojnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mesatare mbi 8.5; • Kualifikime dhe grada shkencore; • Aktivitete kërkimore shkencore në fushën profesionale; • Aftesi komunikimi në mësimdhënie; <p>[Takim në institucion]</p> <p>Vendosja e kriterëve të veçanta përbën pak vështirësi në procesin e rekrutimit të stafit akademik me kohë të plotë. Kërkesa e tregut të punës për inxhinierë të informatikës është e lartë dhe tërheqja e tyre në fushën akademike bazuar në rrogat që Institucioni Publik ofron shpreh një shkallë vështirësie dhe për sa më sipër kryesisht në kriterë të veçanta nga ana e institucionit janë hapur vende vakante për Asistent Lektor [Ev.: Takim në institucion].</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriterë të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ndjek procedurë rekrutimi dhe vlerësimi bazuar në Statut, në Rregulloren e UT-së dhe në të gjitha aktet ligjore dhe nën ligjore në fuqi. Gjatë takimit të zhvilluar në Institucion në zyrën e Burimeve Njerëzore, GVJ u njoh me procedurën e rekrutimit dhe të vlerësimit të cilat konsistojnë si vijojnë më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Diskutimi në departament në lidhje me ngarkesat mësimore vjetore dhe nevojat për personel akademik PAE ose PAK dhe personel ndihmës akademik; 2. Paraqitja e kërkesës në Dekanat të FSHN-së dhe miratimi i saj; 3. Hartimi i kriteve të veçanta pas një diskutimi paraprak në departament dhe aprovimi i saj nga Dekanati i FSHN-së. 4. Shpallja e procedurës për vendet vakante në website https://unitir.edu.al/ dhe në portalin www.app.gov.al 5. Para-selektim i kandidatave duke ju referuar edhe kriterëve të publikuara; 6. Zhvillimi i intervistës përpara komisionit ad hoc të ngritur dhe të aprovuar nga Dekanati i FSHN-së. 7. Vlerësimi i çdo anëtari të komisionit përmes një sistemi pikëzimi të kandidatave dhe shpallja e kandidatit fitues. <p>Në lidhje me sistemin e pikëzimit në vizitën e zhvilluar në institucion pati edhe diskutime të gjerë. Gjatë vizitës u konstatua përdorimi i një sistemi vlerësimi që vendosej nga</p>

	anëtarët e ad-hoc dhe aspak bazuar në një procedurë të aprovuar. Bazuar nga gjetjet në Institucion GVJ rekomandon: <i>Vendosjen e një sistemi të standartizuar vlerësimi dhe pikëzimi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Procesi mësimor i programit të studimit Bachelor në “Informatikë” zhvillohet në ambjentet e Fakultetit të Shkencave të Natyrës në katër godina përkatësisht A,B,C dhe D [Ev.: 12 infrastruktura FSHN]. GVJ gjatë vizitës që zhvilloi në institucion konstaton se infrastruktura është në përputhje me standartet që garantojnë zhvillimin cilësor të një procesi mësimor. Programi i studimit zhvillohet në ambjente të cilat plotësojnë standartet për një hapësirë të duhur, të mjaftueshme dhe cilësore. Institucioni i kushton një vëmendje të veçantë mirëmbajtjes dhe përmirësimit të vazhdueshëm të infrastrukturës. Programi i studimit zhvillohet në katër godina (Godina A, B, C dhe D) me një sipërfaqje totale 8824.5m². Godinat sigurojnë ambjente të duhura për salla leksioni dhe seminare (2559.31m²), salla për laboratorë (3492.08m²), ambjente për zyra për stafin akademik (1186.72m²), ambjente të përbashkëta (3310.04m²) [Ev.: 18 Informacion mbi numrin dhe kapacitetin dhe sipërfaqet e sallave të mësimit].</p> <p>Nga vizita në institucion, GVJ konstatoi se ambientet në të cilat zhvillohet procesi mësimor janë të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për një zhvillim cilësor të këtij procesi, që përfshin: ngrohje-ftohjen, ndriçimin, tabelat, projektorë dhe çdo gjë tjetër të domosdoshme për këtë qëllim. Një kontribut i rëndësishëm ofrohet nëpërmjet bazës laboratorike dhe FSHN zotëron 8 laboratorë informatike me një sipërfaqje totale 327.1m² në shërbim të programit të studimit [Ev.: 13 Tabela nr.16 përmbledhese Per RVB Informatikë; Ev. Vizita e ambienteve; RVB].</p>

	<p>Në shërbim të programit janë 18 klasa për leksione dhe 10 klasa për seminare dhe 82 laboratorë për lëndët të cilat ofrohen për të gjithë programet e studimit të zhvilluar në FSHN [Ev.: 13 Tabela nr.16 permbledhese Per RVB Informatikë; Ev. Vizita e ambienteve]. Klasat garantojnë një ndriçim të duhur dhe janë të pajisur me tabela, projektore dhe mjete didaktike ndihmëse në shërbim të procesit mësimor. Per godinat sigurohet një konfort termik të duhur për studentin gjatë procesit mësimor. Infrastruktura është në përmirësim të vazhdueshëm. Gjatë vizitës GVJ konstaton një mungesë të rampave dhe aksesibilitet për njerezit me aftesi të kufizuar. Në këtë drejtim <i>rekomandojmë që institucioni të marrë masat e duhura për këtë grup marginal</i> [Vizita e ambienteve].</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>FSHN dhe Departamenti i Informatikës mbartin një përvojë dhe eksperiencë të gjerë në fushën e mësimdhënies duke diplomuar studentët të cilët tashmë janë të suksesshëm në fushën akademike dhe të biznesit. Departamenti i Informatikës angazhon një staf me përvojë në fushën e informatikës. Konkretisht për vitin 2020-2021 janë angazhuar për programin e studimit Bachelor në "Informatikë" 3 Prof.Dr, 4 Prof. Asoc., 22 Dr, 6 Asistent me MSc (në process doktrature), 8 Asistentë MSc, në një total 43 punonjës akademike kundrejt 27 PAK (1 Dr, 2 Asistentë MSc (në process doktrature) dhe 24 Asistente MSc me një raport në përqindje 61.4 % PAE kundrejt 38.6% PAK duke përmbushur edhe kërkesat e shprehur në kornizën ligjore në fuqi për zhvillimin e programeve të studimit të cilit të parë Bachelor [Ev.: 13 Tabelat permbledhese Per RVB Informatikë].</p> <p>Institucioni i kushton një vëmendje të veçantë aftësimin dhe kualifikimin të vazhdueshëm të stafit akademik. Departamenti i Informatikës konsideron me një prioritet të veçantë zhvillimin periodik të konferencës shkencore RTA-CSIT të zhvilluar në 2018 dhe 2022. Kjo konferencë ndërkombëtare mundëson ndarjen e eksperiencës me hulumtues nga universitete të njohura duke hapur një perspektivë për stafin akademik të Departamentit të Informatikës në lidhje me kualifikimin e vazhdueshëm të tij shkencor dhe akademik. Përvoja është dhënë edhe përmes mësimave të hapura në kuadër të projektit Erasmus+ (2019) apo përmes angazhimit të kompanive të suksesshme si Mozenda e cila spikatet në Utah (USA) në fushën e grumbullimit të të dhënave nga web në mënyre automatike [Ev.: 29 Aktivitete Departamenti Informatikes 2018-2021].</p>

Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.

FSHN i kushton një vëmendje përmirësimit të metodave të mësimdhënies. Fusha e inxhinerisë informatike është e veçantë dhe gjithmonë në zhvillim dhe progres të vazhdueshëm dhe për këtë nga ana e stafit akademik kërkohet zbatimi i informacionit dhe teknikave në drejtim të mësimdhënies dhe mësimnxënies në përputhje me tendencat e fundit teknologjike. Departamenti i Informatikës konsideron se element i rëndësishëm i pedagogjisë nuk është thjesht transmetimi i informacionit nga pedagogët tek studentët por aftësimi i studentëve në mënyrën e trajtimit të koncepteve, provat dhe mënyrën e të menduarit të tyre si një ekspert. Departamenti i Informatikës zhvillon punën duke patur:

- a. Mësimdhënien me qendër studentin;
- b. Të nxënit gjatë gjithë jetës;

Në këtë drejtim GVJ konstaton si vijon më poshtë:

1. Analizimin e situatës së procesit mësimor në drejtim të mësimdhënies. Raportet vjetore japin qartë një analizë në këtë drejtim duke dhënë suksesin, problematikat dhe masat në lidhje me përmirësimin e tyre. Analizimi i procesit mësimor bëhet në koherencë edhe me arritjet kërkimore shkencore të departamentit dhe të stafit akademik [Ev.: 26 Analiza Vjetore e Departamentit të Informatikës; Evidenca 22 Raporti Vjetor FSHN UT 2020-2021]
2. Përmirësimi i infrastrukturës mësimore në drejtim të përmirësimit të procesit mësimor.
3. Në kuadër të situatës së COVID – 19 janë ndërmarrë hapa në lidhje me zhvillimin e procesit mësimor online. Takimet në institucion demonstruan aftësinë në këtë drejtim (e-learning, e-classroom, video tutoriale) [Evidenca 54 Komunikim në MS Teams ndërmjet një studenti dhe një pedagogu; Evidenca 34 Trajtime për stafin akademik mbi platformën Microsoft Teams; Evidenca 33 Udhëzues i Universitetit të Tiranës për përdorimin e sistemit të mësimin në distancë].
4. Bashkëpunimin me kompanitë e biznesit dhe institucionet publike për të sjellë në procesin e mësimdhënies problematikën e biznesit dhe orientimin e studentit drejt identifikimit praktik dhe gjetjes së zgjidhjes [Ev.: 27 Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit]
5. Përdorimi i ambjenteve tutoriale: Departamenti i Informatikës organizon edhe aktivitetin YPS “Kendi i



	<p>programuesve të rinj” e cila është një platformë e aksesueshme online cila u ofron studentëve të testojnë aftësitë e tyre në gjuhë të ndryshme te programit.</p> <p>[Ev.: 32 Metoda inovative të zhvilluara dhe përdorura gjatë mësimdhënies në departamentine Informatikës; 33 Udhëzues i Universitetit të Tiranës për përdorimin e sistemit të mësimin në distance; 34 Trajnime per stafin akademik mbi platformën Microsoft Teams; 54 Komunikim në MS Teams ndërmjet një studenti dhe një pedagogu]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Departamenti i Informatikës plotëson standartet dhe kërkesat ligjore në fuqi në lidhje me organizimin e strukturës së saj të brendshme duke dëshmuar angazhimin e një stafi akademik me grada shkencore dhe me eksepriencë në fushen e informatikës dhe të lëndëve mbështetëse ndihmëse të këtij programi. GVJ konstaton se Departamenti i Informatikës angazhon një staf akademik me kohë të plotë dhe të pjeshme për të plotësuar edhe kërkesat e programit mesimor. Konkretisht:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. Për vitin 2020-2021 janë angazhuar 3 Prof. Dr, 4 Prof. Asoc. Dr; b. Për vitin 2020-2021 janë angazhuar 22 staf akadmeik me graden Dr. duke patur nje rritje në krahasim me vitin 2018; c. GVJ konstaton një renie të stafit akademik Dr. në process (6 ne vititn 2020-2021 kundrejt 11 në vitin 2018) e cila jep edhe përmbushjen e gradës shkencore duke sjell edhe rritjen e theksuar me sipër të personelit akademik me gradën Dr. d. Departamenti i Informatikës angazhon staf PAE me grada shkencore dhe eksperiencë nga departamente të tjera në mbështetje të programit mësimor. <ul style="list-style-type: none"> • 2 Prof. Dr, 6 Dr. dhe 3 MSc angazhohen nga Departamenti Matematikë e Aplikuar për lëndën “Matematikë e Aplikuar”, “Statistikë e Aplikuar” dhe “Analizë Numerike”; • 1 Prof. Asoc. Dr dhe 2 Dr., nga Departamenti i Matematikës për lëndën “Matematikë”; • 1 Prof. Asoc. dhe 3 Dr për lëndën “Fizikë” nga Departamenti i Fizikës. e. Per stafin akademik PAK jane angazhuar 1 PhD, 2 Dr. ne process dhe 24 MSc kundrejt 30 për vitin 2018. GVJ konstaton se stafi PAK kryesisht vjen nga fusha e

biznesit dhe nga institucionet publike si Ministria e Mbrojtjes apo IAL publike [Ev.: 13 Tabelat permbljedhese Per RVB Informatikë].

Nga evidentimi i bërë ngarkesës mësimore, konstatohet:

Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)
2018-2019	6515	4294	2221	66% / 34 %
2019-2020	6314	4411	1913	70% / 30%
2020-2021	6412	4502	1910	70.3% / 29.7%

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	FSHN pjesë e Universitetit të Tiranës është e pozicionuar në Bulevardin “Zogu I”. Institucioni zotëron katër godina përkatësisht godina A, B C dhe D me një sipërfaqje totale 11,863.51 m ² . GVJ zhvilloi takim në institucion ku konstaton se ambjentet dhe infrastruktura e brendshme dhe e jashtme janë në përputhje me standartet e kërkuara për një proces mësimor me cilësi. FSHN për programin e studimit ofron 18 salla leksioni me sipërfaqje (2167m ²), 10 klasa për seminare (404m ²), 8 laboratorë informatike (327.1m ²), 2 salla interneti (137.25m ²) dhe 3 salla biblioteke (148.75m ²). Për aktivitete promovuese dhe konferencë është ndërtuar një sallë e veçantë me sipërfaqje 1336.4 m ² . Institucioni ofron mjedise për librari, fotokopjime për studentët (678.75m ²). Në funksion të studentëve është zyra për informacion për studentët (28.28m ²) dhe mjedisi për qeverinë studentore dhe aktivitetet e tyre (28.28m ²). Departamenti i Informatikës ofron mjedise të duhura edhe për stafin akademik duke siguruar një akomodim në zyra të pajisura me mjetet e duhura në ndihmë të punës së tyre përgatitore. Ambjentet janë të ristrukturuara

	<p>duke siguruar një ndriçim brenda standarteve dhe një sistem HVAC që siguron një konfort termik të duhur për procesin mësimor. <i>GVJ konstaton mungesën e rampave për studentët për gruper në nevojë dhe për këtë GVJ rekomandon marrjen e masave në këtë drejtim [Ev.: 12 Infrastruktura FSHN; Takime ne institucion; 18 Informacion mbi numrin dhe kapacitetin dhe sipërfaqet e sallave të mësimi].</i></p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Mjediset e sallave të leksioneve dhe seminareve (18 salla leksioni dhe 10 salla për seminare) dedikuar Departamentit të Informatikës janë të pajisura me të gjithë mjetet në ndihmesë të zhvillimit të procesit mësimor. Nga vizita në institucion konstatohet pajisjen e sallave me projektore, video-projektore portable për sallat e seminareve. Në lidhje me përmirësimin e infrastrukturës në laboratore, investime bëhen nga institucioni çdo vit. Bazuar në kërkesat e studentëve e përcaktuar nga formularët online që ata plotësojnë për vlerësimin e lëndëve dhe nga kërkesat e stafit akademik pasqyruar këto edhe në raportet vjetore bëhen edhe kërkesat për investime në pajisjen e laboratoreve dhe përmirësimin e tyre [Ev.: 12 Infrastruktura FSHN, 26 Analiza Vjetore e Departamentit të Informatikës; 13 Tabelat permbljedhese Per RVB Informatikë]. GVJ konstaton se laboratorët janë në përmirësim të vazhdueshëm dhe ndonëse investimet janë të vogla nga të ardhurat e institucionit, një pjesë e tyre janë zhvilluar në kuadër të projekteve [Takime ne institucion].</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Departamenti i Informatikës në mbështetje të programit mësimor ka krijuar një infrastrukturë të duhur për mjediset laboratorike. Konkretisht GVJ konstaton laboratorët si vijon më poshte:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. 2 Laboratore Programimi C, C++ (32 PC ne total kryesisht per programim ne gjuhet C, C++ me parametra Intel® Core™ i5-8500 @ 3.00 GHz, 8GB Ram, HDD 500GB) b. Laborator Programimi JAVA(24 Laptope kryesisht per programim ne JAVA me parametra Intel® Core™ i5-6200U @ 2.3 GHz, 4GB Ram, HDD 256GB) c. Laborator IoT (16 Laptope Intel® Core™ i5-6200U @ 2.3 GHz, 4GB Ram, HDD 500GB); d. Laborator SQL SERVER (16 Laptope Intel® Core™ i5-6200U @ 2.3 GHz, 4GB Ram, HDD 500GB); e. Laborator GIS (15 Ëorkstation me parametra Intel® Xeon® E5606 @ 2.13 GHz, 8GB Ram, HDD 500GB);



	<p>f. <i>Data Center (1 Server PRIMERGY RX2540 M4 Intel® Xeon® Silver 4110 @ 2.10GHz , 16GB Ram, SAS 40TB; 1 Server PRIMERGY RX4770 M4 Intel® Xeon® Gold 5118 @ 2.30 GHz, 256GB Ram, SSD 8TB; Sëitch 1G UPLINK PoE+; UPS);</i></p> <p>[Ev.: 16 Specifikimet e Laboratoreve].</p> <p>Laboratorët janë në dispozicion të studentëve jo vetëm gjatë procesit mësimor por edhe jashtë saj. Në mbështetje të programit për orët laboratorike dhe për punën studimore të studenteve është një staf mbështetës i kualifikuar [Takim me stafin akademik, vizitë në institucion].</p> <p>Departamenti i Informatikës ofron edhe programe të tjera si vijon më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Bachelor në Informatikë;</i> 2. <i>Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi;</i> 3. <i>Master i Shkencave Informatike;</i> 4. <i>Master i Shkencave Teknologji Informacioni;</i> 5. <i>Materi i Shkencave AML Informatike;</i> 6. <i>Master Profesional Informatike Biznesi;</i> 7. <i>Master Profesional Teknologji Informacioni;</i> <p>GVJ në vizitën e kryer verifikoi nëse laboratorët janë disponibël për studentët edhe pas orës së mësimit. Ndonëse nga stafi akademik u konfirmua vënia në dispozicion, GVJ duke konsideruar numrin e madh të programeve në fushën e informatikës dhe Teknologjisë së informacionit rekomandon që:</p> <p><i>Institucioni duhet të zgjerojë kapacitetin e ambienteve informatike në funksion të zhvillimit të aktiviteteve laboratorike të parashikuara në planet mësimore të programeve përkatëse të studimit që ofron.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.</p>	<p>Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të dedikuar të cilat janë të pajisur me të gjithë mjetet didaktike të nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor. Në drejtim të tyre një punë zhvillohet në mirëmbajtje ku një staf mbështetës IT angazhohet për sigurimin që PC dhe laptopet në këto laboratorë janë në parametrat dhe fuqinë e duhur për studentët gjatë procesit mësimor. Sallat e laboratorëve janë të pajisur me mjetet diadaktike si video-projektore, për demonstrime gjatë procesit mësimor [Takime në institucion; Evidenca 24 – Raporti Vjetor i DI2021 – 2022; 16 - Infrastruktura Laboratorike e DI; 18 – Informacion</p>

	<p>mbi numrin dhe kapacitetin dhe sipërfaqet sallave të mësimi].</p> <p>GVJ thekson si edhe ne kriterin 3 më sipër:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Është e nevojshme shtimi i kapaciteteve kompjuterike për laboratorët ekzistues, të tillë që së paku një student i grupit laboratorik, të ketë në dispozicion një kompjuter.</i> • <i>Është e nevojshme shtimi i numrit të laboratorëve informatik në tërësi.</i> 			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</p>	<p>Programi i studimit nuk parashikon praktikë profesionale të mirëfilltë. Në këtë kuadër, studentët nuk e kanë detyrim zhvillimin e praktikave profesionale pranë kompanive apo institucioneve në fushën e këtij programi studimi. Megjithatë, Departamenti i Informatikës ka lidhur disa marrëveshje të drejtpërdrejta bashkëpunimi me disa kompani si dhe shfrytëzon dhe marrëveshjet me FSHN/UT, që studentët të kenë mundësi për praktika, internshipe por edhe seminare të përbashkëta. Institucioni garanton kushtet e nevojshme për zhvillimin e praktikave apo edhe qasje WiFi në internet. Megjithatë, në momentin e vizitës, jo të gjitha ambientete e FSHN-së, që aksesohen nga studentët, kishin qasje WiFi në të gjitha ambientet e FSHN-së. Sipas bisedimeve gjatë vizitës, është në planin afatshkurtër të institucionit zgjerimin e mbulimit me sinjal WiFi në të gjithë ambientet. Gjithashtu në dispozicion është dhe biblioteka e FSHN.</p> <p>[Ev.: 25 – Marrëveshje të FSHN me kompani, institucione të tjera 2016 – 2021; 69 - Shembull marrëveshje me kompani të ndryshme në fushë e Teknologjisë së Informacionit; 42 – Informacion Biblioteka FSHN]</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4	
<p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave të Natyrës pjesë e të cilës është edhe Departamenti i Informatikës ka në strukturën e tij edhe bibliotekën si njësi ndihmës – akademike me karakter administrativ. Kjo strukturë funksionon mbi bazën e një Rregullore të Brendshme të miratuar me vendim Dekani nr, 215 date 29.12.2021. Biblioteka e FSHN e pozicionuar në katin e parë në një shtrirje të gjere (700m²) është vënë në shërbim të procesit mësimor dhe formimit profesional të studentëve [Ev.: 42 Informacion Biblioteka FSHN]. Në këtë strukturë janë punësuar një staf me eksperiencë dhe e dedikuar (3 bibliotekarë dhe 1 sekretare e këshillit botues të revistes periodike të Buletinit të Shkencave të Natyrës [Ev.: 52 Rregullore Bibliotes-FSHN neni 19, takim ne institucion]. Biblioteka është në dispozicion të studentëve edhe për këtë program studimi përmes ofrimit të një numri të mjaftueshem botimesh. Biblioteka e FSHN ofron 92 poste studimi ne fondin e hapur te librit për të cilën edhe një specialiste është në ngarkim, 4 vende në ambjentin e shërbimit të fondit kryesor, 44 vende në fondin e hapur të periodikut.</p> <p>GVJ konstaton se ky kapacitet është pak i vogël duke konsideruar numrin e madh të programeve që FSHN ofron. GVJ rekomandon:</p> <p><i>Të shtohet numri i posteve për të mbuluar kërkesat e studentëve.</i></p>
<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka e FSHN ofron një gamë të gjerë botimesh. Në vizitën e kryer në institucion GVJ konstaton një larmi botime të vjetra dhe shumë botime të viteve të fundit te ofruara në përputhje me kërkesat e shprehur nga Departamenti i Informatikës për programin e studimit [Vizitë në institucion]. Përgjegjësi i bibliotekës në vizitën e kryer ofroi një informacion të gjerë në lidhje me historikun dhe progresin e bërë në drejtim të ristrukturimit dhe rikonstruksionit të kësaj njësie. Biblioteka ka një fond me 76000 libra, dispenca dhe disertacione në fushën e shkencave të natyrës pjesë e të cilës është edhe programi i studimit Bachelor në “Informatikë”. Biblioteka ofron mbi 20,000 njesi periodike. Litarura e ofruar varion në gjuhen shqipe, angleze, rusisht, frengjisht, gjermanisht etj [Vizitë në institucion].</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-</p>	<p>Biblioteka e FSHN ofron 92 poste studimi në fondin e hapur të librit për të cilën edhe një specialiste është në ngarkim, 4 vende në ambjentin e shërbimit të fondit kryesor, 44 vende ne fondin e hapur të periodikut. Departamenti i Informatikës pjesë e FSHN-së ka akses për abonimin në biblioteken</p>

<p>line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>digjitale JSTOR e mundësuar përmes bashkëpunimit me ADF. Kjo bibliotekë dixhitale ofron artikuj të revistave akademike në fushën e informatikës, ofron mbi 2 milion dokumente në 75 disiplina pjesë e të cilës është edhe fusha e informatikës. JSTOR është e aksesueshme nga studentët dhe stafi akademik.</p> <p>FSHN ofron edhe U-library (https://ulibrary.rash.al pjesë e rrjetit të IAL-ve publike mundësuar nga Rrjeti Akademik shqiptar U-library shfrytëzohet në mënyrë aktive nga studentët dhe stafi akademik [Ev.: 42 Informacion Biblioteka FSHN].</p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Dixhitalizimi i bibliotekës së FSHN-së është në proces dhe tashmë vetëm 4.1% e titujve aktuale janë dixhitalizuar. Biblioteka është e pajisur me kompjuterë të cilët krijojnë lehtësi përdorimi për studentët. Personeli i IT është përgjegjës për mirëmbajtjen e tyre dhe vënien në kapacitet të plotë [Takim në institucion].</p> <p><i>GVJ konstaton se numri i PC është i vogël duke konsideruar numrin e madh të studentëve. GVJ në vizitën e kryer konstaton edhe mungesën e mbulimit me wifi në këtë njësi.</i></p> <p>GVJ sygjeron që sallat në dispozicion të studentëve duhet të pajisen me pc dhe sinjal wifi.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>GVJ konstaton përpjekje të institucionit dhe Departamentit të Informatikës në veçanti për pasurimin e bibliotekës dhe plotësimin e kërkesave të stafit akademik me libra. Në këtë drejtim kërkesat burojnë nga stafi akademik dhe paraqiten në Dekanatin e FSHN-së i cili vijon më pas me pasqyrimin e tyre në projekt buxhetin për vitin ardhës financiar [Takim në institucion]. Konkretisht për vitin 2021 është parashikuar edhe një fond i veçantë për bibliotekën për abonim në bibliotekën elektronike ndërkombëtare për botime shkencore e cila do të zhvillohet përmes një procedure prokurimi e kufizuar [Ev.: <u>Buxheti 2021 - Fakulteti i Shkencave të Natyrës (fshn.edu.al)</u>].</p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Biblioteka e FSHN është e hapur për stafin akademike dhe studentët. Një staf i përkushtuar angazhohet në oraret 8.00-20.00 nga e Hëna deri në të Enjte dhe 8:00-18:00 ditën e Premte e percaktuar kjo edhe në Rregulloren e Institucionit dhe në nenin 24 të rregullores së bibliotekës [Ev.: 6 Rregullore e UT; 52 Rregullore Bibliotekës-FSHN]. Në vizitën e zhvilluar në këtë strukturë nga ana e punonjësve u theksua angazhimi i tyre edhe gjatë pandemisë por me orar të kufizuar [vizitë në bibliotekë]</p>


Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrohet të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>FSHN disponon dhe administrohet informacionin e duhur për studentët, stafin akademik dhe personelin administrativ përmes një sistemi menaxhimi i mirëpërcaktuar në procedurë sipas rregullores së institucionit dhe rregullores të brendshme të strukturave në funksion të tij. Konkretisht GVJ konstaton në këtë drejtim:</p> <ol style="list-style-type: none"> Sekretarinë mësimore e cila është përgjegjëse për administrimin e informacionit dhe pasqyrimin e tij në regjistrin themeltar të studentëve, regjistrin e arritjeve akademike të cilat mbahen në formë elektronike dhe në hard copy. Kjo zyrë është përgjegjëse për regjistrimin e studentëve dhe administrimin e dosjeve të veçanta për secilin prej tyre. GVJ zhvilloi një vizitë në këtë strukturë dhe verifikoi mënyrën e administrimit të dosjeve për çdo student dhe regjistrat përkatës të përmendur me sipër dhe konkludon zbatimin me korrektësi të procedurave. FSHN është duke punuar në lidhje me ndërtimin e një sistemi të ri elektronik i cili ka në fokus të tij administrimin e të dhënave të studentëve dhe lidhjen e tij me portalin www.e-albania.com. Ky sistem është në proces dhe në fund të vitit akademik parashikohet të përfundojë. Microsoft Office365 ka qenë edhe paketa e përdorur nga stafi akademik për procesin mësimor gjatë situatës së Covid-19 ku moduli i komunikimit online Microsoft Teams është përdorur për arritjen e një komunikimi interaktiv student – pedagog [Takim me stafin akademik dhe studentët; Evidenca 43 – Rregullore për funksionimin e sistemit informatik në UT; 108 - Rregullore e sekretarisë mësimore; 34 – Trajnime për stafin akademik mbi platformën Microsoft Teams; 53 – Llogari në MS Teams

	<p>pedagogu; 54 – Komunikim në MS Teams ndërmjet një studenti dhe një pedagogu; 55 – Komunikim në Microsoft Teams për ngarkimin e leksioneve (literaturës bazë)]</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>FSHN garanton përmes strukturave administrative të ngritura amdinistrimn e informacionit në lidhje me personelin akademik, studentët dhe progresin e programit mësimor. Statuti dhe rregulloret e brendshme përcaktojnë qartë detyrat në lidhje me funksionimin e strukturave të cilat janë përgjegjëse për mbajtjen dhe menaxhimin e dokumentacionit për programin e studimit. GVJ shqyrtoi me vëmendje dokumentacionin e paraqitur nga institucioni dhe konstaton:</p> <ol style="list-style-type: none"> Njësinë bazë përgjegjëse për administrimin e dokumentacionit në lidhje me programin mësimor, planet kalendarike, syllabuset, dokumentacionin për kërkimin shkencor (projekte dhe artikuj nga personeli akademik), raportet vjetore për programin mësimor dhe kërkimin shkencor në nivel njësi bazë, procesverbalet në lidhje me diskutimet e zhvilluara në mbledhje, draft buxhetin dhe propozimet etj [Ev.: 26 Analiza Vjetore e Departamentit të Informatikës; 35 Raport Vjetor DSBCK 2020_2021; Takime në institucion]. Dega e Burimeve Njerëzore dhe Protokoll – Arshivës dhe Sektori i Burimeve Njerëzore / Sektori i Arshivës të cilat janë përgjegjëse për dokumentacionin e personelit akademik (PAE/PAK), stafit administrativ. Sekori i Arkivës mban në mënyrë të rregullt arkivimin e dokumentacionit bazuar kjo edhe në dispozita të shprehura në Statut të UT-së [Ev.: 6 Rregullore e UT; 1 Statuti i Universitetit të Tiranës] Sekretaria mësimore e cila menaxhon dhe administron dokumentacionin për studentët e regjistruar dhe progresin e tyre deri në diplomim, procesverbalet e provimeve dhe rezultatet e studentëve, aplikimet për ekuivalentim ose transferim.
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sipas evidencës së paraqitur, rezulton që sistemi i menaxhimit siguron akses studentëve dhe personelit akademik, i cili është konfidencial në respekt të ruajtjes së të dhënave personale dhe mundësohet nëpërmjet llogarive personale. Studentët kanë në dispozicion portal elektronik nëpërmjet aksesit individual në të cilin ai kryen regjistrimin për kurset që do të frekuentojë, njihjen me rezultatet në provime etj. Gjithashtu në faqen zyrtare elektronike, studenti nëpërmjet aksesit individual</p>

mund të sigurojë faturat për tarifatat e studimit, listë notash, certifikata apo dhe programet mësimore. Akses elektronik i sigurohet edhe personelit akademik, ndihmës akademik dhe sekretarisë mësimore. Sistemi i menaxhimit të institucionit dhe sekretarisë mësimore, nuk parashikon mundësinë e hedhjes dhe ruajtjes së detyrimeve lëndore të studentëve. Detyrime që janë parakusht për të lejuar pjesëmarrjen në provim. Detyrime si frekuentimi, shlyerja e laboratorëve apo e projekteve dhe detyrave të kursit. Ky detyrim mirëmbahet vetëm nga pedagogu i lëndës, i cili, edhe pse ka në dispozicion listën e studentëve të grupit që ka provim, të hartuar nga sekretaria mësimore, mund të mos lejojë student të zhvillojnë provimin, pasi ka detyrime lëndore të pa shlyera. Mbajta e informacionit rreth shlyerjes së detyrimeve të lëndës nga pedagogu për secilin student, mund të paraqesin vështirësi në transmetimin e këtij informacioni në rast të ndërrimit të pedagogut të lëndës, apo në rast të studentëve që frekuentojnë lëndën në një vit akademik, por për motive nga më të ndryshme, zhvillojnë provimin e saj, në vitet pasardhëse akademike.

- *Është i nevojshëm një sistem elektronik të jetë më dinamik dhe i plotë, ku pedagogët të deklarojnë detyrimet dhe vlerësimet e studentëve dhe nga i cili studenti jo vetëm të kryejë regjistrimet për provime por të marrë edhe shërbime të tjera lidhur me arritjet e tij akademike.*
- *Sistemi i sekretarisë mësimore duhet të administrojë avancimin akademik të studentit, edhe për argumentet e veçanta të secilës lëndë të parashikuara në programin e saj, duke lehtësuar pedagogun e lëndës nga mbajtja e të dhënave administrative të kësaj fushe.*

Megjithatë, GVJ vlerëson se informacioni i ruajtur nga sekretaria mësimore, bazohet në rregulloren institucionale të Universitetit të Tiranës, dhe nuk është në përgjegjësi apo kompetencë të këtij programi studimi. Njësia bazë, mund të sugjerojë që këto informacione të shtohen në të dhënat e menaxhuara nga sekretaria mësimore.

[Ev.: 43 – Rregullore për funksionimin e sistemit informatik në UT; 108 - Rregullore e sekretarisë mësimore]

Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të

Nga GVJ u konstatua që midis studentëve dhe personelit akademik ekziston një komunikim interaktiv, si fizik, student-staf akademik gjatë orës së mësim, ashtu edhe jashtë saj.

<p>komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Komunikimi mes studentëve, stafit akademik dhe atij administrativ zhvillohet edhe nëpërmjet postës elektronike zyrtare në domain të institucionit, ashtu edhe në modulet e përdorura për komunikim online si Microsoft Teams. Institucioni përdor edhe faqen online institucionale të FSHN lidhur me informacione të detajuara për njoftime të ndryshme lidhur me aktivitete që zhvillohen, mobilitete në kuadër të programeve europiane, tarifa të studimit, informacione të detajuara lidhur me strukturën e vitit akademik dhe të dhëna për fakultetin etj. Njëkohësisht, komunikim kryhet edhe nëpërmjet faqes së Departamentit, në të cilën janë të detajuara edhe të dhënat për secilin nga personeli akademik. Në përgjithësi, i gjithë personeli ka paraqitur të dhëna lidhur me arsimimin, titujt, botimet dhe disipinat që mbulon.</p> <p>[Ev.: 43 – Rregullore për funksionimin e sistemit informatik në UT; 53 – Llogari në MS Teams pedagogu; 54 – Komunikim në MS Teams ndërmjet një studenti dhe një pedagogu; 55 – Komunikim në Microsoft Teams për ngarkimin e leksioneve (literaturës bazë); 74 - Microsoft-office-365-për-student; 75 - e-Student UT Manual përdorimi – Pedagogët; 76 - Sistemi e-Student Manual përdorimi]</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit siguron adresa personale uniforme me domain të institucionit dhe llogari me akses elektronik personal. Gjithashtu, në dispozicion është platforma Teams, faqet zyrtare të UT dhe FSHN ku informacioni është i drejtpërdrejtë në kohë reale si për studentët që duan të informohen ashtu dhe për personelin akademik dhe administrativ që do të informojë.</p> <p>[Ev.: 43 – Rregullore për funksionimin e sistemit informatik në UT; 54 – Komunikim në MS Teams ndërmjet një studenti dhe një pedagogu]</p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Të gjitha informacionet e nevojshme që lidhen me programet e studimit, personelin akademik si dhe aktivitete të ndryshme merren nëpërmjet faqes elektronike të UT, faqes elektronike të FSHN si dhe asaj të departamentit, të cilat rezultojnë të përditësuara. Gjenden informacione të detajuara lidhur me planin mësimor dhe syllabuset e çdo disiplinë. Konstatohet që syllabuset e shkurtuara janë të paraqitura në faqe të departamentit. Japin informacion lidhur me objektivat e lëndës, konceptet themelore, strukturën e disiplinës si dhe mënyrën e vlerësimit.</p>

	[https://fshn.edu.al/; https://unitir.edu.al/eng/]			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.6	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>FSHN harton një raport financiar i cili reflekton te gjithë kërkesat e paraqitura nga njësitë bazë. Draft buxheti është subjekt i diskutimeve në çdo njësi bazë. Përgjegjësi për hartimin e tij janë Administratori i FSHN-së dhe Administratori i UT-së. Bazuar në organigramën e FSHN-së, Administratori ka në varësinë e tij Sektorin e Finances dhe Buxhetit. Detyrat dhe përgjegjësitë e tyre janë dhënë qartë në Statut, në Rregulloren e UT-së dhe të FSHN-së.</p> <p>Financimi i kërkimit shkencor është shprehur në nenin 120 në Statut të UT-së. Në buxhetin e hartuar nga njësi bazë është përcaktuar një plan buxhet afatmesëm dy vjeçar i cili parashikon shpenzimet dhe investimet në infrastrukturë dhe në mbështetjen ndaj kërkimit shkencor të cilën GVJ e gjen në përputhje edhe me strategjinë e zhvillimit të institucionit [Ev.: 1 Statuti i Universitetit të Tiranës; 4 Strategjia E Zhvillimit Të Universitetit Të Tiranës 2018-2023; 5 Strategjia e Departamentit të Informatikës]</p> <p>Raporti financiar përcakton qartë kostot për programim mësimor përmes një analize financiare edhe për tarifën e shkollimit e cila është një nga zërat kryesorë e burimit të të ardhurave në institucion. [Ev.: 76 Kostoja e programeve të studimit FSHN; 48 – Parashikimi i Projekt Buxhetit; 110 - Kostoja e programeve të studimit FSHN]</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive</p>	<p>Hartimi i plan buxhetit për vitin ardhës dhe plan buxheti afatmesëm bazohet në kërkesat dhe standartet e përcaktuara nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë. Plan buxheti përfshin të gjithë zërat për të ardhurat dhe shpenzimet. Neni 144 në Statut të UT-së përcakton edhe burimet e financimit të institucionit. Burimet kryesore të financimit për këtë program studimi janë:</p> <p>a. Buxheti i shtetit;</p>

mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.

- b. Pagesat e studentëve për arsimin;
- c. Të ardhurat nga shërbimet e treta;
- d. Të ardhurat nga veprimtaria kërkimore – shkencore;
- e. Projektet kombëtare dhe ndërkombëtare;

GVJ konstaton se të ardhurat nga tarifat e studentëve janë të konsiderueshme. Programi mësimor ka një qëndrueshmëri në lidhje me numrin e kuotave të pranimit të studentëve dhe atyre aktuale të regjistruar. Departamenti i Informatikës siguron të ardhura edhe nga veprimtaria kërkimore – shkencore. Kjo njësi ka një sërë projektsh përmes të cilave është përmirësuar edhe një pjesë e infrastrukturës mësimore dhe pajisja e laboratorëve me mjete didaktike.

GVJ gjeti evidenca në lidhje me zërat kryesore në drejtim të kërkimit shkencor, mbështetjes së dhënë në drejtim të stafit akademik për botime dhe pjesëmarrje në konferenca, fonde për bibliotekën dhe një analize në lidhje me të ardhurat përftuar nga regjistrimet e studentëve. GVJ konstaton se procesi i hartimit të plan buxhetit është gjithpërfshirës dhe miratohet me vendim të Bordit të Administrimit të UT-së. Plan buxheti parashikon edhe investime në infrastrukturë duke mbuluar pjesërisht nevojat e identifikuara nga njësitë bazë të pasqyruar në raportet e analizës vjetore të organizuar nga njësisë baze për ecurinë e programit mësimor.

[Ev.: 48 – Parashikimi i Projekt Buxhetit; 110 - Kostoja e programeve të studimit FSHN; <https://fshn.edu.al/Info/buxheti/notifications/buxheti-2021>]

Për programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në “Informatikë”, GVJ konstaton :

- a. Një rritje të të ardhurave nga pushteti qëndror në 424,067,595 lekë për vitin 2021 kundrejt 412,865,446 lekë për vitin 2020;
- b. Një rënie të lehtë nga grantet për kërkim dhe kontratat në masën 4,649,284 lekë kundrejt 5,329,250 lekë për vitin 2020;
- c. Tarifat për shkollimin kanë pësuar një rënie për vitin 2021 (96,422,361 lekë) në krahasim me vitin 2019 (133,613,323 lekë) dhe vitin 2020 (103,339,799 lekë);
- d. Totali i të ardhurave për vitin 2021 (525,745,073 lekë) reflektohet me një rritje të lehtë krahasuar me vitin 2019 (522,449,213 lekë) dhe vitin 2020 (521,534,495 lekë) **[Ev.: 13 Tabelat permbledhese Per RVB Informatikë]**

<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishe financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Analiza financiare dhe realizimi i zërave të investimit dhe shpenzimet është subjekt i kontrolleve periodike nga Administratori i FSHN-së dhe Sektori i Financës dhe Buxhetit. Institucioni i nënshtrohet në mënyrë periodike auditimit të brendshëm organizuar nga strukturat përkatëse në varësi të drejtpërdrejtë të Bordit të Administrimit të UT-së dhe auditimit të jashtëm ushtruar nga strukturat shtetërore financiare dhe Ministria e Arsimit dhe Sporteve.</p> <p>[https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2021/04/Urdher-Nr.8-dat%C3%AB-30.03.2021.pdf]</p> <p>[https://unitir.edu.al/programi-i-transparences-2/]</p> <p>[Ev.: 110 - Kostoja e programeve të studimit FSHN]</p> <p>[https://fshn.edu.al/Info/buxheti/notifications/buxheti-2021]</p>
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>UT paraqet në fund të çdo viti akademik MAS dhe MFE raportet vjetore për veprimtarinë e kryer, gjendjen financiare të institucionit, parashikimin për angazhimin e personelit akademik, tarifat e shkollimit për vitin në vijim. Raportet financiare ruhen të dokumentura përmes zbatimit të procedurës së miratuar në lidhje me ruajtjen dhe arkivimin e tyre. Sektori i Financës është përgjegjës për raportimin e realizimit në përqindje të zërave të parashikuar në buxhetin financiar. Analiza financiare e hartuar diskutohet në Senatën Akademik dhe në Bordin e Administrimit ku miratohen edhe aktet për ndërhyrje në raste të mos-realizimit të zërave të parashikuar në buxhet.</p> <p>[Ev.: 110 - Kostoja e programeve të studimit FSHN]</p> <p>[https://fshn.edu.al/Info/buxheti/notifications/buxheti-2021]</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>UT rezulton se ka kapacitete të mjaftueshme financiare (grantet e MAS, të ardhurat nga studentët dhe të ardhura nga shërbime për të tretë etj.) ekzistuese për të realizuar objektivat e tij.</p> <p><i>Duhet të shtohen akoma më tepër zërat financiare për mbështetje të veprimtarive botuese të personelit akademik si dhe për të organizuar dhe mbështetur veprimtari të përbashkëta shkencore me studentët.</i></p> <p>[Ev.: 110 - Kostoja e programeve të studimit FSHN]</p>

	[https://fshn.edu.al/Info/buxheti/notifications/buxheti-2021]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor “Informatike” është ndërtuar referuar kornizës së nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, e organizuar në 180 kredite dhe me kohëzgjatje normale në tre vite akademike. FSHN ka te institucionalizuar të gjithë procedurat që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve në kete program studimi. GVJ i gjen të shprehur qartë në dokumenta baze në nivel institucional deri në nivel programi si vijon më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Statut i UT-së; 2. Rregullore UT-së; 3. Rregullore e FSHN-së; 4. Rregullore e Departamenti të Informatikës; 5. Rregullore e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor ‘Informatikë’; <p>Këto dokumenta përshkruajnë qartë procedurat dhe strukturat përgjegjëse në lidhje me procesin e regjistrimit të studentëve, të zhvillimit të procesit mësimor, të transferimit, procedurën e ankimimit dhe diplomimit të tyre. GVJ gjen hartimin e dokumenteve bazë institucionale në përputhje me Ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe zbatimit të udhëzimeve e MASR nr.10 datë 15.05.2019, nr.17 datë 30.07.2019 .</p> <p>[Ev.: 1 Statuti i Universitetit të Tiranës; 6 Rregullore e UT; 3 Rregullore e Departamentit të Informatikës; 2 Rregullore Programi Studimi Bachelor Informatike; 45 Rregullore Diplomimi për Programet e Ciklit I FSHN]</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Politikat dhe procedurat e pranimit në programin e studimit Bachelor në “Informatike” janë në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Kuotat dhe kriteret pasi janë hartuar dhe miratuar në njësinë bazë, dhe miratuar nga të gjitha hallkat brenda UT, miratohen edhe nga ministria përgjegjëse për arsimin duke u bërë publike edhe në portalin U-Albania për të gjithë kandidatët studentë në të gjithë vendin. Mënyra e pranimit dhe regjistrimit kryhet në përputhje me aktet ligjore të lëshuara nga MAS për të gjithë kandidatët-studentë të vendit në</p>

	<p>çdo vit akademik, duke respektuar gjithë instancat e përfshira në të që nga njësia bazë derisa shpallen fituesit nga FSHN pas verifikimit të të gjithë dokumentacionit përkatës.</p> <p>Politikat dhe procedurat që kanë të bëjnë me përparimin e studentëve, frekuentimin e tyre, përfaqësimin e tyre në organet drejtuese etj, janë të rregulluara nëpërmjet dokumenteve zyrtare të UT, Statutit të UT, rregullores së UT, dhe rregullores së programit të studimit. Në to janë të pasqyruara qartë të drejtat dhe detyrat e studentëve, të cilat garantojnë barazinë ndërmjet tyre. Gjithashtu barazia dhe të drejta të njëjta për të gjithë studentët, garantohet edhe nga elemente të tjerë të rëndësishëm informimi siç janë: faqja elektronike e FSHN, e departamentit, informimi nëpërmjet adresave personale elektronike për çdo student, pjesëmarrja e studentëve në këshillat studentore, në senat, në Bordin e Administrimit, në Komisionet e ndryshme të UT. Garantohet pjesëmarrja e studentëve në aktivitete shkencore dhe sociale. Ata informohen për mundësitë e reduktimit të tarifave të studimit sipas akteve ligjore, informohen në mënyrë të barabartë për mundësitë e mobiliteteve në programe të ndryshme europiane, kanë mundësi këshillimi me psikologun e FSHN kanë të përcaktuar për çdo vit studimi një Kujdestar Akademik dhe pjesëmarrja në veprimtari të tjera akademike dhe sportive apo dhe pjesëmarrje në mobilitete Erasmus. Në nivel institucional është ngritur Komisioni për mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe marrëdhënieve me studentët. Gjithashtu, informacione të mjaftueshme për veprimtaritë e mësipërme gjenden në faqen web të UT, FSHN dhe Departamentit.</p> <p>[Ev.: 1 – Statuti i Universitetit të Tiranës; 2 – Rregullore e Programit Bsc. Informatike; 3 – Rregullore e Departamentit të Informatikës; 6 – Rregullore e UT; 58 – Kujdestari i studentëve të Programit të studimit Bsc. TIK]</p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Institucioni ka përcaktuar qartë procedurat në lidhje me pranimin dhe përzgjedhjen e studentëve. Këto procedura janë të aprovuara nga Senati Akademik dhe zbatohen në mënyrë rigoroze nga njësiti bazë dhe administrative. Institucioni zbaton me korrektësi procedurat në lidhje me pranimin e studentëve. Çdo vit akademik për të ndjekur studimet në ciklin e pare Bachelor në “Informatikë” pranohen studentë nga Shqipëria, Kosova, Maqedoni, Mal i Zi dhe nga vende të tjera nëse kandidatët njohin gjuhën shqipe [Ev.: Neni 25 – Rregullore e programit të studimit]. Kuotat për pranimin e studentëve vendosen nga institucioni por i nënshtrohen një kontrolli në lidhje me plotësimin e standarteve nga MAS. Për</p>

programin e ciklit të parë Bachelor në “Informatikë” kuotat e pranimit për vitin 2020 – 2021 është 244 studentë. Aktualisht në këtë vit janë regjistruar 201 studentë duke përmbushur në masën 82.38% kuoten e pranimit [Ev.: 76 Kostoja e programeve te studimit FSHN].

Bachelor në “Informatikë”		
Viti akademik	Nr. i studentëve të regjistruar për herë të parë	Totali
2017-2018	200	201
2018-2019	202	203
2019-2020	200	201
2020-2021	201	201
2021-2022	113	109

Kriteret e përgjithshme të pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve janë të përcaktuar qartë në Rregulloren Institucionale dhe në Rregulloren e Programit të Studimit Bachelor “Informatikë”. Progresi i studentëve jepet qartë në dokumentat bazë institucionale [Ev.: 6 Rregullore e UT; 3 Rregullore e Departamentit te Informatikes; 2 Rregullore Programi Studimi Bachelor Informatike]. Mënyra e organizimit të programit të studimit, format e mësimdhënies dhe format e vlerësimit shprehen qartë në këto doumenta. Në takimet e zhvilluar në Insitution u theksua puna që kryhet në lidhje me njohjen e tyre nga ana e studentëve që në fillim të çdo semestri akademik. Rrjetet dhe sistemet e informimit përdoren në mënyrë aktive nga ana e stafit akademik dhe institucioni në lidhje me informimin e studentëve. Kriteret e transferimit janë shprehur qartë në rregulloren e programit të studimit Bachelor “Informatikë”. GVJ konstaton zbatimin me korrektësi i procedurës së transferimit të studentëve [Ev.: 59 Ekuivalentime kategoria transferime dege te dyta]. Konkretisht nga të dhënat e paraqitura nga institucioni evidentohen raste shumë të vogla transferimi.

Bachelor “Informatikë”			
Viti akademik	Nr. i studentëve të regjistruar për herë të parë	Studentë të transferuar sipas viteve	Totali
2017-2018	200	1 (viti II)	201
2018-2019	202	1 (viti III)	203
2019-2020	200	1 (viti II)	201

2020-2021	201	-	201
-----------	-----	---	-----

Departamenti i Informatikës në bashkëpunim me sekretarinë mësimore ndjekin procesin e studentëve që në hyrje deri në diplomimin e tyre. Të dhënat e mbledhura janë subjekt i diskutimeve në departament dhe raportimin institucional të tyre në Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve [Neni 122 – Statuti i UT-së].

Mesatarja në hyrje e studentëve është e lartë duke pësuar një rënie të lehtë të saj në përfundim të studimeve.

Bachelor “Informatikë”		
Viti akademik	Nr. i studentëve të regjistruar për herë të parë	Nota mesatare e studentëve në hyrje
2017-2018	200	-
2018-2019	202	9.37
2019-2020	200	9.41
2020-2021	201	9.41


Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t’u pranuar në ciklin e parë të studimeve.

Çdo vit akademik vendosen kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimit Bachelor në “Informatikë”. Kjo realizohet në bazë të procedurës së përcaktuar në Statutin e UT (neni 90), në përgjigje të kërkesës së MAS, me propozim të Departamentit të Informatikës, miratim të Senatit Akademik të UT dhe vendim të MAS. Këto kriteret të pranimit publikohen në faqen zyrtare të UT, FSHN dhe Departamentit të Informatikës, si dhe shpërndahen nëpërmjet broshurës “Mbi programet e studimit dhe kriteret e pranimit” dhe fletëpalosjes”. Kriteret e pranimit” tek maturantët. Kriteret e përgjithshme dhe të veçanta propozohen nga njësia bazë jo më vonë se data 20 Dhjetor.

Si kriteret të përgjithshme janë:

- Kandidatët që kanë përfunduar me sukses maturën shtetërore dhe plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar me VKM;
- Kandidatët që kanë një diplomë të shkollës së mesme ekuivalente të një vendi të huaj;
- Shtetasit e huaj në kushtet dhe mënyrat e parashikuara nga marrëveshjet dypalëshe ose shumëpalëshe;

	<p>Në lidhje me kriteret e veçanta të propozuara nga Departamenti i Informatikës, GVJ konstaton zbatimin e një formule të veçantë për programin e studimit të ciklit të parë Bachelor “Informatikë”:</p> $Piket\ totale = MVKM * 50 + M_{MatematikeB} * 15 + M_{Fizike} * 5 + M_{TIK} * 10 + N_{Matematika12} * 20$ <p>Në këtë formulë konsiderohet mesatarja e Matematikës nga kurrikula bërthamë e vitit të I, II dhe të III, mesatarja e TIK nga kurrikula bërthamë e vitit të I dhe të II dhe nota e Matematikës 12 nga kurrikula me zgjedhje e vitit të III. GVJ konstaton se kriteret e veçanta nuk kanë pësuar ndryshime që në vitin 2019.</p> <p>[https://fshn.edu.al/info/kritere]</p>
<p>Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Institucioni zbaton të gjithë udhëzimet dhe ndryshimet e përcaktuara nga MAS në lidhje me vendosjen e kuotave të pranimit dhe procedurave në lidhje me regjistrimin e studentëve. Informacioni është i shprehur qartë edhe në ëbsite [https://unitir.edu.al/kriteret-e-pranimit-kuotat-dhe-tarifat-e-studimit/]. Për kriteret e pranimit në ciklin e parë, Institucioni bazohet në:</p> <ol style="list-style-type: none"> Udhëzimin e MAS nr.16 datë 29.06.2022; Udhëzim i MASR nr.11 datë 02.06.2021; Udhëzim i MASR NR.10 datë 15.05.2019; Urdher i përbashkët nr.8 datë 3006.2022; VKM nr//.386 datë 0106.2022 Udhëzim mbi fazën e katërt të regjistrimeve për vitin akademik 2022-2023; <p>Duke parë procedurën e ndjekur në bazë të evidencave përkatëse, konstatohet se institucioni në hartimin dhe zbatimin e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta, ndjek plotësisht në mënyrë rigorozë gjithë hapat e parashikuara në aktet nënligjore në fuqi të çdo viti akademik të nxjerra nga MAS si dhe në përcaktimet dhe hapat ligjore të parashikuara në dokumentet zyrtare të UT: Statuti, Rregullore. Planifikimi i kuotave dhe kriterëve të pranimit në ciklin e parë të studimeve shprehet qartë në nenin 90 në Statut të UT-se. Departamenti i Informatikës propozon kuotat e tij jo më vonë se data 10 Dhjetor të vitit parardhës. Kuotat përcaktohen gjithmonë në përputhje me infrastrukturën reale ekzistuese duke siguruar cilësinë dhe standardet ligjore dhe duke respektuar gjithë kategoritë e njohura shoqërore të kandidatëve (brenda vendit, nga trojet, me aftësi të kufizuara, jetimet, shtetas të huaj, romë, kandidatë për transferim studimesh, kandidatë për programe të</p>

	dyta studimi etj) [Ev.: 2 – Rregullore e Programit Bsc. Informatike; 19 – Kuotat e Pranimit Cikli I dhe II; 20 – Kriteret e Pranimit në Ciklin e parë]			
Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	<p>Në bashkëpunim me DRAP dhe ZVA, FSHN dhe Departamenti i Informatikës, organizojnë me nxënësit – maturantë të shkollave të Arsimit të Mesëm të Lartë takime informuese në “javën e informimit”. [https://unitir.edu.al/ditet-e-informimit-per-nxenesit-maturante-ne-universitetin-e-tiranes/]</p> <p>Në këto takime merr pjesë personeli akademik, të cilët informojnë në detaje dhe qartësojnë nxënësit – maturantë mbi të gjitha programet e studimit që FSHN ofron, si dhe mbi procedurat dhe kriteret për t’u regjistruar si student në secilin program studimi. Informacionet për kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të programit të studimit publikohen në ëbsite-in e FSHN [https://fshn.edu.al/Info/kritere; https://unitir.edu.al/kriteret-e-pranimit-kuotat-dhe-tarifate-studimit/]. Në faqet e FSHN dhe Departamentit të Informatikës, gjenden dhe informacione publike në lidhje me programin e studimit, organizmin e institucionit, të drejtat dhe detyrat e studentit, jetën studentore, etj.</p> <p>[Ev.: 2 – Rregullore e Programit Bsc. Informatike; 19 – Kuotat e Pranimit Cikli I dhe II; 20 – Kriteret e Pranimit në Ciklin e parë]</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	<p>GVJ konstaton se një informacion i gjerë vihet në dispozicion të studentëve në lidhje me përmbajtjen e programit të studimit, elementet detyrues të tij dhe progresi i tyre në vite deri në përfundim të studimeve. GVJ evidenton që burimet bazë të informimit janë si vijojnë më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Java Orientuese e cila organizohet nga institucion në çdo vit akademik dhe mundëson studentët të njihen me

	<p>insitucionin, stafin akademik dhe përmbajtjen e programit të studimit;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Dokumnetat bazë (Statut, Rregullore) për të cilat studentët informohen dhe janë të pasqyruar edhe në ëebsite të FSHN-së; • Stafi akademik i cili në fillim të çdo lënde bën informim tek stundetët në lidhje me përmbajtjen e tij, detyrimet për aktivizimin, dorëzimin e detyrave/projekteve të kursit dhe provimin final. Stafi akademik vë në dispozicion të studentëve syllabusin e lëndës i cili pasqyron qartë objektivat formues dhe tematikat që do të zhvillohen në leksione, praktikë dhe laboratorë; • Kujdestari akademik i cili është në dispozicion të studentëve për çdo problematikë që ata kanë në lidhje me lëndët apo me organizimin e praktikës profesionale • Departamenti i Informatikës i cili shpërndan informacion në lidhje me ndryshimet në modulet dhe detyrimet përkatëse të studentëve. Njësia bazë është përgjegjëse edhe për oraret mësimore, mënyrën e organizimit të programit mësimor dhe ndjekjen e progresit të studentëve përmes analizimit të rezultave të tyre në fund të çdo semestri; <p>[Ev.: 2 – Rregullore e Programit Bsc. Informatike; 58 – Kujdestari i studentëve të Programit të studimit Bsc. Informatike; 3 – Rregullore e Departamentit të Informatikës; 6 – Rregullore e UT]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.</p>	<p>Institucioni garanton procedurat për njohjen dhe ekuivalentimin e kualifikimeve. Procedurat e transferimit shprehen qartë në dokumentat bazë:</p> <ol style="list-style-type: none"> Neni 109 në Statut të UT-së; Neni 78 dhe 79 në Rregulloren e UT-së; Neni 28 në Rregulloren e programit të studimit Bachelor ne “Informatikë”; <p>GVJ konstaton zbatimin me korrektesi të praktikës se ekuivalentimit dhe transferimit të studentëve.</p> <p>[Ev.: 59 Ekuivalentime Kategoria Transferime Dege Te Dyta; 60 Shqyrtimi i Dosjeve Dege II Transferime Cikli I Cikli II]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive</p>	<p>Institucioni informon studentët në mënyrë të detajuar lidhur të gjithë elementët dhe procedurat e vlerësimit të tyre në çdo disiplinë. Vlerësimi i dijeve shprehet në dokumentat bazë:</p>

<p>të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>a. Neni 21-24 në Rregulloren e programit të studimit të ciklit të parë “Informatikë”;</p> <p>b. Neni 45 në Rregulloren e UT-së;</p> <p>GVJ konstaton se elementet kryesore të mësimi janë: leksionet, seminarët, orët laboratorike, detyrat/projektet e kursit, provimet e ndërmjetme, provimi final dhe provimi e diplomës. Në lidhje me këto elemente bazë vlerësimi u bëhet e qartë studeteve dhe institucioni garanton transparencën në lidhje me to. Leksionet, seminarët dhe praktikat mësimore zhvillohen në grupe në përputhje me përcaktimet dhe udhëzimet e dhëna nga MAS. Në fillim të çdo lënde stafi akademik informon studentët në lidhje me frekuentimin në leksione, seminare dhe orë laboratorike. Kontrolli i dijeve përcaktohet në Rregulloren e FSHN-së dhe takimi i zhvilluar në institucion evidentoi njohjen e saj nga ana e studentëve [Takim në insitucion].</p> <p>Në takimin e zhvilluar me stafi akademik u theksua nga ana e tyre që ndonëse elementët bazë të vlerësimit të dijeve janë shprehur në syllabus, ata ushtrojnë edhe kontroll për një vlerësim të vazhdueshëm të studentit gjatë orës së mësimi përmes zbatimit të teknikave në mënyrën e organizimit të lëndës në pjesën teorike dhe praktike të saj. Shembuj u sollën nga lëndë të ndryshme ku format e mësimdhënies dhe vlerësimit varionin në përputhje me specifikat e lëndëve [Takim me stafin akademik]</p> <p>GVJ konstaton në syllabuset e lëndëve të paraqitur nga ana e institucioni që përmbajnë të gjithë elementët e vlerësimit. Pikët e grumbulluar nga studenti konvertohen në notë sipas përcaktimeve ligjore. Studenti ka të shprehur qartë në Rregulloren e UT-së afatet e informimit të tij në lidhje me vlerësimin dhe procedurën e ankimimit. Takimi me studentit solli shembuj të rasteve për rishikimin në lidhje me vlerësimin e bërë nga ana e pedagogut dhe evidentoi njohjen e saj si procedurë nga ana e studentëve [Ev.: 6 Rregullore e UT; Ev. 2 Rregullore Programi Studimi Bachelor Informatike; Takim me studentet]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Procedura e provimit të diplomës shprehet qartë në Rregulloren e UT-së (neni 59 i saj), në Rregulloren e Diplomit për Programet e ciklit të parë dhe të dytë në FSHN [Ev.: 6 Rregullore e UT; 45 Rregullore Diplomimi per Programet e Ciklit I FSHN]. Studenti informohet në fillim të vitit të tretë në lidhje me provimin. GVJ konstaton ndjekjen korrekte të procedurës së diplomimit e cila finalizohet me provim</p>

	diplomë. Në lidhje me zhvillimin e saj diskutime u bënë në takim me stafin akademik dhe studentet. Pjesëmarrësit theksuan inkorporimin e praktikës profesionale me provimin e diplomes por vlerësuar me 3ECTS dhe jo detyruese. [Takim me stafin akademik] .			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	FSHN është aktive në lidhje me informimin e studentëve. Faqja website ofron një gamë të gjerë informimi në lidhje me programin mësimor, kuotat, kriteret e veçanta, infrastrukturën e tj. Broshura, fletëpalosje vihen në dispozicion të publikut me qëllim informimi. Fushata ndërgjegjësimi ndërmerren nga Departamenti i Informatikës në Bashkëpunim me Drejtoritë Arsimore Rajonale duke organizuar edhe takime me gjimnazistët e shkollave të mesme dhe informimin e tyre për programin e studimit. [https://unitir.edu.al/ditet-e-informimit-per-nxenesit-maturante-ne-universitetin-e-tiranes/]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	GVJ konstaton një mirë informim të studentëve në lidhje me programin mësimor. Takimi i zhvilluar me ta solli shembuj të informimit që në javën e parë të regjistrimit të tyre me fakultetin, mjediset dhe stafin. Tabela informuese janë vendosur në vende të dukshme për të dhënë informacion në lidhje me oraret mësimore dhe klasat për zhvillimin e tyre. Kujdestari akademik i cili caktohet nga njësia bazë në fillim të çdo viti akademik është përgjegjës për orientimin e studentëve. Sekretaria mësimore është përgjegjëse për regjistrimin e studentëve duke informuar ata në lidhje me dokumentacionin plotësues dhe pajisur me kartën e studentit dhe për detyrimet që ata kanë gjatë procesit mësimor. Të drejtat dhe detyrimet e studentëve në lidhje me programin mësimor shprehen qartë edhe në dokumentat bazë. [Ev.: 58 – Kujdestari i studentëve të Programit të studimit Bsc. Informatike; 2 – Rregullore e Programit

	<p>Bsc.Informatike; 3 – Rregullore e Departamentit të Informatikës; https://unitir.edu.al/ditet-e-informimit-per-nxenesit-maturante-ne-universitetin-e-tiranes/</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Informacioni rezulton të merret në Javën Orientuese në javën e parë të vitit akademik, merret nga çdo titullar i lëndëve, i cili informon në detaje strukturën, përmbajtjen, frekuentimin, vlerësimin, kreditet, objektivat, veprimtaritë formuese dhe qëllimet e lëndës. Studentë këto informacione mund ti marrin edhe nëpërmjet faqes web, nëpërmjet sistemit elektronik ndërmjet sekretarisë mësimore dhe bibliotekës së FSHN.</p> <p>[Ev.: 2 – Rregullore e Programit Bsc. Informatike; 3 – Rregullore e Departamentit të Informatikës; https://unitir.edu.al/ditet-e-informimit-per-nxenesit-maturante-ne-universitetin-e-tiranes/]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>Institucioni informon studentët në lidhje me oferta për punësim përmes zyrës së Këshillimit të Karrierës & Alumni e ngritur në nivel universiteti dhe prej 6 muajve të fundit e ngritur edhe në nivel fakulteti. Kjo zyrë përmes aktiviteteve të saj ofron mundësi dhe alternativa për punësim të studentëve duke shfrytëzuar marrëvshjet institucionale me kompani biznesi. GVJ konstaton si vijon më poshtë aktivitete bazë në këtë drejtim:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. Takime face – to –face të cilat mundësojnë studentin të ketë kontakte të drejtpërdrejta me punëdhënësit; b. Rrjete sociale. Përmes tyre studentët kanë mundësi informimi në lidhje me ofertat e parqitura nga kompani biznesi; c. Sektori i karrierës ka krijuar edhe nje data base i cili mban të dhëna në lidhje me studentët e diplomuar dhe siguron kontakte të vazhdueshme me studentët alumni. Në lidhje me këtë gjurmimi i studentit është një nga aspektet e rëndësishme të punës së kësaj strukture. Për këtë kjo njësi ndërmer një pyetsor online i cili mundëson pasurimin e të dhënave për studentët e diplomuar [https://fshn.edu.al/Info/gjurmimi-i-studenteve/]. d. Zyra e Karrierës & Alumni zhvillon edhe Panairin e Karrierës, aktivitet i cili krijon mundësi studentëve të njihen me kompani biznesi dhe me kërkesat e tyre. e. Njoftime në tabela informuese të cilat vendosen në vende të dukshme në holle apo korridore ku studentët në kohë pushimi kanë mundësi të marrin informacion.

	<p>[Takime në institucion]</p> <p>Në lidhje me orientimin e studentëve drejt tregut të punës një rol të rëndësishëm luan edhe zgjedhja e temës së diplomës e cila profilizon stundetët për karrierën e tyre të ardhshme</p> <p>[Takim me stafin akademik]</p>			
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>GVJ konstaton se Departamenti i Informatikës mundëson një shpërndarje të informacionit në shumë drejtime gjatë gjithë karrierës universitare në mënyrë të vazhdueshme. Përmes punës së tij studentët informohen në lidhje me të drejtat, detyrat dhe udhëzimet informuese për procesin mësimor. Informacioni shpërndahet përmes:</p> <ol style="list-style-type: none"> Stafit akademik të cilët pasqyrojnë tek studentët syllabusin e lëndës me elemente e tij përbërës [Ev.: 9 Syllabuset Bachelor në Informatikë 2020-2021 skanuar]; Kujdestari akademik ë cili është përgjegjës për informimin e studentëve. Platformat elektronike ku studentët marrin njoftime rreth orarit mësimor; Sekretaria mësimore ku studentët informohen rreth vlerësimit në lëndët e programit të studimit që ndjekin. Rubrika “Studenti” në website të FSHN-së ofron informim të studentëve në lidhje me oraret mësimore, provimet, njoftime, bursa, aktivitete e Këshillit Studentor etj <p>[https://fshn.edu.al/Info/gjurmimi-i-studenteve; http://37.139.119.36:81/orari/student; https://fshn.edu.al/info/provime]</p>			
<p>Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.</p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve												
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.</p>	<p>FSHN dhe Departamenti i Informatikës zotërojnë të dhëna në lidhje me studentët e diplomuar në cdo vit akademik. Mbështetur në ligjin nr.80/2015 të dhënat e studentëve mbahen, administrohen, monitorohen dhe kontrollohen në sekretarinë mësimore. Të dhënat mbahen në formë të shkruar dhe elektronike në regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave [Plotesim dok.]</p> <table border="1" data-bbox="608 629 1359 958"> <thead> <tr> <th data-bbox="608 629 863 734">Programi i studimit</th> <th data-bbox="863 629 1050 734">Viti Akademik</th> <th data-bbox="1050 629 1359 734">Numri total i të diplomuarve</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="608 734 863 790"></td> <td data-bbox="863 734 1050 790">2018-2019</td> <td data-bbox="1050 734 1359 790">233</td> </tr> <tr> <td data-bbox="608 790 863 898">Bachelor në "Informatikë"</td> <td data-bbox="863 790 1050 898">2019-2020</td> <td data-bbox="1050 790 1359 898">166</td> </tr> <tr> <td data-bbox="608 898 863 958"></td> <td data-bbox="863 898 1050 958">2020-2021</td> <td data-bbox="1050 898 1359 958">165</td> </tr> </tbody> </table> <p>GVJ zhvilloi edhe një vizitë në Sekretarinë Mësimore dhe konstatoi se plotesimi i regjistrin të lëshimit të diplomave dhe certifikatave është në <i>përputhje me standartet dhe udhëzimet e MAS [Vizitë në institucion]</i>.</p> <p>Të dhënat reflektohen në analizën vjetore të Departamentit të Informatikës dhe në raportin vjetor institucional të UT-së [Ev.: 26 Analiza Vjetore e Departamentit të Informatikës; 22 Raporti Vjetor FSHN UT 2020-2021].</p>	Programi i studimit	Viti Akademik	Numri total i të diplomuarve		2018-2019	233	Bachelor në "Informatikë"	2019-2020	166		2020-2021	165
Programi i studimit	Viti Akademik	Numri total i të diplomuarve											
	2018-2019	233											
Bachelor në "Informatikë"	2019-2020	166											
	2020-2021	165											
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Sekretaria mësimore është përgjegjëse për mbledhjen e informacionit dhe administrimin e dokumentacionit për çdo student që në momentin e regjistrimit të tij deri në përfundim të studimeve. Kjo strukturë administron të dhëna në lidhje me procedurat e transferimit dhe ç'regjistrimet që mund të ketë gjatë vitit akademik. Të dhënat pasqyrohen edhe në Departamentin e Informatikës. Sektori i Arkives dhe Protokollit administron edhe procedurat në këtë drejtim. Të dhënat në lidhje me studentët mbahen në formë elektronike dhe hard copy. Të dhënat hidhen në dy regjistra bazë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Regjistri themeltar i studentëve;</i> • <i>Regjistri i arritjeve akademike;</i> <p>GVJ konstaton gjate vizitës së kryer në Sekretarinë Mësimore zbatimin me korrektësi të ruajtjes së të dhënave.</p>												

	GVJ në përputhje gjeti regjistrimin përfundimtar të studentëve me numrin e matrikulimit.
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.	<p>Sekretaria mësimore është përgjegjëse për mbajtjen e të dhënave në lidhje me ecurinë studentëve. GVJ verifikoi në vizitën e kryer në sekretarinë mësimore rregjistrin e arritjeve akademike. Verifikimi u bë me të dhënat e dy studenteve të përzgjedhur në mënyrë rastësore në një procesverbal provimi me notat përkatëse të studentëve të zgjedhur të hedhur në regjistrin e arritjeve akademike. Verifikimet gjejnë një përputhje të notave dhe në tërësi plotësimi i tij është në përputhje me kuadrin ligjor. Departamenti i informatikës analizon të dhënat dhe reflekton në fund të vitit në analizën vjetore kalueshmërine për çdo lëndë të programit të studimit [Vizitë në institucion].</p> <p>GVJ konstaton se mungon informacion në sekretarinë mësimore në lidhje me detyrimet lëndore. Këto të dhëna administrohen nga pedagogu i lëndës bazuar në nenin 15 të Rregullores së programit të studimit. Bazuar për sa më sipër, GVJ konstaton se mungon informacion në sekretarinë mësimore për elementet e vlerësimit si detyrimet në frekuentim, detyrimet në orët laboratorike, detyra/projekte kursi etj. Mungesa e një informacioni mund të krijojë problematikë nëse një student kërkon informacion për detyrimet e tij dhe të bëjë shlyerjen e tyre.</p> <p><i>GVJ sugjeron që të gjenden instrumentat e duhur që ky informacion të zotërohet edhe në sekretarinë mësimore në mënyrë që informimi i studentit të jetë pa vonesa.</i></p>
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Të dhënat e studentëve ruhen në regjistrat bazë dhe janë subjekt kontrolli dhe verifikimi të vazhdueshëm. Të dhënat statistikore mbi procesin mësimor të studentëve të përmendura me lart menaxhohen nëpërmjet sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit duke ruajtur konfidencialitetin [Takim në institucion].
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	GVJ u njoh me analizën vjetore që Departamenti i Informatikës harton në fund të çdo viti akademik. Në këtë raport një pjese e analizës është edhe ecuria e procesit mësimor, numri i studentëve të regjistruar, kalueshmëria në çdo lëndë dhe numri i studentëve të diplomuar. Analiza vjetore shoqërohet edhe me pasqyrimin e problematikës dhe hapat konkrete për përmirësimin e tyre. Në përputhje me udhëzimet e MAS, të dhënat përpunohen në nivel insitucional dhe një raport vjetor dorëzohet pranë MAS në

	fund të çdo viti akademik [Ev.: 21 – Raporti Vjetor FSHN UT 2019 – 2020; 22 – Raporti Vjetor FSHN UT 2020 – 2021; 92 - Raporti i Vlerësimit të Lëndëve Semestri I 20-21; 96 - FSHN Raporti Shkencor 2018-2019; 106 - Vendim nr.54-1 datë 20.12.2021 Për miratimin e raportit vjetor të veprimtarisë së UT 2020-2021]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	<p>Përfshirja e studentëve në proceset vendimmarrëse është një atribut i shprehur në dokumentat bazë dhe një kërkesë e MAS. GVJ konstaton përfaqësimin e studentëve në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Senatin Akademik; • Komisionin e mbarëvajtjes së veprimtarisë dhe marrëdhënieve me studentët; • Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standarteve të Cilësisë; • Komisionin e Përhershëm të Kurrikulës; • Këshillin e Etikës; <p>[Ev.: 1 - Statuti i Universitetit të Tiranës]</p>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	<p>Studentët janë pjesë e procesit të vlerësimit të programit mësimor dhe të stafit akademik përmes plotësisht të pyestorëve në fund të cdo semestri akademik ndonëse pjesëmarrja e tyre në këtë proces është pak e dobët. Bazuar për sa më sipër kërkohet nga ana e institucionit:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>të bëhet një punë më e madhe në lidhje me rritjen së pjesëmarrjes të studentëve në procesin e anketimit duke garantuar marrjen e një feedback-u më real në lidhje me ecurinë e programit të studimit;</i>
Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën	<p>Në hartimin e programeve të studimit merren në konsideratë gjithë rekomandimet për ngarkesën akademike të studentëve në auditor dhe mësim jashtë auditorit sipas parashikimeve ligjore</p>

akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.

e nënligjore në fuqi. Numri i orëve totale në auditor dhe për studim individual është si më poshtë:

Ngarkesa mësimore:

Viti	Orë në auditor	Orë studim individual
I	675	825
II	615	885
III	698	802
Total	1988	2512

[Ev.: 13 Tabelat permbledhese Per RVB Informatikë]

GVJ ndërromori një takim me përfaqësues të Zyrës së Kurrikulave. Një pjesë e punës së tyre konsistonte në rishikimin e programit mësimor në përputhje me udhëzimet e MAS. GVJ konstaton se përmirësimet e bëra në programin mësimor në masen 20% nuk kanë sjellë një rritje të ngarkesës mësimore të studentit. Konkretisht:

	Lënda/Moduli	ECTS	Ore në auditor	Orë studim individual	Totali
1	Lënda ishte Inxhinieri softi dhe programin në web	10	101	149	250
	Lënda u bë Inxhinieri softi	5	42	83	125
	Lënda u bë programim në web	10	117	133	250
2	Lënda ishte Llogjike Qarqesh (viti III)	5	60	65	125
	Lënda u bë Llogjike qarqesh (Viti I)	5	60	65	125
3	Lënda ishte Algoritëm në C++	12	135	165	300
	Lënda u bë Algoritmike	6	75	75	150

		Lënda u bë Programim në C++	6	60	90	150
	4	Lënda ishte Elektronike		60	665	125
		Kjo lënde është hequr nga programi mësimor		-	-	-

Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.

Institucioni përmes anketimeve të kryera përfshin studentët në dhënien e mendimit të tyre në lidhje me procesin mësimor. Në takimin e zhvilluar me përfaqesues të Zyrës së Kurrikulave u soll si shembull heqja e lëndës së “Kimise” si pasojë edhe të kërkesës së shprehur nga studentët [**Takime në institucion**]

Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.

Nga pikëpamja ligjore, në Rregulloren e UT dhe Rregulloren e programit të studimit, studentëve ju garantohej plotësisht mundësia për të ankimuar procesin e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve si dhe rezultatin në to, me një procedurë plotësisht të përcaktuar. Nga biseda e GVJ me studentët, rezultoi që kjo realizohet në realitet konform rregullores.

[Ev.: 1 - Statuti i Universitetit të Tiranës; 3 – Rregullore e Departamentit të Informatikës]

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht

Standardi V.6

Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në	Institucioni garanton informimin e studentëve përmes zbatimit të akteve ligjore të shprehur në dokumentat bazë [Ev.: 1 Statuti i Universitetit të Tiranës; 2 Rregullore

<p>përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>Programi Studimi Bachelor Informatike; 3 Rregullore e Departamentit të Informatikës; 6 Rregullore e UT; 45 Rregullore Diplomimi per Programet e Ciklit I FSHN; 43 Rregullore Per Funkcionimin E Sistemit Informatik Në Universitetin E Tiranës]. Në shërbim të informimit të studentëve janë edhe strukturat mbështetëse administrative: Sekretaria mësimore, Zyra e Karrieres & Alumni, Biblioteka e FSHN-së. Departamenti i Informatikës angazhon në çdo vit mësimor Kujdestarin Akademik i cili është përgjegjës për informimin, dhënien e ndihmës dhe mbështetjes ndaj studentëve. Ndryshimet ligjore, udhëzimet dhe njoftimet jepen përmes Dekanatit të FSHN-së dhe Shefit të Departamentit të Informatikës. Në këtë drejtim shfrytëzohen rrjetet sociale, njoftimet në ëbsite, platformat eletronike duke garantuar shpërndarjen e tij në kohë reale [Takime në institucion]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Në FSHN tashmë është ngritur në nivel fakulteti edhe zyra e Karrierës & Alumni e cila përfshihet ne sektorin e NJSBC. Kjo zyrë është përgjegjëse për informimin e studentëve, këshillimin dhe ofrimin e asistencës. Zyra e Karrieres & Alumni bashkëpunon me sekretarinë mësimore duke marrë të dhënat baze të kontaktit për çdo student. Kjo zyrë bashkërendon punën për të ndjekur ecurinë e studentëve dhe punësimin e tyre [Takim në institucion].</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Informatike” nuk ka të parashikuar praktikë profesionale si element të veçantë në programin mësimor, nga ku studentët të mund të kishin një qasje jo vetëm për praktikë, por edhe për zhvillim karriere.</p> <p>Institucioni ka të ngritur degën e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës e cila kë edhe përgjegjësinë së bashku me njësinë bazë, të orientojë studentët drejt karrierës së tyre profesionale. Gjatë takimit në institucion, dhe në veçanti me studentët, u vu re se kjo njësi informon studentët kryesisht me anë të postës elektronik rreth mundësive për punësim apo intershipe. Megjithatë nuk ka një qasje të orientuar rreth këshillimit të studentëve për qasjen që duhet të kenë në fillimin e karrierës së tyre profesionale. Kjo edhe si rrjedhojë e numrit të ulët të personelit të angazhuar në këtë sektor.</p> <p>Për të rritur cilësinë e shërbimit të këshillimit të karrierës, mendojmë se institucioni duhet të rrisë përfshirjen e kësaj njësie në takime jo vetëm virtuale por edhe në auditor me studentët jo vetëm për të parashtuar njoftimet e kompanive për punë apo intershipe, por edhe për ti orientuar ata rreth tregut të punës, mundësive të zhvillimit profesional apo krijimin e</p>

	start-up apo kompani në fushën e këtij programi studimi [Ev.: 40 – Manuali i sigurimit të cilësisë UT].			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Njësia që informon, këshillon dhe orienton studentët gjatë studimeve deri në diplomim me kontakte të drejtpërdrejta ose me material informuese, edhe në ciklin e dytë dhe më pas duke mbledhur të dhëna për punësimin e tyre edhe pas diplomimit është Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës. Kjo zyrë ndërmer pyetorë online për studentët e diplomuar duke garantuar një gjurmim efektiv të tyre. Gjithashtu UT organizon në mënyrë periodike edhe panairët e punës ku studentët mund të marrin informacione direkt nga punëdhënës të ndryshëm.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI.SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Bazuar tek dokumentacioni i vënë në dispozicion si dhe nga takimet me përfaqësues të Drejtorisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Drejtorisë së Kurrikulave, GVJ konstaton se institucioni ka hartuar politika dhe struktura të posaçme për sigurimin e brendshëm të cilësisë në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale [Takime në institucion].
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për	Bazuar ne Statutin e Ri hartuar në vitin 2018 dhe bazuar në rekomandimet e dhëna në akreditimin insitucional të UT-së janë ngritur strukturat e sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel universiteti dhe fakulteti. Konkretisht janë në funksion:

<p>përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<ul style="list-style-type: none"> a. Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (nivel universiteti) b. Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC) (nivel universiteti) c. Sektori i Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (nivel universiteti) d. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (nivel fakulteti) <p>Institucioni ka miratuar edhe Rregulloren për Sigurimin e Cilësisë në UT dhe Manualin e Sigurimit të Cilësisë. Veprimtaria e tij mbështetet mbi hapa konkrete përmes një plan veprimi afatgjatë (2021-2024).</p> <p>[Ev.: 1 - Statuti i Universitetit të Tiranës; 40 – Manuali i sigurimit të cilësisë UT; 62 – Komisioni i përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë, Vendim Nr. 10, Datë 11.04.2019 i Senatit Akademik; 68 - Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT; 94 - Miratimi i planit të veprimit për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2021-2024]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>UT i nënshtrohet akreditimit të jashtëm periodik. Me vendim të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Bordi i Akreditimit përmes vendimit nr. 84 datë 27.10.2018 ka dhënë një vlerësim pozitiv për cilësinë akademike në këtë institucion me një afat 4 vjeçar (26.10.2022). Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Informatikë” është liçensuar përmes vendimit të MA nr.31 datë 30.12.1994 dhe vlerësimi i jashtëm i programit të studimit Bachelor në “Informatikë”, me qëllim akreditimin e programit, po realizohet për herë të parë nga ASCAL [Ev.: 66 Vendimi i Bordit të Akreditimit Nr.84, date 27.10.2018]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Bazuar në evidencat përkatëse dhe nga vëzhgimi gjatë vizitës në institucion, Universiteti i Tiranës ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike në kuadër të Sigurimit të Cilësisë së Brendshme me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimeve që ofron. Në dokumentet zyrtare siç është Statuti i UT-së parashikohen qartë procedurat e posaçme për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve që ofrohen.</p> <p>Në rregulloren e sigurimit të cilësisë janë përcaktuar procedurat, afatet, instrumentet dhe burimet për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Njëkohësisht, në ndihmë të këtij procesi përveç pyetësorëve periodikë, Departamenti i Informatikës harton dhe në mënyrë të përvitshme analizat vjetore të punës së tij dhe harton dhe panin e masave për</p>

	përmirësime te mundshme. [Ev.: 1 - Statuti i Universitetit të Tiranës]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Në përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen dhe rishikimin e programeve të studimit të Ciklit të parë, rezulton që UT ka të ngritura njësi të posaçme kryesore: Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC) dhe Komisioni Përhershëm i Kurrikulës etj.</p> <p>Njëkohësisht, në nivel njësie kryesore, është ngritur dhe funksionon realisht Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK). Në këtë kuadër, dhe në mbështetje edhe të njësive të mësipërme, koordinimi i Përgjegjësit të Departamentit me zv. Dekanin që mbulon Ciklit të Parë të studimeve dhe zv. Dekanin që mbulon kërkimin shkencor, ndihmon në realizimin e analizave të punës mësimore-kërkimore dhe hartimin e raporteve përkatëse, të cilat më pas integrohen në raportimet vjetore si FSHN.</p> <p>Për një analizë më efektive, bazuar edhe në ndryshimet e shpejta teknologjike në fushën e teknologjisë së informacionit, si dhe në ngarkesën administrative të drejtuesit të njësisë bazë, monitorimi dhe rishikimi i programit të studimit bazuar kryesisht vetëm në analizën e drejtuesit të njësisë kryesore, nuk rezulton efektiv. Kjo bazuar edhe në numrin e lartë të programeve të studimit që ofron kjo njësi bazë (tetë programe në total) dhe angazhimeve të tjera administrative të kërkuara prej drejtuesit të saj.</p> <p><i>Ne si GVJ propozojmë që për të rritur efikasitetin e monitorimit dhe rishikimit të programeve të studimit, do të ishte me interes ngritja e Këshillit të Programeve të Studimit (KPS) për çdo program studimi të ofruar. Ky këshill, i dedikuar për një program studimi, do të kishte fokusin e tij të mirë përcaktuar dhe rezultatet do të jenë më efektive në</i></p>

	<p><i>funksion të rritjes së cilësisë në tërësi të shërbimeve të ofruara në kuadër të vet programit të studimit.</i></p> <p>[Ev.: 1 - Statuti i Universitetit të Tiranës; 40 – Manuali i sigurimit të cilësisë UT]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Institucioni përdor mekanizma dhe procese të cilat zhvillohen mbi bazën e nje kuadri ligjor të përcaktuar qartë në dokumentat bazë. Departamenti i Informatikës shqyrton veprimtarinë mësimore dhe harton raportet vjetore duke pasqyruar problematikat dhe hapat konkrete në drejtim të përmirësimit. GVJ konstaton se ndiqen dhe zbatohen me korrektësi të gjithë udhëzimet dhe standartet e përcaktuara nga MAS. [Ev.: 68 - Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT; 94 - Miratimi i planit të veprimit për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2021-2024; 23 – Shkresë përcjellëse për raportet mbi veprimtarinë mësimore dhe kërkimore – shkencore]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës në FSHN përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve të cilat bazohen në dokumentin “Paketa e instrumenteve të cilësisë” të miratuar nga Senati Akademik. Këto mekanizma përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • vlerësimin e lëndës nga studenti (pyetësor që plotësohet përpara provimit); • vlerësimi i studentëve që diplomohen (pyetësor që plotësohet përpara se të marrin diplomën për cilësinë e programit të studimit); • raporti i studentëve (pyetësor me studentët e diplomuar për cilësinë e arsimimit të tyre); • vlerësimi i pedagogut (pyetësor që plotësohet nga studentët përpara provimit); • Raport i vetëvlerësimit të lëndës nga pedagogu (i cili plotësohet nga çdo personel akademik në fund të çdo semestri në lëndët ku janë titullarë duke kryer një vetvlerësim dhe analizë bazuar në përqindjen e kalueshmërisë të studentëve dhe shpërndarjes së notave në përqindje); <p>Prej tyre, prodhohen statistika për program studimi, për lëndët e programit të studimit, për metodat e mësimdhënies (rasti i veçante i përdorimit të platformës online në kohën e pandemisë) si dhe analiza për përmirësimin e mëtejshëm të veprimtarisë akademike dhe programit mësimore aty ku shihet e nevojshme. Të gjitha këto mekanizma janë të</p>

	<p>unifikuar dhe të përfshira në Manualin e Cilësisë, Paketën e instrumenteve të cilësisë të miratuara në Senatin Akademik.</p> <p><i>Problem mbetet përqindja e ulët e pjesëmarrjes së studentëve në plotësimin e pyetësorëve. Ndoshta duhet të shtohet në këto mekanizma, edhe një vlerësim nga vetë personeli akademik, lidhur me infrastrukturën apo elemente të tjera të organizimit të institucionit.</i></p> <p>[Ev.: 40 – Manuali i sigurimit të cilësisë UT; 57 – Vendimi i Bordit të Akreditimit Nr. 84, datë 27.10.2018; 62 – Komisioni i përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë, Vendim Nr. 10, Datë 11.04.2019 i Senatit Akademik; 68 - Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT; 94 - Miratimi i planit të veprimit për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2021-2024]</p>
<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Rezultatet e pyetësorëve nga studentët përpunohen në formë statistikore dhe konform Manualit të Cilësisë dhe Rregullores së Sigurimit të Cilësisë [Ev.: 40 UT Manual i sigurimit të cilësisë; 38 RREGULLORE E DSBC FSHN; 65 Rregullore për sigurimin e cilësisë]. Të dhënat i percillen Departamentit të Informatikës për informim dhe përmirësim. Rezultatet reflektohen edhe në raportet vjetore që hartohen në nivel departamenti dhe njësi kryesore dhe vijon më pas me përcjelljen e tyre Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve [Ev.: 35 Raport Vjetor DSBC 2020_2021; 71 Plan Masash Departamenti i Informatikës; 74 Raporti i Vlerësimit Te Lendeve Semestri I 20-21; 22 Raporti Vjetor FSHN UT 2020-2021; 26 Analiza Vjetore e Departamentit të Informatikës]</p> <p><i>Në takimin e zhvilluar në institucion u theksua që pyetësorët janë sipas formatit të hartuar nga strukturat në nivel universiteti dhe ndihet e nevojshme difersifikimi i tyre në përshtatje me specifikat e programeve mësimore në FSHN [Takim në institucion].</i></p>
<p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.</p>	<p>Raportet e vlerësimit përfshijnë evidenca në lidhje me vlerësimet e bëra për programin e studimit dhe stafin akademik. Departamenti i Informatikës diskuton çështjet e dala nga të dhënat e mbledhura dhe harton një plan masash për përmirësim. Konkretisht GVJ u njoh me marrjen e masave në drejtim të përmirësimit të kushteve laboratorike, ndërkombëtarizimit për vitin akademik 2020-2021 ndërsa shtron si problematikë kërkesën për 6 pedagogë të rinj plotësimi i të cilës do të sjellë edhe reduktim të ngarkesës mësimore të stafit ekzistues por edhe ndikon në rritjen e</p>

	cilësisë së mësimdhënies [Ev.: 71 Plan Masash Departamenti i Informatikës]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Norma	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3	
Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë kryen në mënyrë periodike vlerësimin e programit të studimit. Sektori i sigurimit të brendshëm të cilësisë në bashkëpunim me NJSBC në FSHN ndërmerr në fund të çdo semestri anketime për programin mësimor. Të dhënat e mbledhura shërbejnë për hartimin e raporteve të vetvlerësimin të brendshëm në proces akreditimi. GVJ zhvilloi një takim me anetarët e GVB dhe konstaton se hartimi i raportit është realizuar përmes hulumtimit dhe bashkëpunimit me të gjitha strukturat në tre nivelet [Takim në institucion].
Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.	Për kryerjen e vlerësimit Institucioni zhvillon metoda dhe forma të cilat variojnë në funksion të qëllimit dhe objektivave që ka çdo strukturë e ngritur. Cilësia e mësimdhënies monitorohet dhe vlerësohet nga Departamenti i Informatikës përmes diskutimeve në mbledhje dhe në analizën periodike që ndërmerr. Në shërbim të vlerësimit të stafit akademik shërben edhe Manuali i vlerësimit të performancës së personelit akademik [Ev.: 72 Manuali i Vlerësimit të Performancës së Personelit Akademik të Universitetit të Tiranës]. GVJ zhvilloi takim edhe me Zv. Dekanen për anën mësimore e cila bazuar edhe në detyrat e përcaktuar në Rregulloren e FSHN-se ndjek hartimin dhe zbatimin e masave në lidhje me përmirësimin e programeve mësimore dhe masat për reduktimin e problematka që viti akademik ka shfaqur gjatë procesit mësimor [Takim në institucion].
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të	GVJ konstaton zbatimin e metodave të drejtpeëdrejta në drejtim të vlerësimit të cilësisë së programit të studimit. Konkretisht përmendim:

<p>studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>a. Analiza vjetore në tre nivelet për zhvillimin e programit të studimit;</p> <p>b. Analiza në lidhje me zhvillimin e procesit mësimor online;</p> <p>c. Plan masash për përmirësimin e problematikave të shfaqura në vitin akademik në procesin mësimor;</p> <p>d. Anketimet me studentët të ndërmarrë nga zyra e NJSBC-së.</p> <p>e. Analiza vjetore në lidhje me performancën e stafit akademik dhe arritjet kërkimore – shkencore;</p> <p>[Ev.: 71 Plan Masash Departamenti i Informatikës; 39 Raporti mbi sondazhin e mesimit online; 68 1841_1 Prot. Përcillen raportet e pyetësorëve të zhvilluar për vitin akademik 2020-2021]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutuara nga ky program.</p>	<p>GVJ konstaton zbatimin e metodave të tërthorta në lidhje me vlerësimin dhe garantimin e cilësisë në programin e studimit Bachelor në “Informatikë”. Në këtë drejtim po punohet drejt:</p> <ul style="list-style-type: none"> • zhvillimit të anketimeve përmes shpërndarjes së pyetsoreve tek studentët. Duhet theksuar që punë po zhvillohet në drejtim të rritjes së pjesëmarrjes së tyre në procesin e anketimit i cili do të sigurojë një feedback më real në lidhje me programin e studimit dhe problematikat që ai mbart; • Mbledhjes se të dhënave nga sekretaria mësimore në lidhje me rezultatet e provimeve, kalueshmëria etj. • Marrjes informacion nga Këshilltari Akademik i cili është në kontakte të drejtpërdrejta me studentët dhe më pranë mendimit dhe opinionit të tyre. • Gjurmimi i studentëve të diplomuar përmes anketimit online nga ana e zyrës së Karrieres & Alumni mundëson marrjen e mendimit për programin e mesimit dhe përmbajtjen e tij në përputhje me kërkesat e tregut të punës. • GVJ konsideron kontaktet me kompanitë e biznesit dhe krijimin e mundësisë për pëthithjen e mendimit të tyre në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm të kurrikulës. • Studimet në lidhje me tendencat e tregut të punës në fushën e informatikës përfutuar nga studime të mirefillta tregu.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Mbështetur në gjithë dokumentet zyrtare të tij, UT parashikon dhe garanton në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. Një nga aktorët e rëndësishëm të brendshëm janë studentët, të cilëve ju garantohet edhe pjesëmarrja aktive në organet vendimmarrëse në të gjitha nivelet, por edhe në struktura si Komisioni i përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë, Komisioni i përhershëm i kurrikulës apo angazhohen edhe në Grupet e vlerësimit të brendshëm për vlerësime institucionale dhe të programit të studimit. Në dokumentet zyrtare si Statuti dhe rregullore të tjera institucionale, UT ka të sanksionuar një politikë dhe procedurë të brendshme të përcaktuar qartë në funksion të përmirësimit të cilësisë së programeve të studimit.</p> <p>[Ev.: 1 - Statuti i Universitetit të Tiranës; 6 - Rregullore e UT]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Raportet vjetore reflektojnë qartë mendimin e përthithur të studentëve në pyetsorët e plotësuar nga ana e tyre. Në takimin e zhvilluar në institucion GVJ konstaton vetdijen e tyre në drejtim të plotësimit të pyetsorëve. Plani strategjik për cilësinë 2021-2024 tregon vëmendjen që institucioni i kushton sigurimit të brendshëm të cilësisë. Në takim me përfaqësues të NJSBC & Alumni u theksua vëmendja që Rektori i UT-së i kushton të dhënave dhe mendimit të studentëve të shprehur në pyetsorë. Nga ana e tij kërkohet marrja e menjëhershme e një plani masash në drejtim të përmirësimit. GVJ gjen evidencë të praktikave të ndërmarra në këtë drejtim edhe nga ana e Departamentit të Informatikës [Ev.: 69 Miratimi i planit të veprimit për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2021-2024; 71 Plan Masash Departamenti i Informatikës; Takim në institucion]</p>


<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton në bazë të dokumentave të shqyrtuara se, në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit Bachelor në “Informatike” janë përfshirë staf akademik, ndihmës akademik, administrativ dhe student [Ev.: 63 Urdher i brendshëm Nr.25 i GVB UT Akreditimi Institucional; 62 ANETARET GVB FSHN].</p>			
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Në respekt të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, gjatë procedurave që kryhen nga strukturat përkatëse të sigurimit të cilësisë për vlerësimin e programit të studimit, respektohet integriteti akademik, etika dhe liria akademike. Të gjithë pyetësorët që kryhen me studentët në mënyrë periodike janë të tilla që ruajnë anonimatit dhe konfidencialitetin e tyre.</p>			
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Nga evidentimi i bërë, rezultojnë që në aspektin e aktivizimit si pjesë e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë të aktorëve të jashtëm, kryhet Panairi i Karrierës të organizuara nga UT/FSHN ku marrin pjesë subjekte publike dhe private. Gjithashtu është organizuar dhe “Java e Europës në Universitetin e Tiranës”. Gjithashtu mobilitetet Erasmus/+ kanë ndihmuar në këtë proces.</p> <p>Nga takimi i GVJ me stafin e njësisë bazë, Departamenti i Informatikës, u vu re se organizon takime me studentët (kryesisht në kuadër të lëndës “Njohje me profesionin”) duke ftuar here pas here ish student të këtij programi studimi që janë në punë në sektorë të ndryshëm dhe të cilët në takime me studentët aktuale paraqesin përvoja të tyre apo dhe paraqesin tema nga sektori i tyre i punës. Kjo praktikë vlerësohet shumë pozitive për të motivuar studentët e këtij programi studimi në thellimin e njohurive të tyre profesionale sipas edhe eksperiencës së profesionistëve të formuar në këtë program studimi.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Jo përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi VI.5

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423


E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Vlerësojmë se politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit nga UT/FSHN janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit. UT ka krijuar programin e transparencës e cila është publike ne faqen web të tij https://unitir.edu.al/programi-i-transparences-2 . Në faqet web të FSHN dhe UT bëhen publike Analiza e Pyetësorëve, Statuti, Rregullorja, Vendime të Senatit Akademik, Vendime të Bordit të Administrimit, aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë. Edhe njësia bazë, në faqen e vet bën publike dokumentacionet bazë që lidhen me këtë program studimi.
Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Vlerësojmë se gjithë rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit që përpilojnë strukturat e institucionit respektojnë lirinë dhe etikën akademike, duke u bazuar edhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.531, datë 11.09.2018, “Për Miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë” dhe Ligjin Nr.9887 datë 10.03.20008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Rezulton që rezultatet e vlerësimit shoqërohen me plan masash konkrete për përmirësimin e mangësive dhe dobësive që janë evidentuar nga procesi i anketimeve me studentët dhe vetvlerësimi i personelit akademik. [Ev.: 94 - Miratimi i planit të veprimit për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2021-2024]
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	GVJ konstaton perpjekje nga ana e UT-se në lidhje me efektivitetin e procesit të vlerësimit të brendshëm të cilësisë në programin e studimit. Angazhimi i të gjithë hallkave në këtë proces është shprehje e qartë e vëmendjes që ky institucion i jep këtij procesi.
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin	Gjatë vizitës në institucion, rezulton se Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës organizon aktivitete dhe leksione informuese me personelin akademik dhe studentët në bashkëpunim me Këshillin Studentor, me qëllim ndërgjegjësimin e studentëve mbi rëndësinë e pjesëmarrjes së



afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	tyre në procesin e përmirësimit të cilësisë së programeve të studimit dhe shërbimeve administrative që ata marrin në institucion. Megjithatë, kjo nuk ka rezultuar e mjaftueshme për të rritur pjesëmarrjen e studentëve në plotësimin e pyetësorëve apo anketimeve në lidhje me të gjithë aspektet akademike dhe administrative të organizuara. Rritja e pjesëmarrjes së studentëve në këto anketime, do të rriste bazën statistikore për të bërë të vlefshme rezultatet e përgjigjeve nga ana statistikore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbyhet plotësisht	Përmbyhet pjesërisht	Përmbyhet kryesisht	Përmbyhet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Përmbyhet plotësisht	Përmbyhet pjesërisht	Përmbyhet kryesisht	Përmbyhet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Informatikë”

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Programi i studimit ofrohet nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës i cili jo vetëm ka një eksperiencë të gjerë në fushën e mësimdhënies dhe programeve të studimit, por dhe ka mundësuar në vite përgatitjen e një kontigjenti ekselent në fusha të tilla si matematika, fizika, kimia, informatika etj.;
2. Përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me programet e studimit bashkëkohore brenda dhe jashtë vendit;
3. Niveli i studentëve që regjistrohen në këtë program studimi është cilësor dhe me një mesatare të lartë;
4. Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Informatikë”garanton një punësim të studentëve në përfundim të studimeve të tyre;
5. Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Informatikë” ju ofron studentëve mundësinë në përfundim të studimeve të tyre të ndjekin studime të thelluara në nivelin Master i Shkencave;
6. Lëndët e programit të studimit ofrohen nga personeli akademik në përputhje me fushën e ekspertizës së tyre;
7. Marrëdhënie të institucionalizuara me universitete të huaja homologe në shërbim të kualifikimit dhe shkëmbimit të eksperiencave, konkretizuar në projekte kërkimore të përbashkëta dhe mobilitete për stafin akademik dhe studentët;
8. Pjesëmarrje e lartë e stafit akademik në konferenca, projekte kërkimore shkencore dhe botime në revista shkencore;

9. Staf akademik dhe ndihmës akademik i përkushtuar për realizimin cilësor të programit të studimit;
10. Institucioni ofron infrastrukturën e duhur duke garantuar një proces mësimor cilësor;
11. Institucioni ofron një bazë laboratorike bashkëkohore duke aftësuar studentët në drejtim të përgatitjes praktike të tyre;

b. Pika të dobta:

1. Ngarkesë mësimore e personelit akademik relativisht e lartë (*standarti II.5, kriteri 1*);
2. Mungesë e një sistemi për menaxhimin e informacionit shoqëruar me hapësirë vetiake të dedikuar (*standarti III.3, kriteri 9, Standarti IV.5, kriteri 3*);
3. Mungesë e diplomimit përmes temave të diplomës për studentët me mesatare të lartë (*standarti III.5, kriteri 3; standarti III.8, kriteri 5 dhe 6*).


Rekomandime:

1. Rekrutimi i personelit akademik efektiv suplementar me qëllim reduktimin e ngarkesës mësimore;
2. Të specifikohen në planin mësimor edhe elementë që lidhen me ngarkesën në auditor të detyrave apo projekteve të kursit;
3. Rritja e peshës së detyrave të kursit apo projekteve si dhe rritja e mëtejshme e peshës së praktikës në elementët formues të programit ;
4. Ti jepet mundësi diplomimi studentëve me mesatare të lartë përmes zhvillimit të temës së diplomës;
5. Vënia në efijencë e sistemit të menaxhimit të informacionit lidhur me studentin dhe personelin akademik;
6. Mbështetja financiare më e lartë për veprimtarinë botuese të personelit akademik si dhe për organizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të përbashkëta shkencore me studentët;
7. Rritja e pjesëmarrjes të studentëve në procesin e anketimit duke garantuar marrjen e një feedback-u më real në lidhje me ecurinë e programit të studimit;

Conclusions of the evaluation of the first cycle program Bachelor in "Informatics"

a. Strengths and affirmations:

1. The study program is offered by the Faculty of Natural Sciences, which not only has extensive experience in the field of teaching and study programs, but also has enabled over the years the preparation of an excellent contingent in fields such as mathematics, physics, chemistry, informatics, etc.;
2. The content of the study program is in accordance with contemporary study programs inside and outside the country;
3. The level of students enrolled in this study program is qualitative and with a high average.



4. The study program of the first cycle Bachelor in "Informatics" guarantees an employment of the students at the end of their studies;
5. The study program of the first cycle Bachelor in "Informatics" offers students the opportunity at the end of their studies to follow in-depth studies at the Master of Science level;
6. The courses of the study program are offered by the academic staff in compliance with their field of expertise.
7. Institutionalized relations with foreign counterpart universities in the service of qualification and exchange of experiences;
8. The Institution, through scientific research projects and collaborations with counterpart universities, offers mobility for academic staff and students;
9. High participation of academic staff in conferences, scientific research projects and publications in scientific journals;
10. The Institution offers an appropriate infrastructure guaranteeing quality in the learning process;
11. The Institution offers a modern laboratory base, enabling students in terms of their practical preparation;

b. Weakness:

1. The teaching load of the academic staff is high (*standard II.5, criteria 1*);
2. The lack of a digital platform of the institution for information management accompanied by its own dedicated space (*standard III.3, criterion 9, Standard IV.5, criteria 3*);
3. Lack of graduation through diploma thesis for students with a high average (*standard III.5, criteria 3; standard III.8, criteria 5 and 6*);

Recommendations:

1. Recruitment of additional effective academic staff in order to reduce the teaching load;
2. To specify elements related to the workload in the auditorium of course assignments or projects;
3. An increase in the weight of course tasks or projects is recommended, as well as a further increase in the weight of practice in the formative elements of the program and the increase in the number of hours of laboratory sessions;
4. The provide a possibility of graduation to students with a high average through the development of the diploma thesis;
5. Improving the efficiency of the information management system related to the student and academic staff;
6. More financial funds should be added to support the publishing activities of the academic staff as well as to organize and support joint scientific activities with students;
7. Increasing student participation in the survey process by ensuring more realistic feedback on the progress of the study program;

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Përbushen plotësisht	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X